



REPUBLIKA E SERBIË
MBROJTËSI I QYTETARËVE



Заштитник грађана
Zaštitnik građana

**REALIZIMI I TË DREJTËS SË PAKICAVE KOMBËTARE NË
PËRDORIM ZYRTAR TË GJUHËS
DHE SHKRIMIT NË REPUBLIKËN E SERBIË**



Beograd, 2010.



Заштитник грађана
Zaštitnik građana

REALIZIMI I TË DREJTËS SË PAKICAVE KOMBËTARE NË PËRDORIM ZYRTAR TË GJUHËS

Hartuar nga: Dr Goran Bašić, Dr Ljubica Đorđević

Ekipi hulumtues: Dr Goran Bašić, Dr Ljubica Đorđević, Nina Janjić,
Violeta Ćorić, Jelena Ivanović, Biljana Pavlović



Beograd, 2010.

Përmbajtja

Parathënie	4
Hyrje	7
Korniza ligjore	8
Përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare në Kushtetutën e Serbisë	8
Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare	10
Konventat e Këshillit të Evropës	10
Karta Evropiane mbi gjuhët rajonale dhe të pakicave	10
Konventa Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare	12
Marrëveshjet bilaterale me shtetet në regjion	14
Rregullativa ligjore	16
Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve	17
Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare	19
Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare	21
Rregulloret e Krahinës Autonome të Vojvodinës	22
Aktet e njësive të vetëqeverisjes lokale	25
Gjuhët në Republikën e Serbisë	27
Futja e gjuhëve në përdorim zyrtar	31
Analiza e segmenteve më të rëndësishme të së drejtës në përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare	35
E drejta në emër personal dhe regjistrimin e tij në evidenca dhe dok. publike sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të pakicës kombëtare	35
Dokumentet publike në gjuhët e pakicave kombëtare	39
Shenjat topografike në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare	42
Gjuhët e pakicave kombëtare në procedurat para organeve të administratës	44
Gjuhët e pakicave kombëtare në procedurat para gjykatave	47
Gjuhët e pakicave kombëtare në procesin zgjedhor	52
Përdorimi i gjuhëve të pakicave kombëtare në organet përfaqësuese	52
Publikimi i akteve në gjuhët e pakicave kombëtare	54
Kapacitetet për realizimin e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës së pakica ve kombëtare	56
Konkluzioni	59
Burimet ligjore	62
Burimet e hulumtimit	64

Parathënie

Në shoqërinë moderne janë hapur shumë çështje socio-linguistike në lidhje me ndikimin reciprok të gjuhës dhe shoqërisë. Ka mendime dhe hulumtime të cilat tregojnë se gjuha "e parë" të cilën e shqipton fëmija nuk është domosdoshmërisht edhe gjuha e tij amtare, gjë që ngre dyshime rreth qasjes tradicionale të mbrojtjes së gjuhëve të pakicave. Mirëpo, gjuha, edhe pse është themel i marrëveshjes dhe të kuptuarit, është edhe pjesë e identitetit të individëve dhe grupeve të cilit i përket. Shpesh njerëzit edhe orientohen apo ndjejnë se gjuha që ata flasin është e lidhur direkt me përkatësinë e tyre etnike dhe nëse ata e gjejnë veten në një situatë ku përkatësia e tyre etnike ose gjuhësore në ndonjë mënyrë është e kërcënuar, synojnë, për aq sa lejojnë kushtet shoqërore dhe institucionale, t'i homogjenizojnë dhe t'i ruajnë ato.

Duke pasur parasysh përvojën por edhe nevojat e popujve të Evropës që të ruajnë trashëgiminë dhe identitetin e vet gjuhësor, institucionet Evropiane kanë themeluar instrumente me të cilat mbrohen si të drejtat e pakicave, ashtu edhe ruajtja e gjuhëve të pakicave dhe ato regjionale. Shumica e shteteve, në mesin e të cilëve edhe Serbia, i kanë pranuar këto instrumente, i kanë ratifikuar dhe i zbatojnë në legjisllacionin dhe praktikën e tyre ndërkombëtare. Duke iu falënderuar kësaj, disa prej gjuhëve dhe identiteteve të cilat besohet të jenë asimiluar apo harruar janë revitalizuar së bashku me trashëgiminë e grupeve më të mëdha apo më të vogla njerëzish të cilët tradicionalisht banojnë në Evropë

Në Serbi ekziston tradita e njohjes dhe e mbrojtjes së identitetit dhe gjuhës së pakicave kombëtare. Gjuhët e bashkësive të caktuara etnike siç janë Shqiptarët, Bullgarët, Hungarezët, Rumunët, Rusinët, Sllovakët, Ukrainasit edhe para disa dekadave kanë pasur vendin e vet në shoqëri dhe në sistemin institucional. Në dekadat e fundit, kërkesat për njohjen e gjuhëve dhe identiteteve janë ngritur edhe nga bashkësitë e tjera etnike, para se gjithash Romët, pastaj edhe pjesëtarët e popujve të cilët në bashkësinë jugosllave kanë pasur statusin e popujve – Boshnjakët, Maqedonasit, Kroatët dhe Malazezët dhe në fund edhe pjesëtarët e të ashtuquajturve bashkësive të "fshehura" – Ashkalinjtë, Bunjevacët, Vllahët, Egjiptasit, Grekët, etj. Qasje e „hapur“ liberale juridike ndaj mbrojtjes së identitetit të bashkësive kombëtare u ka mundësuar pjesëtarëve të pakicave që të parashtrajnë kërkesa edhe për njohjen e gjuhëve të tyre dhe që, varësisht prej numrit dhe vend-ndodhjes së tyre në ndonjë territor të vendit, të merren vesh dhe të shkruajnë në gjuhët e tyre edhe në hapësirat publike. Në kuptimin më të gjërë, qëllimi i kësaj të drejte, e cila në Serbi është pjesë e mbrojtjes kushtetuese, është mbrojtja dhe ruajtja e identitetit të pakicave kombëtare, ndërsa në atë më të ngushtë është pjesëtarëve të pakicave të mos iu mohohen mundësia që të realizojnë ndonjëherë nga të drejtat

e njohura për shkak se nuk iu është mundësuar që të komunikojnë me institucionet dhe organet publike në gjuhë të tyre (t'iu drejtohen dhe të marrin përgjigje).

Ushtrimi i së drejtës në përdorim të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare është një proces kompleks dhe përveç bazës institucionale dhe ligjore kërkon dhe zhvillimin e kushteve të tjera për realizimin e saj - vetëdijes sociale mbi dobitë e arsimit shumëgjuhësh, zbatimi i politikës së mundësive të barabarta ku shumëgjuhësia është një përparësi pozitive dhe personale dhe kapital e mjet shoqëror, dhe mbi të gjitha politika multikulturore përkatëse për një shoqëri, e cila nuk duhet të jetë lineare në zbatimin e të drejtës, por duhet të jetë e drejtë në shpërndarjen e drejtësisë.

Avokati i Popullit e ka kryer hulumtimin mbi zbatimin e ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të shkrimit të pakicave në vitin 2009. dhe 2010 kur ankesat e qytetarëve që u përkasin pakicave kombëtare dhe këshillat e tyre kombëtare nxorën në pah një numër problemesh, por edhe kur me procedura është vënë re se në pjesë të ndryshme të vendit ekziston praktika dhe zbatimi i ndryshëm i rregulloreve të ndryshme në lidhje me ushtrimin e së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave, si dhe që ka rezistencë shoqërore për njohjen e kësaj të drejte në qeveri të caktuara lokale me çka shkelet politika e mundësive të barabarta, dhe i hapen dyert diskriminimit.

Hulumtimi me përkrahjen e Misioni të OSBE-së në Serbi është kryer nga Departamenti për Pakicat Kombëtare i shërbimit profesional të Mbrojtësit të Qytetarëve dhe nga Dr Ljubica Gjorgjeviq, profesoreshë në Fakultetin e Studimeve Evropiane juridiko-politike në Novi Sad. Profesoresha Gjorgjeviq, së cilës unë i jam mirënjohës për punën profesionale, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme, si dhe gatishmërisë për të reflektuar dhe për t'iu përgjigjur çështjeve komplekse dhe specifike lidhur me zbatimin e ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare, ka kryer intervista me përfaqësuesit e organeve shtetërore dhe krahinore përkatëse, ndërmarrjet dhe institucionet publike, gjykatat, qeveritë lokale, këshillat nacionale, ekspertët ... Përveç kësaj, Mbrojtësi i Qytetarëve ka organizuar edhe takim profesional për këtë çështje në të cilin ekspertët e njohur prof. Dr. Ranko Bugarski, Dr Biljana Simiq dhe Dr Jelena Filipoviq i kanë prezantuar ekipit profesional të Mbrojtësit të Qytetarëve probleme specifike sociolinguistike që lidhen me futjen e gjuhëve të ndryshme të pakicave kombëtare në praktikën publike.

Duhet përmendur që gjatë hulumtimi janë ndryshuar kushtet shoqërore dhe juridike në të cilat realizohet kjo e drejtë me çka është dëshmuar edhe njëherë fakti se gjuhët janë materie dinamike, „e gjallë“ e cila përveç që në sistemin tonë juridik përdorimi i tyre nuk është rregulluar si duhet dhe në tërësi, shfaq edhe tendencën kah ndryshimet të cilat nuk janë të kushtëzuara as me arsye juridike dhe as me ato linguistike. Në ndërkohë, në vitin 2010 është plotësuar *Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve* të miratuar gati para dy dekadave (1991); është miratuar edhe *Ligji mbi këshillat kombëtare të pakicave kombëtare* të cilat vetë-qeverisjeve lokale iu jep kompetenca lidhur me realizimin e të drejtës në përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit; është marrë vendimi i Gjykatës supreme dhe ka hyrë në fuqi *Ligji mbi librat amë* të cilat e kanë luhatur autoritetin normativ të dispozitave me të cilat Kuvendi i KA të Vojvodinës ka rregulluar më për së afërmi realizimin e të drejtës në regjistrimin e emrit personal dhe përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare në territorin e saj; Avokati i

Popullit ka lëshuar një rekomandim për autoritetet komunale në Priboj që, në përputhje me ligjin, të krijojnë kushte për futjen e gjuhës boshnjake në përdorim të barabartë në territorin e komunës; Kuvendi Komunal i Mali të Igjosit ka marrë vendimet mbi ndryshimet statusore me të cilat gjuha malazeze u fut në përdorim zyrtar; Gjykata Themelore në Zrenjanin, në përgjigje të padisë të zëvendës Mbrojtësit të Qytetarëve Trajan Pankarigjanit, nxori vendimin e parë të shkallës së parë, me të cilën vlerëson qeveria lokale ka vepruar në një mënyrë diskriminuese ndaj pakicave etnike duke mos respektuar dispozitat gjatë shkrimit të emrave të institucioneve në gjuhët e pakicave; Këshilli Kombëtar i pakicës kombëtare vllahe ka ndryshuar statutin e Këshillit të mëhershëm Kombëtar dhe vendosi që gjuha e vllahëve në Serbi nuk është rumune, ashtu siç ishte përcaktuar më herët dhe se deri në standardizimin e gjuhës vllahe në Serbi, vllahët në Serbi, do të përdorin gjuhën serbe si gjuhë zyrtare...

Duke konsideruar se këto ndryshime pjesë e jetës shoqërore të Serbisë dhe e maturimit të saj në një shtet të zhvilluar demokratik ku politika e multikulturalitetit është faktikisht e orientuar kah qytetarët, kemi vendosur që në një moment të vendosim pikën dhe opinionit publik t'i ofrojmë informatat mbi problemet të cilat i kemi hasur, përshkruar dhe analizuar, e në të cilat hasin pjesëtarët e pakicave kombëtare në Serbi. Iu jemi lutur organet gjegjëse të këshillave kombëtare të pakicave në Serbi që të dërgojnë mendimet dhe sugjerimet e veta lidhur me këtë dokument dhe kemi organizuar debat publik ku janë dakorduar mbi përmbajtjen, të gjeturat dhe konkluzionet e tij. Dokumentin i kemi dërguar edhe Sekretariatit Krahinor për administratë, rregullore dhe pakica kombëtare dhe i jemi mirënjohës sekretarit krahinor Mr Andor Deliu për sugjerime, si dhe znj. Eva Vukashinoviç, zëvendëses së Ombudsmanit Krahinor të KA të Vojvodinës, prof. dr. Tamash Korhec, Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Pakicës Kombëtare Hungareze si dhe znj. Olga Vujkov, zëvendëse e Mbrojtësit të Qytetarëve të Suboticës për leximin e kujdesshëm dhe mbështetjen. Dhe në fund, falënderim të veçantë i drejtojmë profesoreshës së Fakultetit Juridik në Novi Sad, Marijana Pajvaniç, dhe akademikut Tibor Varadij. Sugjerime domethënëse dhe të dobishme ka dhënë edhe Dr Nada Bakiç e cila në disertacionin e saj të doktoraturës është marrë me hulumtime të përdorimit zyrtar të përdorimit të gjuhëve në Serbi dhe Zvicër.

E fundit, por sigurisht jo më pak e rëndësishme, duhet theksuar se përveç meje dhe profesoreshës Gjorgjeviç, anëtar të ekipit hulumtues dhe bashkëpunëtor në hartimin e këtij teksti ishin Violeta Çoriç, Nina Janjiç, Jelena Ivanoviç dhe Biljana Pavloviç. Gjithashtu, dëshiroj të shtoj se dokumenti është shkruar dhe realizuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Serbi, veçanërisht znj Natasha Novakoviç dhe z. Bratislav Rexhiçit.

Me prezantimin e këtij teksti, Mbrojtësi i Qytetarëve nuk përfundon aktivitetet lidhur me monitorimin e realizimit të së drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare. Përkundrazi, përveç që e konsideron të domosdoshme miratimin e një *ligji të ri mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit* i cili në mënyrën më të mirë të mundur do të rregullonte realizimin e të drejtave të pakicave kombëtare për të ushtruar këtë të drejtë, por edhe mbrojtjen e identitetit të tyre, Mbrojtësi i Qytetarëve do të vazhdojë të monitorojë dhe të sjellë rekomandime organeve kompetente shtetërore dhe krahinore si dhe njësitëve të vetëqeverisjes lokale në lidhje me ushtrimin e së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit.

*Udhëheqësi i hulumtimit
dr Goran Bašić, zëvendësi i Mbrojtësit të Qytetarëve*

Publikimi i Mbrojtësit të Qytetarëve paraqet mbase analizën më gjithëpërfshirëse të rregullativës ligjore dhe zbatimit të dispozitave mbi të drejtat e pakicave kombëtare në përdorim zyrtar të gjuhës që është shkruar ndonjëherë në Republikën e Serbisë, përfshirë këtu edhe publikimet shkencore. Për më tepër, analiza e Mbrojtësit të Qytetarëve paraqet të vetmin dokument analitik të këtij lloji të cilin organi republikan e ka përgatitur në dekadat e kaluara. Natyrisht ky konstatim, sado që është lëvdatë për punën e Mbrojtësit të Qytetarëve, në të njëjtën masë paraqet edhe pasqyrën e kapacitetit të administratës shtetërore dhe qëndrimin e deritanishëm të organeve republikane ndaj kësaj problematike të ndjeshme e për disa qindra mijëra qytetarë të këtij shteti, edhe shumë të rëndësishme.

Prof. dr Tamash Korhecz (Tamas Korhecz), Kryetari i Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare hungareze

I Hyrje*

E drejta për të përdorur gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare është ndër të drejtat me të cilat rregullohet autonomia kulturore e pakicave kombëtare në Serbi si një bazë për mbrojtjen dhe ruajtjen e identitetit të tyre. E drejta në përdorim zyrtar të gjuhës amtare, në mënyra të ndryshme, është ngritur në rangun e të drejtës kushtetuese, dhe rregullohet më tej nga një sërë ligjesh dhe rregulloresh. Obligimi i shtetit për të respektuar të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave ka edhe karakter juridik ndërkombëtar, sepse bazohet si në Konventat e Këshillit të Evropës - *Kartën Evropiane për gjuhët rajonale apo minoritare dhe Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, ashtu edhe në marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen e pakicave kombëtare nënshkruar me vendet fqinje. Pavarësisht faktit që në rendin ligjor të Serbisë e drejta e përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave është e rregulluar në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare, në zbatimin e këtij ligji janë të dukshme mangësitë të caktuara.

* Të gjitha shprehjet, nocionet, mbiemrat dhe foljet në këtë tekst të cilat janë përdorur në gjininë mashkullore, i referohen pa diskriminim edhe gjinisë femërore.

II Korniza ligjore

E drejta në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare është e garantuar me Kushtetutë dhe shtjellohet më tej si në aktet ligjore me të cilat rregullohet drejtpërsëdrejti mbrojtja ligjore e pakicave kombëtare, ashtu edhe në ato të cilat për objekt direkt të rregullimit kanë sfera të tjera, por prekin edhe çështjen e përdorimit të gjuhës së pakicave. Baza ligjore e mbrojtjes së kësaj të drejte janë: *Kushtetuta e Serbisë*, marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, ligjet e ndryshme, si dhe aktet juridike të miratuar në nivelin e Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe në nivelin e njësisë së vetë-qeverisjes lokale.

1. Përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave në Kushtetutën e Serbisë

Kushtetuta e Serbisë (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 98/2006) në parimet, ndër të tjera, përcakton përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe të shkrimeve në Republikën e Serbisë. Sipas nenit 10 paragrafi 1 të Kushtetutës, në Serbi janë në përdorim zyrtar gjuha serbe dhe shkrimi cirilik. Përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve të tjera është i lejuar me kusht që ai është i bazuar në Kushtetutë dhe i rregulluar me ligj (neni 10, paragrafi 2 i Kushtetutës). Në këtë kuptim, thelbi i mbrojtjes kushtetuese dhe ligjore të së drejtës për përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare është neni 79 i Kushtetutës, i cili në paragrafin 1 në mënyrë eksplicite cek sferat e caktuara të jetës shoqërore në të cilat është e mundur të përdoren gjuhët zyrtare të pakicave: në zonat ku ata përbëjnë një popullatë të konsiderueshme autoritetet publike (shtetërore, krahinore dhe lokale), si dhe organizatat të cilave u janë besuar kompetenca publike zbatojnë procedurat edhe në gjuhën e tyre; që të përdorin emrin dhe mbiemrin e tyre në gjuhën e tyre; që në zonat ku ata përbëjnë një popullatë të konsiderueshme, emërtimet tradicionale lokale, emrat e rrugëve, vendbanimeve dhe shenjave topografike të shkruhen edhe në gjuhën e tyre. Neni 79 paragrafi 1 i Kushtetutës garanton të drejta të caktuara të cilat nuk janë të lidhura direkt me përdorimin zyrtar të gjuhës, por janë të rëndësishme për realizimin më të mirë të kësaj të drejte, pasi që kontribuojnë thellësisht në ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës së pakicave kombëtare. Fjala është për të drejtën në shkollim në institucionet publike dhe të drejtën e informimit në gjuhën e pakicave kombëtare.

E drejta në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave Kushtetuta e Serbisë e pranon në mesin e të drejtave të cilat edukojnë institutitin e autonomisë kulturore. Në përputhje me nenin 75 paragrafi 2, anëtarët e pakicave kombëtare, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet organeve vetëqeverisëse të pakicave, gjegjësisht këshillave nacionale të pakicave kombëtare

(neni 75, paragrafi 3 i Kushtetutës), marrin pjesë në vendim-marrje ose vendosin vetë për çështje të caktuara në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit.

Përveç dispozitave me të cilat është përcaktuar direkt çështja e përdorimit zyrtar të gjuhëve të minoriteteve, për ushtrimin e kësaj të drejte relevante janë dhe dispozitat e tjera kushtetuese. Kështu, Kushtetuta në dispozitat mbi ndalimin e diskriminimit (neni 21, paragrafi 3) shprehimisht cek se gjuha nuk mund të jetë arsye apo bazë për diskriminim. Ndalimi i diskriminimit të pakicave kombëtare janë garantohet në mënyrë specifike me nenin 76 të Kushtetutës. Me këtë nen, në sistemin kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave të pakicave është futur institucioni i "diskriminimit pozitiv" (masat afirmative). Përveç kësaj, Kushtetuta përmban edhe dispozita lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe statusit të të burgosurve dhe të akuzuarve, të cilat përmbajnë garanci të veçantë për përdorimin e gjuhës në procedurë. Kështu, Kushtetuta, në nenin 27 paragrafi 2 i jep të drejtë personit i cili është ndaluar nga autoritet kompetent publik, të informohet në gjuhën që ata kuptojnë për arsyet e arrestimit të tij, për akuzat që i ngarkohet dhe mbi të drejtat e tyre. Sipas nenit 33 paragrafi 1 i Kushtetutës, një person i akuzuar për një krim ka të drejtë që sa më shpejt të jetë e mundur, në pajtim me ligjin, të njoftohet hollësisht dhe në gjuhën që ai kupton, mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, dhe provave kundër tij. Këto dy dispozita përmbajnë një nivel më të ulët të mbrojtjes së të drejtave për të përdorur gjuhën, pasi që parakusht të procesit parashtrojnë gjuhën të cilën një person "kupton", dhe jo "gjuhën e vet"¹.

Megjithatë, moskuptimi i gjuhës në përdorim zyrtar në organin e shtetit nuk mund të jetë një pengesë për të realizuar të drejtat dhe mbrojtjen e pozitës në proces, ashtu që Kushtetuta në nenin 199 shprehimisht garanton të drejtën për të përdorur "gjuhën e vet" gjatë procedurës. Sipas nenit 199, paragrafi 1 i Kushtetutës, kushdo ka të drejtë që, kur vendoset mbi të drejtat dhe obligimet e tij, të përdor gjuhën e vet në gjykata, organin tjetër shtetëror apo organizatën që ushtron pushtetin publik. Në nenin 199 paragrafin 2 të Kushtetutës, theksohet se mosnjohja e gjuhës së procedurës nuk mund të jetë një pengesë për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Kushtetuta posaçërisht garanton të drejtën për përkthyes pa pagesë në proceset gjyqësore, nëse personi nuk flet ose nuk kupton gjuhën e përdorur zyrtarisht në gjykatë (neni 32, paragrafi 2)².

¹ Të drejtat gjuhësore nga të dyja këto nene të Kushtetutës nuk garantohen për shkak të përkatësisë një pakice kombëtare, por për shkak të arsyes „fair trial“ (nga anglishtja- gjykim të drejtë) dhe iu garantohet të gjithë të akuzuarve (dhe të huajve) pavarësisht gjuhës zyrtare të shtetit dhe gjykatave. Këto dy nene janë obligime të bartura nga neni 5, paragrafi 2 i Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, të cilat shteti i ka marrë përsipër me nënshkrimin e tyre.

² Dr Nana Bakiq, duke lexuar me lutje të autorit të këtij teksti, ka vënë në pah disa hamendje të cilat mund t'i hapin rrugë "leximeve" gjegjësisht interpretimeve të ndryshme të nenit 199. të Kushtetutës. Në fakt, duke marrë parasysh se qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është të garantojë "fair trial", kjo e drejtë nuk është shprehimisht e pakicave, edhe pse në paragrafin 2 përmenden pakicat. Ky nen garanton të drejtën në bazë të parimit personal të gjithë shtetasve dhe të huajve. Neni 199, paragrafi 2 i Kushtetutës shprehimisht cek pakicat si personat të cilave u takon kjo e drejtë dhe me këtë ofron garanca shtesë pjesëtarëve të pakicave, se mund të shfrytëzojnë gjuhën e vet në ndonjë procedurë. I njëjti qëndrim nga i njëjti nen të Kushtetutës përcakton, më tej, se mosnjohja e gjuhës së në të cilën

Në kontekstin e mbrojtjes kushtetuese të të drejtave të pakicave për përdorim të gjuhës dhe shkrimin është edhe dispozita e cila mbron nivelin e arritur të të drejtave, gjegjësisht të drejtave të cilat janë realizuar në mënyrë efektive: niveli i arritur i të drejtave të njeriut dhe të pakicave nuk mund të zvogëlohet.“ (neni 20).

2. Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare

Kushtetuta e Serbisë parasheh se rregullat e pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e rendit ligjor kombëtar dhe mund të aplikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në shkallën e hierarkisë, Kushtetuta i vë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara mbi ligjin, por nën Kushtetutën (neni 16, paragrafi 2 dhe neni 194, paragrafi 4 dhe 5). Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave për përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare, relevante janë dy grupe të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare të detyrueshme të cilat obligojnë Serbinë: a) marrëveshjet shumëpalëshe të miratuara nga Këshilli i Evropës, të cilat rregullojnë drejtpërdrejt mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe b) marrëveshjet bilaterale ndërmjet Serbisë dhe vendeve fqinje që rregullojnë aspekte të caktuara të mbrojtjes së ndërsjellët të pakicave.

2.1. Konventat e Këshillit të Evropës

Bazën e standardeve evropiane për mbrojtjen e pjesëtarëve të pakicave kombëtare e bëjnë marrëveshjet shumëpalëshe të Këshillit të Evropës: *Karta Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave dhe Konventa Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*^{3,4}.

ushtrohet procedura „nuk guxon të jetë pengesë“ për realizimin e të drejtave të pakicave. Kjo nënkupton se e drejta e pjesëtarëve të pakicave për përdorim të gjuhës së tyre në ndonjë procedurë nuk mund të vështirësohet me p.sh. shpenzimet e përkthimit. Kjo nënkupton se pjesëtarëve të pakicave nuk mund t’iu shkaktohen shpenzimet monetare me përdorimin e gjuhës së tyre në procedurën gjyqësore. Prandaj, neni 1999, paragrafi 2 i Kushtetutës iu garanton pakicave shërbime të përkthimit pa pagesë gjatë ndonjë procedure para organit shtetëror, por vetëm me kusht që nuk e njohin gjuhën e procedurës. Në rast se pjesëtari i pakicave njih gjuhën e procedurës, por prapë dëshiron të përdor gjuhën e vet, është i mundur interpretimi që vet duhet t’i bart shpenzimet e përkthimit. Kur Kushtetuta garanton përdorimin e gojor dhe me shkrim të një gjuhe, atëherë ai flet për përdorimin e „gjuhës dhe shkrimit“. Në nenin 199 të Kushtetutës flitet vetëm për përdorimin e „gjuhës“, gjë që shpie në përfundim se ky nen garanton të drejtën e vetëm përdorimit të gjuhës së vet në procedurë në të folur, nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare e procedurës. Në këtë interpretim shpie edhe fakti që ky nen i garanton këto të drejta të gjithë personave dhe të huajve. Mundësia që çdo person, shtetas vendor apo i huaj, mund të përdor gjuhën e vet me gojë dhe me shkrim në cilëndo procedurë pa kufizim do ta vendoste organin i cili zbaton procedurën para vështirësive dhe shpenzimeve të papërbalueshme. Është e vështirë të besohet se hartuesit e Kushtetutës kishin këtë si synim. Prandaj, përmes këtij neni i garantohet çdo personi për të drejtën e të cilit vendoset vetëm përdorimi i folur, pra me gojë, i gjuhës së vet. Përshkrimi i shkruar duhet të pasojë në gjuhën zyrtare të organit i cili udhëheq procedurën.

³ Këtyre konventave i ka paraprirë Rekomandimi mbi të drejtën e pakicave kombëtare për përdorim të gjuhës së vet (Oslo, 1996) i Komisarit të lartë të OSBE-së për pakicat kombëtare.

2.1.1. *Karta Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave*

Karta Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave është hartuar në vitin 1992 ndërsa ka hyrë në fuqi në vitin 2005. Bashkësia shtetërore e Serbisë dhe Malit të Zi ka ratifikuar Kartën në vitin 2005⁵. Pas shpërbërjes së Bashkësisë shtetërore, Serbia si pasardhës juridik, ka marrë përsipër obligimet që rrjedhin pas ratifikimit të *Kartës*.

Objektivi kryesor i *Kartës* është mbrojtja e gjuhëve historike, rajonale dhe gjuhëve të pakicave në Evropë, dhe kështu edhe ruajtjen edhe promovimin e traditave dhe diversitetit kulturor në Evropë. *Karta* parashikon një sërë masash për përdorimin e gjuhës në lëminë e arsimit, drejtësisë, administratës, mediave por dhe jetës shoqërore dhe ekonomike. *Karta* pranon sistem e ashtu-quajtur *a la carte*, sepse shtetet nuk janë të detyruara të zbatojnë të gjitha masat që parashihen në të, por të paktën 35 paragrafët dhe nënparagrafët të zgjedhura nga pjesa e tretë e *Kartës* (neni 2, paragrafi 2 i *Kartës*). Edhe pse një sistem i tillë shfaq një dobësi të *Kartës*, ai konsiderohet i justifikuar të paktën për dy arsye. Së pari, me atë mundësohet që shtetet nënshkruese të zgjedhin masat që ata i gjykojnë si më të përshtatshme për mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve rajonale dhe të pakicave në territorin e saj. Së dyti, duke aplikuar parimet e zgjedhjes së hapur ndërmjet opsioneve në dispozicion, mundësohet zbatimi i rregullativës së caktuar ndërkombëtare e cila është e pranueshme për një gamë sa më të gjerë të mundshme të vendeve. Në këtë kuptim është edhe dispozita e *Kartës* me të cilën shteteve nënshkruese iu lihet e drejta për të zgjedhur se në cilën gjuhë do të zbatojnë masa specifike të *Kartës* (neni 2, paragrafi 2).

Karta në tërësi i kontribuon realizimit të së drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare, por për këtë analizë me rëndësi të veçantë janë nenet 9, 10. dhe 13. të *Kartës* të cilat përmbajnë masat e veçanta për avancimin e gjuhëve rajonale dhe të pakicave në gjyqësi, administratë dhe shërbime publike, si dhe në jetën ekonomike dhe shoqërore.

Me aktin e ratifikimit Serbia, në kuptim të përdorimit të gjuhëve rajonale dhe të pakicave para organeve të gjyqësisë (neni 9. i *Kartës*), obligohet që në procedurën penale t'i garantojë të akuzuarit të drejtën e përdorimit të gjuhës së vet dhe të sigurohet që kërkesa dhe dëshmitë, pa marrë parasysh nëse janë në formë të shkruar apo me gojë, të mos konsiderohen si të papranueshme vetëm për shkak se janë formuluar në gjuhët rajonale apo të pakicave (neni 9. paragrafi 1. pika a (II) dhe b (III)). Sa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave në procedurat kontestimore dhe administrative, Serbia obligohet që t'u lejojë palëve që para gjykatës të mund të përdorin gjuhën e vet rajonale apo të pakicave pa shpenzime shtesë (neni 9. paragrafi 1. pika b (II) dhe c (II)). Përveç kësaj, Serbia gjithashtu është zotuar që për realizimin e të drejtës në përdorim të gjuhës apo shfrytëzimin e domosdoshëm të përkthyesit të mos iu shkaktohen shpenzimet shtesë palëve të interesuara (neni 9. paragrafi 1. pika d). Krahas kësaj, duhet përmendur që vetë *Karta* përmban kufizime të caktuara në kuptim të zbatimit të masave të

⁴ Në kuptimin më të gjërë ndërmjet dokumenteve të cilat përcaktojnë standardet juridike të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare është gjithashtu edhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive dhe protokollove shtesë prej 1-13, të cilat në Serbi kanë hyrë në fuqi në vitin 2004.

⁵ Ligji për ratifikimin e *Kartës Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave*, (*Gazeta Zyrtare e SMZ-zë-Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 18/2005).

përzgjedhura, dhe atë si në raport me zonën e caktuar gjyqësore ku jeton numri i mjaftueshëm i folësve të gjuhëve rajonale dhe të pakicave, specifikave të çdonjërit nga gjuhët e mbrojtura, ashtu edhe në kuptim të vlerësimit të gjykatësit nëse shfrytëzimi i lehtësirave të pranuar pengon zbatimin e rregullt të procedurës (neni 9. paragrafi 1). Dhe në fund, Serbia është obliguar që të mos mohojë vlefshmërinë e dokumenteve juridike të hartuara në gjuhët rajonale dhe të pakicave (neni 9, paragrafi 2, pika a, b, c) dhe se tekstet më domethënëse legislative do t'i vë në dispozicion në gjuhët e pakicave kombëtare (neni 9. paragrafi 3. i *Kartës*).

Në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave në sferat administrative të shtetit ku jeton një numër i folësve të gjuhëve të pakicave që justifikon zbatimin e masave të posaçme, Serbia është zotuar t'u mundësojë që të paraqesin parashtrimet dhe dokumentet me gojë ose me shkrim në këto gjuhë (neni 10 paragrafi 1 pika a dhe (IV) dhe (V)). Përsa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave para autoriteteve lokale dhe rajonale, Serbia është zotuar të miratojë apo të inkurajojë: a) që njerëzit që flasin gjuhët e pakicave të paraqesin parashtrimet e tyre me gojë ose me shkrim në këto gjuhë, b) që autoritetet rajonale dhe lokale të publikojnë dokumentet zyrtare në gjuhët përkatëse të pakicave, c) përdorimin e formave tradicionale të emrave në gjuhët rajonale ose minoritare, së bashku me emrin në gjuhën zyrtare shtetërore (neni 10, paragrafi 2, pika b, c, d, g). Përsa i përket përdorimit të gjuhëve të pakicave në shërbimet publike në territorin në të cilin përdoren këto gjuhë, Serbia është detyruar t'u mundësojë përdoruesve të gjuhëve rajonale ose të pakicave që të paraqesin kërkesa në këto gjuhë (neni 10, paragrafi 3, pika c). Për të mundësuar realizimin e përdorimit zyrtar të gjuhëve rajonale ose të pakicave para autoriteteve administrative dhe shërbimeve publike, Serbia është zotuar, për aq sa është e mundur, t'i plotësojë kërkesat e punonjësve të shërbimit publik të cilët njohin ndonjë gjuhë rajonale ose minoritare të angazhohen në territorin në të cilin përdoret ajo gjuhë (neni 10, paragrafi 4, pika c). Serbia ka pranuar edhe masën nga neni 10 paragrafi 5, i cili parasheh që shtetet obligohen të lejojnë përdorimin dhe përvetësimin e emrave të familjeve në gjuhët rajonale ose të pakicës, me kërkesë të të interesuarve.

Përsa i përket përdorimit të gjuhës së pakicave në jetën ekonomike dhe shoqërore, Serbia është orientuar për një masë mjaft të përgjithshme – që t'i kundërvihet praktikës e cila ka për qëllim të dekurajojë përdorimin e gjuhës regjionale dhe të pakicave në këto sfera (neni 13 paragrafi 1 pika c).

Gjatë ratifikimit të *Kartës* Serbia ka pranuar zbatimin e masave të cekura në raport me gjuhët shqipe, boshnjake, bullgare, hungareze, rome, rumune, rusine, sllovaqe, ukrainase dhe kroate, duke mos bërë asnjë dallim ndërmjet tyre.

2.1.2. *Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*

Konventa Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: *Konventa Kornizë*) (1995) është marrëveshja e parë shumëpalëshe e cila ka të bëjë ekskluzivisht me të drejtat e pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Ajo përmban qëllime dhe parime të definuara në formë kornize të cilat shtetet anëtare duhet t'i zbatojnë në politika dhe rregullativën e tyre. *Konventa Kornizë* nuk përcakton sistemin e mbrojtjes ligjore siç është ajo që përcjell *Konventën Evropiane të të drejtave dhe lirive të njeriut*. *Konventa Kornizë* përmban katalogun e të drejtave të cilat shtetet duhet t'i sendërtojnë në politikat kombëtare dhe në rendin ligjor dhe në këtë mënyrë të

krijonjë kushtet për ruajtjen e specifikave të pakicave kombëtare. Ajo në masë të madhe ka të bëjë me kulturën, arsimin, përdorimin e gjuhës, informimin por jo edhe të drejtat siç janë pjesëmarrja e pjesëtarëve të pakicave kombëtare në punët publike apo në ruajtjen e kontakteve me bashkëqytetarët.

Republika Federale e Jugosllavisë ka inkorporuar *Konventën Kornizë* në rendin juridik ligjor që në vitin 1998⁶, por është anëtarësuar vetëm në maj të vitit 2001. Nga aspekti ndërkombëtar – juridik *Konventa Kornizë* është bërë obligative për RS të Jugosllavisë së atëhershme në shtator të vitit 2011 dhe që atëherë ka ndikuar thellësisht në rregullativën kombëtare mbi pakicat kombëtare, para se gjithashtu në Ligjin mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare (*Gazeta Zyrtare e RSJ-së*, nr 11/2002), në zgjidhjet kushtetuese, Ligjin mbi këshillat kombëtare (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 72/2009), por edhe në ligje dhe dispozita të tjera.

Konventa kornizë vërteton se gjuha është njëri prej elementeve kyçe të identitetit të pjesëtarëve të pakicave (neni 5, paragrafi 1) dhe përmban dispozita të ndryshme të cilat kanë për qëllim të ruajnë dhe të avancojnë identitetin e tyre gjuhësor, posaçërisht përmes edukimit dhe informimit në gjuhën e pakicave kombëtare. *Konventa Kornizë* rregullon çështjen e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare përmes neneve 10. dhe 11. Neni 10. paragrafi 1 e njuh të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që lirshëm dhe pa pengesë të shfrytëzojnë gjuhën e vet, dhe atë privatisht dhe publikisht⁷. Obligimi i shtetit i cili rrjedh nga kjo dispozitë konsiston në rend të parë në mosveprim, duke marrë parasysh që shteti nuk guxon të pengojë përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare. Obligimi për të mos ndërhyrë, në kuptim të mbështetjes apo avancimit, nuk është rregulluar shprehimisht me ndonjë normë, dhe prandaj veprimi i shtetit ka të bëjë vetëm me obligimin e tij që të parandalojë pengesat nga ana e palëve të treta.

Përdorimi i gjuhës së pakicave kombëtare në komunikim me organet shtetërore është rregulluar në nenin 10, paragrafi 2. Me këtë rast, me këtë normë nuk janë përfshirë të gjitha organet shtetërore, por vetëm organet e administratës. Çështje e vërteta, në përputhje me tekstin shpjegues të Këshillit të Evropës për *Konventën Kornizë*, nocioni „organet administrative“ duhet të interpretohet në kuptim të gjërë, ashtu që për shembull të përfshijë edhe institucionin e ombudsmanit⁸. Dispozita e cekur është formuluar në mënyrë të paqartë dhe u lejon shteteve mundësinë e vlerësimit të lirë. Gjuha e pakicës kombëtare mund të përdoret në komunikim me organet administrative, nëse pakica kombëtare tradicionalisht apo në numër më të madh banon në një zonë të caktuar, nëse pjesëtarët e pakicave kërkojnë përdorimin e gjuhës së tyre dhe nëse kjo kërkesë iu përgjigjet nevojave reale deri “në masën e mundshme”. Neni 10, paragrafi 3 rregullon përdorimin e gjuhës në rastin e privimit nga liria dhe

⁶ Ligji mbi vërtetimin e *Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*, (*Gazeta Zyrtare e RF të Jugosllavisë– Marrëveshjet ndërkombëtare* nr. 6/98)

⁷ Nocioni „publik“ i referohet përdorimit të gjuhës së pakicave në një vend publik, jashtë, por edhe në prani të personave të tjerë, por asesi nuk duhet të interpretohet në raport me vendet publike. Pika 63. *Teskti shpjegues i raportit mbi Konventën Kornizë*:

(<http://www.humanrights.coe.int/Minorities/Eng/FrameworkConvention>).

⁸ *Burimi i njëjtë*, pika 64.

akuzës eventuale. *Konventa Kombëtare* nuk del jashtë kornizës së mbrojtjes të cilën e ofron *Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut* (neni 6, paragrafi 3, pikat a dhe e e *Konventës Evropiane*). Konventa Kornizë, ashtu si Konventa Evropiane, përmban mbrojtjen në nivelin e gjuhës të cilën personi „e kupton“, por parasheh edhe të drejtën në ndihmë të përkthyesit pa pagesë.

Për realizimin e të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare domethënës është edhe neni 11 i *Konventës Kornizë*. Sipas nenit 11, paragrafi 1, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin emrin dhe mbiemrin e tyre në gjuhën e vet, si dhe të drejtën e njohjes zyrtare të atij emri, në mënyrën e cila lejohet me sistemin juridik të shtetit nënshkrues. Në këtë kuptim, shtetet mund të përdorin shkrimin e gjuhës zyrtare për të shkruar emrin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare në formën fonetike të tij. Përveç kësaj, rendi ligjor duhet të parasheh mundësinë që personat të cilët ishin të detyruar të heqin dorë nga emri i tyre burimor, ose emri burimor i të cilëve ishte ndryshuar me forcë, mund ta kthejnë emrin e tyre burimor, me përjashtim të rasteve kur ndryshimi i këtyllë ka për qëllim keqpërdorimin e kësaj të drejte apo mashtrimin.⁹

Neni 11, paragrafi 2 i *Konventës Kornizë* parasheh të drejtën e personave e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që publikisht të nxjerrin në pah shenjat, mbishkrimet dhe informatat tjera të natyrës private në gjuhën e pakicave. Termi "natyrë private" duhet të interpretohet si referencë ndaj çdo gjëje që nuk është zyrtare. Kjo dispozitë nuk liron pjesëtarët e pakicave nacionale si shtesë të përdorin gjuhën zyrtare apo një tjetër gjuhë të pakicave kombëtare. Neni 11 paragrafi 3 ka të bëjë me shfaqjen e shenjave topografike në gjuhën e pakicave. Me dispozitë është përfshirë shfaqja e emërtimeve tradicionale të vendeve, emërtimeve të rrugëve dhe shenjave të tjera topografike drejtuar publikut. Këto emërtime topografike mund të paraqiten edhe në gjuhën e pakicave kombëtare, me kusht që në trevën përkatëse tradicionalisht jeton një numër i konsiderueshëm i personave që u përkasin pakicave kombëtare, dhe se ka kërkesë të mjaftueshme për shenja të tilla. Detyrimi i shtetit dobësohet më tej nga dispozitat ku thuhet se shtetet do të "synojnë", dhe se do të veprojnë siç është parashikuar, "duke marrë parasysh kushtet e tyre specifike."

Përveç këtyre „burimeve“ të së drejtës ndërkombëtare duhet të ceket edhe se përmbajtja e tyre rrjedh nga instrumentet dhe praktikat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe KEBS-it: - Neni. 2. Karta e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut (Resolution 10 December 1948, UN Doc. A/RES/47/135) e cila ndalon diskriminimin në bazë të gjuhës. Edhe pse nga ky nen nuk rrjedhin obligimet ligjore për shtetin, domethënia e tij është e madhe. Kjo dhe normat e ngjashme (Dokumenti përfundimtar i takimit të Kopengahës i datës 29.6.1990) kanë domethënie në kuptim të zhvillimit të së drejtës interne, ato në fakt tregojnë se në ç’drejtim duhet të zhvillohet lëmia e caktuar juridike dhe shërbejnë si një paradigmë e llojit të vet.

- Neni 27 i Paktit ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike e 19 dhjetorit 1966, nga i cili rrjedhin obligimet ligjore për shtetin. Në literaturë mbizotëron mendimi se shtetet mbi bazën e këtij neni janë të obliguara jo vetëm të tolerojnë përdorimin e gjuhës së një pakice, por

⁹ *Burimi i njëjtë* pika 68.

kanë edhe obligim direkt që pakicave gjuhësore t'u mundësojnë kushtet për zhvillimin e natyrës speciale të gjuhës së vet.

- Pakti i Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe Marrëveshja Ndërkombëtare mbi eliminimin e çdo forme të diskriminimit rasor nga të cilat gjithashtu rrjedhin disa të drejta të caktuara për nënshkruesit.

2.2. *Marrëveshjet bilaterale me shtetet në rajon*

Serbia është trashëgimtare e marrëveshjeve bilaterale mbi mbrojtjen e pakicave të cilat RSJ-a apo Bashkësia shtetërore e Serbisë dhe Malit të Zi i kanë nënshkruar me Kroacinë¹⁰, Hungarinë¹¹, Maqedoninë¹² dhe Rumaninë¹³. Lidhja e këtyre marrëveshjeve në masë të madhe ka rrjedhur nga neni 18, paragrafi 1 *Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare* të Këshillit të Evropës i cili parasheh që shtetet nënshkruese, sipas nevojës, lidhin marrëveshjet dypalësh dhe shumëpalëshe me shtetet e tjera, posaçërisht me shtetet fqinje, në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e ndërsjellët të pakicave kombëtare.

Me marrëveshjet bilaterale janë rregulluar çështje të ndryshme nga lëmia e lirisë së shprehjes, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të pakicave kombëtare. Çdonjëra nga këto marrëveshje përmban edhe nen të veçantë me të cilin rregullohet çështja e përdorimit zyrtar të pakicës së caktuar kombëtare. *Marrëveshja me Rumaninë dhe me Maqedoninë* përmban dispozita pothuajse të njëjta mbi përdorimin zyrtar të pakicave zyrtare, ndërsa *Marrëveshja me Hungarinë dhe Kroacinë* është më e gjërë dhe rregullon në mënyrë më të hollësishme këtë çështje. Me të gjitha marrëveshjet palët kontraktuese obligohen të sigurojnë përdorimin e gjuhës amtare, privatisht dhe publikisht¹⁴; të përdorin gjuhën e vet në procedura para organeve lokale, administrative, dhe gjyqësore¹⁵; që mbishkrimet topografike, emërtimet e vendeve,

¹⁰ Ligji mbi ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Kroacisë mbi mbrojtjen e të drejtës së pakicave serbe dhe malazeze në Republikën e Kroaciës dhe pakicës kroate në Serbi e Mal të zi, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet Ndërkombëtare*, nr. 3/2005.

¹¹ Ligji mbi ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës Hungareze mbi mbrojtjen e pakicës kombëtare hungareze e cila jeton në Serbi dhe Mal të zi dhe pakicës kombëtare serb që jeton në Republikën Hungareze, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 14/2004.

¹² Ligji mbi ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Serbisë dhe Malit të zi dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen e pakicës kombëtare serbe dhe malazeze në Republikën e Maqedonisë dhe pakicës kombëtare maqedonase në Serbi dhe Mal të Zi, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 6/2005.

¹³ Ligji mbi ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Federale të RFJ-së dhe Qeverisë së Rumanisë mbi bashkëpunimin në sferën e mbrojtjes së pakicave kombëtare, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 14/2004.

¹⁴ Neni 6 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Kroacinë*; neni 5 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Hungarinë*; neni 3 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Maqedoninë*; neni 3 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Rumuninë*.

¹⁵ Neni 6 paragrafi 2 alineja 1 e *Marrëveshjes me Kroacinë*; neni 5 paragrafi 3 i *Marrëveshjes me Hungarinë*; neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Maqedoninë* neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Rumaninë*.

rrugëve dhe mbishkrimet e tjera publike të vendosen edhe në gjuhën e pakicave kombëtare¹⁶. Përveç *Marrëveshjes me Kroacinë*, e cila këtë çështje nuk e thekson posaçërisht, të gjitha marrëveshjet e tjera parashohin obligimin e shteteve nënshkruese që t'u sigurojnë pjesëtarëve të pakicave kombëtare që emri dhe mbiemri i tyre në dokumentet personale dhe ato zyrtare t'u shkruhet në gjuhën amtare¹⁷. Në rregullimin e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicës kombëtare *Marrëveshja me Kroacinë* dhe *Marrëveshja me Hungarinë* janë më të detajshme dhe çdonjëra prej tyre përmban disa dispozita të cilat nuk mund të gjenden në marrëveshjet me shtetet e tjera. Kështu *Marrëveshja me Hungarinë* rregullon: a) lëshimin e dokumenteve personale të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në gjuhën amtare (neni 5 paragrafi 2); b) e drejta në përkthyes pa pagesë në procedurat para organeve të autoriteteve publike (neni 5. paragrafi 3); c) e drejta e vetëqeverisjeve të pakicave që të administrojnë punët e veta në gjuhën e vet amtare (neni 5 paragrafi 4). *Marrëveshja me Kroacinë*, nga ana tjetër, posaçërisht thekson aspektin e përdorimit të gjuhëve të pakicave të cilat nuk gjenden në marrëveshjet e tjera, dhe atë: përdorimin e gjuhës së pakicave në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të vetëqeverisjes lokale, në procedurën e mbajtjes së zgjedhjeve dhe referendumeve shtetërore dhe lokale, certifikatave dhe vërtetimeve, gjatë hartimit të dokumenteve personale të cilat përdoren në qarkullimin privat, për përdorimin e formularëve dygjuhësor, pllakave të mbishkrimit, vulave dhe shenjave të organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe personave juridik të cilat kanë kompetenca (neni 6 paragrafi 2, alineja 2-6).

3. Rregullativa ligjore

Për rregullimin e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës amtare në nivelin e ligjeve, kyç janë dy ligjet: Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit (*Gazeta zyrtare e RS-së*, nr. 45/91, 53/93, 67/93, 48/94, 101/2005 dhe 30/2010) dhe Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare (*Gazeta zyrtare e RSJ-së*, nr. 11/2002).

Duke marrë parasysh se Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave ka konstatuar, ndërsa Kushtetuta e Serbisë ka vërtetuar, të drejtën në autonominë kulturore të pakicave kombëtare, me të cilën është përfshirë e drejta në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, në këto ligje themelore duhet të vendoset edhe Ligji mbi Këshillat nacionale të pakicave kombëtare (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 72/2009), me të cilin rregullohen autorizimet e këshillave nacionale në kuptim të realizimit të së drejtës në përdorimin zyrtar të gjuhës amtare.

Përveç tre ligjeve të përmendura, aspektet e ndryshme të përdorimit të gjuhëve të pakicave rregullohen me ligjet të cilat për objekt parësor nuk e kanë rregullimin e mbrojtjes së të drejtës së pakicave kombëtare, por ndonjë sferë tjetër të marrëdhënieve shoqërore. Në këtë kuptim, relevante janë ligjet vijuese: Ligji mbi vetëqeverisjen lokale (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 129/07),

¹⁶ Neni 6 paragrafi 2, alineja 7 e *Marrëveshjes me Kroacinë*; neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Maqedoninë*; neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Rumaninë*.

¹⁷ Neni 5 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Hungarinë*; neni 3 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Maqedoninë* dhe neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Rumaninë*. *Marrëveshja me Rumaninë* parasheh regjistrimin e emrit dhe mbiemrit personal në evidencat zyrtare dhe përmbledhjet e të dhënave personale.

Ligji mbi librat amë ((*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 20/2009), Ligji mbi marrëdhëniet familjare (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 18/2005), Ligji mbi letërnjoftimin (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 62/2006), Ligji mbi dokumentet e udhëtimit (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 90/2007 dhe 116/2008), Ligji mbi procedurën e përgjithshme administrative (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 33/97 dhe 31/2001), Ligji mbi procedurën kontestimore (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 125/2004 dhe 111/2009), Ligji mbi procedurën jashtëkontestimore (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 25/82 dhe 48/88 dhe *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 46/95-dr. ligj dhe 18/2005), Kodi i Procedurës Penale (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 70/2001 dhe 68/2002 dhe *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 58/2004, 85/2005, 115/2005, 85/2005-dr. ligji, 49/2007 dhe 20/2009), Ligji mbi kundërvajtjet (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 101/2005, 116/2008, 111/2009), Ligji mbi zgjedhjen e deputetëve popullor (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 35/2000, 57/2003 – Vendimi i GJKRS-së, 72/2003 - dr. ligj, 75/2003 - korr. i ligjit të dytë , 18/2004, 101/2005 – ligji i dytë dhe 85/2005), Ligji mbi zgjedhjet lokale (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 129/07), Ligji mbi vulën e organeve shtetërore dhe të tjera (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 101/07), Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, 109/2007). Problemet të cilat paraqiten në lidhje me realizimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave qëndrojnë në atë se dispozitat e ligjeve të cekura jo gjithmonë janë në përputhje me standardet e përcaktuara nga Kushtetuta dhe Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, dhe se nuk janë të harmonizuara ndërmjet veti.

Mangësitë në nivelin e rregullativës ligjore ndikojnë negativisht në efektivitetin e parimeve të mbrojtjes së pakicave kombëtare të vendosura nga *Kushtetuta* dhe Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të pakicave kombëtare, ashtu që përkundër sistemit të përpunuar ligjore nuk mund të thuhet se Serbia ka një *sistem* të kompletuar dhe efikas të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare për përdorimin zyrtar të gjuhëve të tyre.

Në këtë pjesë do të paraqesim ligjet e përmendura themelore, ndërsa zgjidhja e ligjeve të tjera do të shfaqet në pjesën që ka të bëjë me analizën e aspekteve të ndryshme të përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të pakicave kombëtare.

3.1. *Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit*

Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit rregullon çështjen e përgjithshme të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit në Republikën e Serbisë, me ç'rast në pjesën e III-të përmban dispozita të cilat ekskluzivisht iu referohen përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare. Që në fillim, në nenin 1 Ligji përcakton se në trevat ku jetojnë pjesëtarët e pakicave kombëtare, krahas¹⁸ gjuhës serbe në përdorim zyrtar janë edhe gjuhët dhe shkrimet e tyre.

Me përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit Ligji nënkupton përdorimin e gjuhës dhe shkrimit në punën e organeve shtetërore, organeve autonome të krahinave, qyteteve dhe komunave, instituteve ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera gjatë ushtrimit të kompetencave publike,

¹⁸ Gjykata Kushtetuese e Serbisë, në vendimin që kishte të bënte me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Statutit të komunës Tutin, kishte paraqitur qëndrimin që nocionin „njëkohësisht“ në kuptimin ligjor nuk është sinonim me nocionin „i barabartë“, dhe se një përdorimi „njëkohësishtëm“ i gjuhës në kuptimin zyrtar nuk është barazi me përdorimin e „barabartë“ të gjuhës dhe shkrimit zyrtar. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese IU-27/99 i datës 11.1.2001, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 10/2001.

shërbimeve publike dhe ndërmarrjeve e organizatave të tjera të cilat ushtrojnë punët e përcaktuara me Ligj.

Në kuptim të Ligjit përdorimi zyrtar i gjuhës në veçanti nënkupton: komunikimin verbal dhe me shkrim të organeve ndërmjet veti, si dhe me palë; kryerja e procedurave për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve; mbajtja e evidenca të nevojshme; lëshimi i dokumenteve publike dhe të tjera të cilat janë me interes për realizimin e të drejtave të garantuara të qytetarëve; realizimi i të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësive të punëtorëve nga marrëdhënia e punës dhe në bazë të punës. Përdorimi i gjuhës dhe i shkrimit gjatë shkrimit të emërtimeve topografike, emërtimin e organeve, organizatave dhe firmave, si dhe gjatë publikimit të thirrjeve publike, njoftimeve dhe paralajmërimeve dhe mbishkrimeve publike gjithashtu konsiderohet përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit (neni 3).

Neni 6 i Ligjit parasheh të drejtën e çdo personi që në procedurë para organit dhe organizatës e cila, duke ushtruar kompetencat publike, vendos mbi të drejtën dhe obligimin e tij, të përdor gjuhën e vet dhe që në procedurë të njihet me fakte në gjuhën e vet. Neni 7 rregullon mënyrën e shkrimit të tekstit në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare, dhe atë ashtu që këto shkruhen pas tekstit në gjuhën serbe nën apo djathtas tij, me të njëjtën formë dhe madhësi të shkronjave. Me ligjin është parashikuar që në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjuha e pakicës kombëtare që është në përdorim të mos ndryshojë, me çka është siguruar mbrojtja e parimit kushtetues e të drejtave të arritura.

Në Pjesën III të Ligjit i cili në tërësi merret me përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave parashihet që „në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku tradicionalisht jetojnë pjesëtarët e pakicave kombëtare, gjuha dhe shkrimi i tyre mund të jetë në përdorim të barabartë zyrtar “ (neni 11). Paragrafi pasues i të njëjtit nen e obligon njësinë e vetëqeverisjes lokale në territorin e së cilës, me regjistrimin e fundit të popullsisë, janë konstatuar më shumë se 15% të pjesëtarëve të ndonjë pakice kombëtare, që me statut ta vendosin gjuhën e pakicës kombëtare në përdorim të barabartë zyrtar. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku jetojnë pjesëtarët e pakicave kombëtare, përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave kombëtare nënkupton që pjesëtarët e pakicave kombëtare e përdorin gjuhën e vet në: a) në procedurën ligjore dhe gjyqësore (kryerja e të procedurave bëhet në gjuhën e pakicës kombëtare); b) në komunikim me organet që ushtrojnë kompetenca publike; v) me marrjen e dokumenteve publike në gjuhën e vet; g) gjatë regjistrimit në evidenca publike dhe në përmbledhje të të dhënave publike dhe me pranimin e dokumenteve të tilla si të vlefshme; d) gjatë zgjedhjeve fletëvotimet dhe materiali zgjedhor botohen edhe në gjuhët e tyre; gj) në punën e organeve përfaqësuese.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku ekziston obligimi i futjes së gjuhës së pakicave në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit, kërkohet që emërtimet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, vendbanimeve, shesheve dhe rrugëve si dhe toponimet tjera të shkruhen në gjuhën e pakicës kombëtare sipas traditës dhe drejtshkrimit të tyre.

Krahinat autonome përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në punën e organeve të tyre e rregullojnë me statut, ndërsa pjesëtarët e pakicave kombëtare numri i përgjithshëm i të cilëve në Serbi arrin të paktën 2% mund t’iu drejtohen organeve republikane në gjuhën e vet në të cilin edhe duhet të marrin përgjigje. Të drejtë të njëjtë kanë edhe pjesëtarët e pakicave kombëtare të cilat në popullsinë e përgjithshme të Serbisë nuk arrin 2%

por mund ta realizojnë përmes njësisë së vetëqeverisjes lokale ku gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar dhe e cila është e obliguar që të sigurojë përkthimin e parashtrësës me të cilën pjesëtari i pakicës kombëtare i drejtohet organit republikan.

Pjesa III e Ligjit rregullon:

- a) Zbatimin e procedurës administrative, penale, kontestimore apo ndonjë tjetër në shkallë të parë në gjuhën e pakicave (neni 12 - 14);
- b) Përdorimin e gjuhës së pakicave në procedurën e cila kryhet në treva ku gjuhët e pakicave nuk janë në përdorim zyrtar (neni 16 - 17);
- v) lëshimi i dokumenteve publike në gjuhën e pakicës kombëtare (neni 18);
- g) përzgjedhja dhe përdorimi i emrit personal dhe emrat e fëmijëve si dhe regjistrimi i këtyre emrave në të gjitha dokumentet publike, evidencat zyrtare dhe përmbledhjet e të dhënave personale (neni 18a)
- d) shkrimi i shenjave topografike, si dhe shkrimi i firmës në gjuhën edhe në gjuhën e pakicave kombëtare (neni 19 - 20).

Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit është ndryshuar për herë të fundit në vitin 2010. Hulimtimin të cilin e ka kryer Mbrojtësi i Qytetarëve në lidhje me realizimin e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kishte përfunduar disa muaj më herët. Gjithashtu, ende nuk ka informata mbi shembuj të praktikës së mirë dhe problemeve të cilat paraqiten në zbatimin e tij, por veç tani mund të vihen në pah disa mospërputhje të tekstit ligjor dhe zgjidhjes në nenin 11 paragrafi 2 të cilat thellësisht pengojnë zbatimin e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare.

Fitohet përshtypja se mangësitë juridiko-teknike rrjedhin nga fakti se dispozitat e tij janë marrë nga Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare. Kështu Ligji mban neni 1 paragrafin 3 të Ligjit i cili flet për përdorimin e “njëkohësishëm” të gjuhëve të pakicave. Përveç kësaj, Ligji mban nenet 2 dhe 3 të ligjit të mëhershëm me të cilin definohet se çka nënkuptohet me përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, ndërsa në nenin 11 paragrafin 3 të ndryshuar përcaktohet se çka nënkuptojmë me përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave. Ndarja e këtillë në përcaktimin e nocionit të përdorimit zyrtar është e panevojshme, pasi që në thelb dyfishohet, dhe mund të shkaktojë edhe problemet e panevojshme me interpretim dhe hamendje mbi përdorimin e “barabartë” të gjuhës së pakicave. Edhe në kuptim të shenjave topografike Ligji nuk është konsistent nga aspekti juridiko-teknik; neni i ri 11 paragrafi 4 rregullon këtë çështje, dhe është ruajtur edhe neni 19 i cili ka të njëjtën lëndë të rregullimit.

3.2. *Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare*

Me propozim të Ministrisë për pakica kombëtare dhe grupe etnike, Kuvendi Federal i atëhershëm kishte miratuar Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin 2002 me idenë e ngërthimit të parimet themelore të mbrojtjes së pakicave, ndërsa Republika e Serbisë dhe Mali i Zi do të duhej të sillnin ligje të cilat duhet të rregullonin këtë materie detajisht, gjë që nuk e kanë bërë deri në shpërbërjen e RF të Jugosllavisë, e më vonë edhe të Bashkësisë shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi.

Pas ndarjes së Serbisë dhe Malit të Zi, Serbia, si pasardhëse e Bashkësisë shtetërore, ka marrë përsipër të gjitha obligimet „federale“, në mesin e të cilave edhe Ligjin mbi mbrojtjen e të

drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare. Mirëpo, natyra deklarative e këtij ligji nuk i ka kontribuar efikasitetit të mbrojtjes së të drejtës së pakicave kombëtare. Dispozitat e Ligjit mbështeten në standardet evropiane të mbrojtjes së pakicave kombëtare, me ç'rast ndikimi i *Konventës Evropiane* e Këshillit të Evropës është i dukshëm. Ligji ka avancuar sistemin e mbrojtjes së pakicave në Serbi para se gjithash përmes definimit të nocionit të pakicës kombëtare, përcaktimit të të drejtave themelore në mbrojtje të specifikave të pakicës kombëtare dhe futja e institutit të këshillave nacionale të pakicave kombëtare në rendin ligjor të Serbisë.

Pjesa qendrore e Ligjit është pjesa e tretë që rregullon ruajtjen e specifikave: të drejtën në zgjedhje dhe përdorim të emrit personal (neni 9), të drejtën në përdorim të gjuhës amtare (neni 10 dhe 11), e drejta për të praktikuar kulturën dhe traditat (neni 12); të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare (neni 13, 14 dhe 15), të drejtën e përdorimit të simboleve kombëtare (neni 16) dhe të drejtën e informimit në gjuhën e pakicave kombëtare (neni 17). Rëndësia e ligjit qëndron edhe në atë se në rendin ligjor dhe jetën shoqërore ka futur edhe institutet e: a) autonomisë kulturore të pakicave kombëtare në fushën e arsimit, mediave, gjuhën dhe kulturën, dhe b) të vetëqeverisjes së pakicave nëpërmjet futjes së këshillave nacionale të pakicave kombëtare (neni 19) të cilat janë pranuar dhe në *Kushtetutën* e Serbisë (neni 75, paragrafi 3 i *Kushtetutës*).

Çështjen e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare ligji e rregullon me nenin 11. Përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave lidhet me territorin e njësisë së qeverisjes lokale, në të cilën tradicionalisht banojnë pakicat kombëtare. Ligji në nenin 11 të paragrafit 2 parasheh që qeveritë lokale duhet të fusin gjuhët e pakicave në përdorim të barabartë zyrtar, nëse përqindja e pjesëtarëve të pakicave në popullsinë e përgjithshme në territorin e njësisë së qeverisjes lokale arrin 15%. Pjesëmarrja prej 15% përcaktohet në bazë të regjistrimit të fundit. Gjuha e pakicave mund të jetë në përdorim zyrtar edhe nëse nuk arrin pragun prej 15%, dhe atë në bazë të Institutit të të drejtave të fituara ose zbatimit të masave afirmative¹⁹.

¹⁹ Dr Nada Bakiq, bazuar në analizën krahasuese të zbatimit të përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare, reflekton në mënyrë kritike mbi zgjidhjet normative të zbatimit të të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare. Përmbledhje e disa mendimeve interesante, polemike, por shumë të rëndësishme edhe për diskursin e së ardhmes të dr. Bakiqit janë si në vijim: "Futja e një gjuhe të pakicave në përdorim zyrtar në Serbi, ka pasoja me ndikim të gjerë, pasi që obligon të gjitha agjencitë shtetërore me seli në komunë në të cilën gjuha dhe shkrimi i pakicave kombëtare është në përdorim zyrtar. Kjo do të thotë se autoritetet komunale dhe gjykatat duhet t'i zgjidhin vetë problemet komplekse të shumëgjuhësisë zyrtare, dhe të aftësohen që t'i kryejnë të gjitha veprimet dhe t'i sjellin të gjitha aktet në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës. Përvetësimi i shumëgjuhësisë në punën e një organi paraqet një prej problemeve shumë komplekse organizative dhe financiare. Nëpërmjet kriterit të popullatës pakicë prej 15% për futjen e gjuhës së pakicave si gjuhë zyrtare para shtetit është vënë një detyrë e vështirë, dhe pritjet janë të larta. Sipas kriterit të 15% në Serbi mund të pritjet që një komunë e vogël të ketë më shumë gjuhë në përdorim zyrtar gj që nuk është rationale, ekonomikisht e pajustificueshme, ndërsa qëllimi i mbrojtjes së identitetit të pakicave kombëtare dhe gjuhëve të tyre mund të arrihet edhe në mënyra të tjera. Nga kjo pikëpamje është përqindje ligjore e popullatës pakicë prej 15% për futjen e gjuhës së pakicave si gjuhë zyrtare është shumë të ulët dhe për këtë arsye kjo dispozitë duhet të interpretohet në kuptim të ngushtë. Dr Bakiq vë

Sipas nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave nënkupton kryerjen e procedurës administrative dhe gjyqësore në gjuhën e pakicave dhe përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare gjatë këtyre procedurave, kur ato kryhen në atë gjuhë; përdorimi i gjuhës së pakicës kombëtare gjatë komunikimit të organeve me kompetenca publike me qytetarët; lëshimin e dokumenteve publike dhe mbajtjen e evidencave zyrtar si dhe përmbledhje e të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimin e këtyre dokumenteve në këto gjuhë si të vlefshme; përdorimi i gjuhëve në fletëvotimet dhe në materialin zgjedhor, si dhe përdorimin e gjuhëve në punën e organeve përfaqësuese.

Ligji rregullon edhe çështjen e shkrimit të shenjave topografike në gjuhët e pakicave kombëtare duke sjellë një risi të rëndësishme, ashtu që lejon që këto shenja të shkruhen sipas traditës dhe drejtshkrimit të pakicës kombëtare (neni 11 paragrafi 5).

Ligji përmban edhe dispozitat sipas të cilave përdorimi i gjuhëve të pakicave kombëtare zgjerohet jashtë kufijve të territorit të vetëqeverisjes lokale. Sipas nenit 11 paragrafi 6, ligjet dhe rregulloret e tjera, në përputhje me ligjin, publikohen edhe në gjuhët e pakicave kombëtare, gjegjësisht parashihet mundësia që pjesëtarët e pakicave kombëtare numri i të cilëve në popullsinë e Republikës së Serbisë arrin së paku 2% sipas regjistrimit të fundit të popullsisë mund t'i drejtohen organeve republikane në gjuhën e vet dhe kanë të drejtë të marrin përgjigje në atë gjuhë (neni 11 paragrafi 7) *Ratio* e kësaj dispozite e përcjell edhe dispozita e nenit 11 paragrafi 8 e cila përcakton të drejtën e deputetëve të pjesëtarëve të pakicave kombëtare të cilat përmbushin regjistrimi në përmendur prej 2% që në Kuvendin Popullor të flasin në gjuhë të vet.

në pah se edhe nga këndvështrimi i të drejtës krahasimore kriteri prej 15% është jashtëzakonisht i ulët. Në Burgenland dhe Carinthia (Austri) kjo përqindje është 20 deri 25% të popullsisë. Në Zvicër, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se gjuha e "pjesës më të madhe të popullatës" duhet të merret parasysh. "Pjesa më e madhe e popullsisë" ekziston kur përqindja e një grupi në një komunë i afrohet përqindjes prej 50%. Për shkak të kompleksitetit të shumëgjuhësisë zyrtare, futja e një gjuhe të pakicave si gjuhë zyrtare mund të arsyetohet vetëm nëse një numër i caktuar i pjesëtarëve të një pakice flasin gjuhën e vet. Si kriter për futje të obligueshme të një gjuhe si gjuhë zyrtare Ligji për pakica e bazon në rezultatet e regjistrimit të popullatës, por merr parasysh vetëm të dhënat mbi përkatësinë kombëtare të një pakice, por jo edhe të dhënat për numrin e personave të cilat flasin gjuhën e pakicave. Të dhënat nga regjistrimi flasin për një dallim domethënës midis numrit të pjesëtarëve të një pakice dhe numrit të personave të cilët flasin gjuhën e asaj pakice. Kështu është e mundur që kriteri prej 15% të popullsisë së një komune të cila deklarohen si pjesëtarë të një pakice të arrihet, por që numri i folësve të gjuhës së tyre të jetë shumë më i ulët. Përdorimi zyrtar i një gjuhe të pakicave mund të jetë i dobishëm vetëm për folësit e asaj gjuhe. Pjesëtarëve të pakicave të ciltët nuk flasin gjuhën e kësaj pakice mundësia e përdorimit të asaj gjuhe të pakicave para organeve shtetërore nuk iu sjell kurrfarë lehtësimi. Prandaj kriteri prej 15% në një komunë duhet t'i referohet numri të folësve të një gjuhe, dhe jo numrit të pjesëtarëve të një pakice kombëtare. Përndryshe, në praktikën krahasuese nuk haset vetëm një kriter (i përqindjes) për futjen e gjuhës së pakicës si gjuhë zyrtare, por merren shumë kritere të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative."

3.3. *Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare*

Duke marrë parasysh se e drejta në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit paraqet një prej të drejtave të autonomisë kulturore, për realizimin e kësaj të drejte me rëndësi është edhe Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare, pasi që autonomia kulturore realizohet në rend të parë përmes këtyre organeve.

Me këtë ligj rregullohen çështje të ndryshme të cilat janë relevante për punën efikase të këshillave nacionale të pakicave kombëtare prej të cilëve vlejné çështje të përmendura statusore të këshillave nacionale (neni 7-9), kompetencat e tyre (neni 10, neni 24), marrëdhëniet me organet publike (neni 25-26), përzgjedhja e anëtarëve (neni 29-111) si dhe financimi i këshillave nacionale (neni 112-119).

Kompetencat e këshillave nacionale në kuptim të përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare Ligji i rregullon në nenin 22. Kompetencat që parashihen me nenin 22 të Ligjit mund të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë janë kompetencat e këshillave nacionale të cilat në përgjithësi iu referohen përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave, ndërsa në grupin e dytë mund të klasifikohen kompetencat e veçanta të cilat merren ekskluzivisht me shenjat topografike. Këshilli nacional i kontribuon realizimit të përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave ashtu që: a) vendos mbi përcaktimin e gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare si gjuhë zyrtare në njësinë e vetëqeverisjes lokale (neni 22, pika 3); b) i propozon organit kompetent ushtrimin e mbikëqyrjes lidhur me përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare (neni 22 pika 6); c) i propozon organeve kompetente masat dhe aktivitetet për avancimin e përkthimit të dispozitave në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar (neni 22 pika 7); d) ndërmerr masa dhe aktivitete për avancimin e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare (neni 22 pika 8). Kompetencat e këshillit kombëtar në kuptim të shenjave topografike iu referohen para se gjithash të drejtës së tij për të përcaktuar emërtimet tradicionale të njërive të vetëqeverisjes lokale, vendbanimeve dhe emërtimeve të tjera gjeografike në gjuhën e pakicës kombëtare, nëse në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale apo të vendbanimit gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar (neni 22 pika 1) dhe i propozon organit kompetent paraqitjen e këtyre emërtimeve (neni 22 pika 2). Përveç kësaj këshilli kombëtar propozon ndryshimin e emërtimeve të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, vendbanimeve të vogla, pjesëve të tjera dhe instituteve për të cilat është konstatuar se janë të rëndësishme të veçantë për pakicën kombëtare (neni 22 pika 4) dhe jep mendim mbi procedurën e përcaktimit të emërtimeve të rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, vendbanimeve të vogla, fshatrave të vogla dhe pjesëve të tjera të vendbanimeve, nëse në territorin e njësisë vetëqeverisës apo vendbanimit gjuha e pakicave kombëtare është në përdorim zyrtar (neni 22 pika 5).

4. *Rregulloret e Krahinës Autonome të Vojvodinës*²⁰

²⁰ Në një pjesë të Republikës së Serbisë, në Kosovë dhe Metohi, mbi të cilën në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara numër 1244 përgjegjësinë ka marrë bashkësia ndërkombëtare (UNMIK-u në aspektin civil, ndërsa NATO në atë ushtarak). Duke qenë se të drejtat dhe liritë e qytetarëve në Kosovë dhe Metohi nuk realizohen përmes organeve të Republikës së Serbisë (përveç në një pjesë më të vogël), nuk ekzistojnë as

Kushtetuta e Serbisë në nenin 183 paragrafi 3 parasheh që krahinat autonome kujdesen për “realizimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave në përputhje me ligjin”. Përveç kësaj, *Kushtetuta* iu lejon mundësinë krahinave autonome që me rregulloret e veta, e në bazë të ligjit, të përcaktojnë të drejta shtesë për pjesëtarët e pakicave kombëtare (neni 79 paragrafi 2 i *Kushtetutës*). Dispozitat e Krahinës Autonome të Vojvodinës (në tekstin e mëtejme: KA e Vojvodinës) paraqesin një bazë të rëndësishme ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare pasi që shpesh përpunojnë apo rregullojnë disa çështje të cilat në nivelin republikan nuk janë rregulluar, janë rregulluar në mënyrë të paqartë apo vetëm në mënyrë deklarative. Mungesa e nën-akteve relevante ligjore në nivelin e pushtetit qendror, i cili në nivelin krahinor zëvendësohet me rregullativën krahinore, në masë të madhe është arsye për ekzistimin e dallimeve faktike midis Vojvodinës dhe Serbisë qendrore në kuptim të cilësisë së mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të pakicave kombëtare.

Përveç *Kushtetutës*, akti themelor nga i cili KA e Vojvodinës nxjerr kompetenca në sferën e mbrojtjes së pakicave kombëtare, e së këndejmi edhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave, është Ligji i veçantë me të cilin përcaktohen kompetencat e krahinës autonome. Ligji i parë i tillë është miratuar në vitin 2002 dhe si objekt kishte përcaktimin e kompetencave të caktuara të Krahinës autonome (*Gazeta Zyrtare e RS-së, nr. 6/2002, 101/2007 – ligji i dytë dhe 51/2009*). Pas miratimi të *Kushtetutës* së Serbisë dhe nevojës që pozita juridike e Vojvodinës t’i përshtatet kornizës së re kushtetuese, në vitin 2009 është miratuar Ligji i ri mbi përcaktimin e kompetencave të Krahinës Autonome të Vojvodinës (*Gazeta Zyrtare e RS-së, nr 99/2009*).

Të dy ligjet parashohin kompetencat e KA të Vojvodinës në lëminë e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare. Në këtë aspekt, KA e Vojvodinës ka dy përgjegjësi themelore – që të rregullojë më për së afërmi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në territorin e vet²¹, me ç’rast është lidhur dhe kufizuar nga ligji²², dhe, si një kompetencë të deleguar²³, të bëjë mbikëqyrjen e kësaj lëmie²⁴.

Përveç ligjit, çështja e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave në KA të Vojvodinës rregullohet edhe me Statutin e vet, si aktin më të lartë juridik krahinor. Deri në 14 dhjetor 2009 statuti në fuqi i KA të Vojvodinës ishte akti i vitit 1991 (*Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës, nr. 17/91*). Sipas nenit 6 të Statutit të vitit 1991, në punën e organeve krahinore, paralelisht me gjuhën “serbokroate”, në përdorim zyrtar ishin: gjuha hungareze, sllovaqe, rumune, rusine dhe shkrimet e tyre. Prandaj, në këtë aspekt, neni 10 pika 4 e këtij Statuti parashihte që KA e

kushtet faktike për realizimin e kompetencave të Mbrojtësit të Qytetarëve në territorin e Kosovës dhe Metohisë, dhe prandaj situata e atjeshme nuk është objekt i shqyrtimeve të mëtejme në këtë dokument.

²¹ Neni 18 paragrafi 1 pika 1 e Ligjit të vitit 2002 dhe neni 76, paragrafi 1 i Ligjit të vitit 2009.

²² Ligji i vitit 2002 orienton në ligjin me të cilin rregullohet përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit, ndërsa ligji i vitit 2009 e përdor shprehjen ligj si një nocion të përgjithshëm.

²³ Neni 18 paragrafi 2 i Ligjit të vitit 2002 dhe neni 76 paragrafi 3 i Ligjit të vitit 2009.

²⁴ Ligji i vitit 2002 shprehimisht parasheh që KA e Vojvodinës ushtron mbikëqyrje mbi aplikimin e dispozitave me të cilat rregullohen çështje të cekura (neni 18 paragrafi 1 pika 1), si dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit (neni 18 paragrafi 1 pika 2), ndërsa Ligji i vitit 2009 vlet vetëm për ushtrimin e „mbikëqyrjes inspektuese“, në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet përdorimi i gjuhës dhe shkrimit (neni 76 paragrafi 2).

Vojvodinës, përmes organeve të tyre, siguron përdorimin zyrtar të këtyre gjuhëve dhe shkrimeve. Statuti gjithashtu parashihte kompetencat e KA të Vojvodinës që, në përputhje me *Kushtetutën* dhe ligjin, të sjellin vendime dhe akte të përgjithshme me të cilat “rregullojnë çështje të caktuara me interes për qytetarët në KA të Vojvodinës në lëminë e përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit të kombësive “ (neni 10 pika 3). Statuti shprehimisht parashihte edhe të drejtën që deputetët në Kuvend të përdorin gjuhën dhe shkrimin përdorimi zyrtar i të cilëve përcaktohej me Statut (neni 26). Përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave është parashikuar edhe në raport me publikimin e akteve²⁵ në *Gazetën Zyrtare të KA të Vojvodinës*, pasi që Statuti në nenin 46 paragrafi 3 parashihte që këto të publikoheshin edhe në gjuhën hungareze, sllovaqe rumune dhe rusine.

Statuti aktual i KA të Vojvodinës (*Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 17/2009) proklamon shumëgjuhësinë si një prej vlerave të përgjithshme me rëndësi të veçantë për KA të Vojvodinës (neni 7 paragrafi 1) dhe urdhëron organet dhe organizatat krahinore që të ndihmojnë në ruajtjen e shumëgjuhësisë, si dhe që me masat dhe aktivitetet e veçanta të ndihmojnë, ndër të tjera, edhe njohjen e gjuhëve të ndryshme në KA të Vojvodinës (neni 7 paragrafi 2). Statuti në nenin 26 paragrafin 1 përcakton gjuhët dhe shkrimet të cilat janë në përdorim zyrtar në organet dhe organizatat krahinore sjell një risi në raport me Statutin e mëhershëm ashtu që në përdorimin zyrtar përfshin edhe gjuhën kroate. Pra, në përdorim zyrtar janë: gjuha serbe dhe shkrimi cirilik, hungareze, sllovaqe, kroate, rumune dhe gjuhët rusine dhe shkrimet e tyre. Në këtë kontekst, Statuti iu referohet ligjit dhe vendimit të Kuvendit provincial. Neni 26 në paragrafin 3 parasheh mundësinë e përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave të cilat nuk janë të cekura në paragrafin 1, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjin dhe të vendimit të Kuvendit krahinor.

Në pjesën e Statutit i cili i referohet kompetencave të KA të Vojvodinës gjithashtu paraqitet lëmia e përdorimit të gjuhëve, dhe atë në nenin 27 alineja 5 sipas të cilit KA i Vojvodinës rregullon përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit në organet dhe organizatat të cilat i ka themeluar, dhe në nenin 29, pika 14 alineja, sipas të cilit, në përputhje me ligjin, përcakton më për së afërmi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare. Sa i përket publikimit të akteve²⁶ në *Gazetën Zyrtare të KA të Vojvodinës*, Statuti parasheh që ato të publikohen në të gjitha gjuhët në përdorim zyrtar në punën e organeve krahinore, dhe në rast të mospërputhjeve teksti në gjuhën serbe konsiderohet meritore (neni 65 paragrafi 3). Statuti gjithashtu parasheh autonominë e pakicave kombëtare në sferën e përdorimit të gjuhëve (neni 25 paragrafi 1), si dhe mundësinë që KA i Vojvodinës t’i besojë ushtrimin e punëve të caktuara këshillave kombëtare të pakicave kombëtare (neni 25 paragrafi 2). Risinë domethënëse Statuti e sjell në raport me themelimin e institucionit të Këshillit të bashkësive kombëtare si organit të veçantë punues të Kuvendit Krahinor (Neni 40 i Statutit). Relevanca e këtij organi punues për lëminë e përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave është që Kuvendi krahinor, gjatë zgjidhjes së

²⁵ Statuti, vendimi dhe akti i përgjithshëm i Kuvendit, dhe kur kjo parashihet shprehimisht, edhe akti i Këshillit Ekzekutiv të organit krahinor qeverisës.

²⁶ Statuti, vendime e Kuvendit krahinor dhe aktet e përgjithshme të Komunës, si dhe rregulloret dhe vendimet krahinore të Qeverisë Krahinore, dhe aktet tjera të Qeverisë krahinore, si dhe aktet e administratës krahinore, atëherë kur kjo shprehimisht parashihet (neni 65 paragrafi 1 dhe 2).

çështjeve të caktuara, e të cilat ndër të tjera i referohen përdorimit zyrtar të gjuhës, duhet të merr mendimin e Këshillit të pakicave kombëtare (neni 40 paragrafi 7 i Statutit).

Acti domethënës me të cilën rregullohet çështja e përdorimit të gjuhëve të pakicave është Vendimi mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara me të cilat rregullohet çështja e përdorimit të gjuhëve të pakicave është Vendimi mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të përdorimit të gjuhëve të pakicave kombëtare në territorin e KA të Vojvodinës (*Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 8/03 i 9/03), të cilën Kuvendi i Vojvodinës e ka miratuar në vitin 2003. Me këtë vendim më për së afërmi rregullon mënyra e realizimit të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në punën e organeve krahinore si dhe organeve dhe organizatave lokale, si dhe në punën e njësive organizative të organeve të administratës shtetërore, ndërmarrjeve republikane dhe lokale të ndërmarrjeve publike, instituteve dhe shërbimeve; të drejtën në përdorimin e emrit personal të pjesëtarëve të pakicave kombëtare; lëshimi i dokumenteve personale dhe dokumenteve të tjera të cilat janë me interes për realizimin e të drejtave të qytetarëve të përcaktuara me ligj; përdorimi i gjuhës në sferën e ekonomisë dhe shërbimeve; shkrimi i emërtimeve topografike dhe të tjera; publikimi i thirrjeve publike, njoftimeve dhe paralajmërimeve për popullatën si dhe shkrimi i mbishkrimeve të tjera publike; kushtet për futjen e përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në njësitë e vetëqeverisjeve lokale; parashtrimi i raporteve Kuvendit të KA të Vojvodinës mbi realizimin e të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare (neni paragrafi 1 i Vendimit). Me vendim nuk rregullohet, dhe dispozitat e tij në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare në procedurat administrative dhe gjyqësore (neni 1 paragrafi 2 i Vendimit).

Gjykata Kushtetuese e RS-së në qershor të vitit 2010 ka sjellë Vendimin (*Gazeta Zyrtare e RS-së nr. 69/2010*) me të cilën është përcaktuar që paragrafi 3 i nenit 6 të Vendimit mbi rregullimin më të afërm të çështjes së përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në territorin e KA të Vojvodinës nuk është në përputhje me ligjin. Sipas mendimit të Gjykatës me paragrafi me të cilin parashihet që „emërtimet e këshillave kombëtare, organizatave shoqërore, shoqatave dhe instituteve të pjesëtarëve të pakicave kombëtare (organizatat nacionale), në territorin ku gjuha e asaj pakice kombëtare është në përdorim publik përjashtimisht mund të shkruhen edhe para tekstit në gjuhën serbe“ ndryshohet në „renditjen e gjuhëve të parashikuar me ligj të shkrimit të emërtimeve të organizatave nacionale në territorin ku gjuha e asaj pakice kombëtare është në përdorim zyrtar.“²⁷

Për praktikën e përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave relevante është edhe Vendimi krahinor mbi formularët shumëgjuhësor të certifikatave të librave amë dhe mbi mënyrën e regjistrimit të tyre (*Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 1/01 dhe 8/03). Ashtu siç tregon titulli i Vendimit, subjekt i rregullimit të saj është çështja e lëshimit të certifikatave dhe vërtetimeve nga librat amë në gjuhët e pakicave kombëtare, si dhe mënyra e regjistrimit në këtë libra në territorin e Vojvodinës. Duhet të vihet në dukje se ky vendim, pa marrë parasysh se faktikisht ishte shfuqizuar pas miratimit të Ligjit mbi librat amë dhe Udhëzimit mbi mbajtjen e librave amë

²⁷ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Serbisë IU-394/2005

ende kanë fuqi ligjore në Vojvodinë, e cila çon në një konfuzion në lidhje me ushtrimin e të drejtave të qytetarëve.

Në fund, me rëndësi për rregullimin e të drejtave për përdorim të gjuhës së pakicave kombëtare në KA të Vojvodinës janë edhe Vendimi krahinor i Kuvendit mbi administratën krahinore (Gazeta Zyrtare e Krahinës Autonome të Vojvodinës, nr. 04/10), ku me nene 26-33 është përpunuar përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe shkrimeve zyrtare në punën e organeve të administratës krahinore, si dhe Vendimi i Kuvendit krahinor mbi Qeverinë e Krahinës Autonome të Vojvodinës (Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës, nr. 04/10), e cila në nenin 28 rregullon kompetencat e anëtarit të qeverisë krahinore në lidhje me përdorimin e gjuhës dhe shkrimin të pakicave kombëtare.

5. Aktet e njësive të vetëqeverisjeve lokale

Edhe pse nuk kanë kompetenca publike të domosdoshme për rregullimin e të drejtës së pjesëtarëve të pakicave kombëtare, njësitë e vetëqeverisjes lokale janë njësi territoriale në të cilat faktikisht realizohen të drejtat e pakicave kombëtare dhe së këndejmi edhe e drejta në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimin. Kështu, në *Kushtetutë* në nenin 190, paragrafi 3, komunës, gjegjësisht qytetit, i besohet kujdesi mbi realizimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave. Kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale në kuptim të realizimit të të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare rregullon me Ligjin për vetëqeverisjes lokale (Gazeta zyrtare e RS-së, nr. 129/2007). Sipas dispozitave të këtij ligji komuna kujdeset për realizimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave individuale dhe kolektive të pjesëtarëve të pakicave kombëtare dhe grupeve etnike, përcakton gjuhët dhe shkrimet e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar në territorin e komunës, dhe ka kompetenca edhe në kuptim të informimit publik në gjuhët e pakicave kombëtare (neni 20 pika 32 – 34).

Duke marrë parasysh se realizimi i të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare kushtëzohet me futjen formale të gjuhës në përdorim zyrtar, kompetencat të cilat njësia e vetëqeverisjes lokale i ka në këtë aspekt janë të rëndësishme thelbësore për aplikimin e kësaj të drejte. Në përputhje me nenin 11, paragrafi 2 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimin, komunat me statutin e vet përcaktojnë gjuhën dhe shkrimin, gjegjësisht gjuhët dhe shkrimet e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar në komunë. Prandaj, statuti faktikisht është akti qendror juridik me të cilin plotësohen parakushtet për zbatimin e garancive kushtetuese, ligjore dhe krahinore në kuptim të përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicës kombëtare. Përveç përcaktimit të gjuhës së pakicave kombëtare të cilat janë në përdorimin zyrtar në qytet gjegjësisht në komunë, statuti mund të përmbajë edhe dispozita të tjera relevante të cilat janë në lidhje direkte me realizimin dhe rregullimin më të afërt të kësaj të drejte: dukjes së vulës, kompetencat mbi përcaktimin e pjesëve të vendbanimeve, rrugëve, shesheve, lagjeve të qytetit, kompetencave në kuptim të sigurimit të shkrimin të shenjave

topografike, njoftimeve dhe mbishkrimeve publike, të drejtave të deputete që në kuvendin lokal të flasin në gjuhët në përdorim zyrtar, apo të botojnë akte në gazeta zyrtare²⁸.

²⁸ Statutet e qyteteve dhe komunave nuk janë të njëjta, gjë që rrjedh nga parimi i autonomisë së vetëqeverisjes lokale, ashtu që nuk e rregullojnë në mënyrë të njëjtë zbatimin e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare (krahason Statutin e qytetit të Zrenjaninit (*Gazeta zyrtare e qytetit të Zrenjaninit*, nr. 21/2008), Statutin e qytetit të Suboticës (*Gazeta zyrtare e komunës së Suboticës*, nr. 26/2008, 27/2008-të ndryshuar), Statutin e Qytetit të Novi Pazarit (*Gazeta Zyrtare e Komunës së Novi Pazarit*, nr. 14/2008 dhe *Gazeta Zyrtare e qytetit të Novi Pazarit*, nr. 7/2009)).

III Gjuhët në Republikën e Serbisë

Në regjistrimin e fundit (2002) është konstatuar se, përveç komunitetit etnik serb në Serbi jetojnë edhe qytetarët që u përkasin 28 grupeve të ndryshme etnike. Inferioriteti numerik i shumicës së këtyre grupeve bën që disa prej gjuhëve të përdoren në disa komunitete rurale dhe në nivel të komunikimit privat, por tetë gjuhët e pakicave kombëtare janë në përdorim zyrtar në nivele të ndryshme. Gjatë ratifikimit të *Kartës Evropiane për gjuhët rajonale ose minoritare*, Serbia e ka pranuar aplikimin e masave në lidhje me gjuhën shqipe, boshnjake, bullgare, hungareze, rome, rumune, rusine, sllovaqe, ukrainase dhe atë kroate (neni 3, paragrafi 1 të Ligjit për ratifikimin e Kartës Evropiane). Përsa i përket interpretimit të frazës "territorit në të cilin gjuhët rajonale ose minoritare janë në përdorim" Serbia ka bërë një deklaratë se kjo vlen për trevat ku gjuhët rajonale ose të pakicës janë në përdorim zyrtar në përputhje me legjislacionin kombëtar (neni 3, paragrafi 2 i ligjit për ratifikimin e Kartës Evropiane). Dy deklaratatë të cilat janë dhënë në kohën e ratifikimit nuk janë në harmoni të plotë, sepse gjuhët rome dhe ukrainase nuk janë në përdorim zyrtar në asnjë njësi të qeverisjes lokale (qoftë në tërë territorin apo në ndonjë pjesë të tij), e cila ngre pyetjen se si Serbia mund të zbatojë angazhimet marrë përsipër, kur nuk ekzistojnë parakushtet elementare për këtë.

Përkundër kësaj, gjuha çeke dhe maqedonase, të cilët janë në vënë në përdorim zyrtar, nuk përfshihen me ratifikimin. Ligji mbi ratifikimin nuk vë në pah as raportin e shtetit ndaj gjuhëve të cilat i flasin pjesëtarët e pakicës kombëtare bunjevase dhe vllahe.

Gjuha dhe shkrimi hungarez janë në përdorim zyrtar në njësitë e vetëqeverisjes lokale në KA të Vojvodinës²⁹, në punën e organeve dhe organizatave të KA të Vojvodinës, e duke marrë parasysh se numri i pjesëtarëve të pakicës kombëtare hungareze tejkalon pragun ligjor prej 2%, gjuha hungareze do të duhej të përdorej edhe në adresimin tek organet republikane krahas të drejtës që përgjigja të shkruhet në këtë gjuhë dhe shkrim. Gjuha dhe shkrimi sllovak janë në përdorim zyrtar në 13 qytete dhe komuna³⁰, rumune në dhjetë³¹, rusine në gjashtë³², ndërsa kroate në katër³³. Sipas Statutit të Vojvodinës të vitit 2009 në të gjitha gjuhët janë edhe në

²⁹Në qytetet/komunat Ada, Baç, BackaTopola, Bela Crkva, Bečej, Çoka, Kanjizhë, Kovačić, Kovin, Kulla, Malli Igjosh, Nova Crnja, Novi Beqej, NoviKneževac, NoviSad, Ogjaci, Pllandishte, Senta, Seqanj, Sombor, Srbobran, Suboticë, Temerin, Titel, Vrbas, Vrshac, Zrenjanin, Zhitishte në tërë territorin, ndërsa në komunën Apatin në vendbanimet Kupusnadhe Svilojevo, komuna Kikinda në lokalitetet Banatska Topolla, Kikinda, Rusko Sello dhe Sajan, në qytetin e Pançevës në vendbanimin e Ivanovës dhe në komunën kadastrale Vojlovica në vendbanimin Pancevo.

³⁰ Në qytetet/komunat Alibunar, Baq, Baqki Petrovac, Baqka Pallanka, Kovaqica, Novi sad, Oxhaci, Pllandishte, Shid dhe Zrenjanin në tërë territorin, ndërsa në komunën Baqka Topollë në vendbanimin Bajsha, në komunën Beoqin në vendbanimin Llug, në komunën Stara Pazova në vendbanimin Stara Pazova.

³¹ Në qytetet/komunat Alibunar, Bella Ckrva, Kovaqica, Kovin, Pllandishte, Seqanj, Vrshac, Zrenjanin dhe Zhitishte në tërë territorin, ndërsa në qytetin e Pançevës në territorin e vendbanimit Banatsko Novo Sello.

³² Në qytetet/komunat Kulla, Novi Sad, Shid, Vrbas, Zhabalj në tërë territorin, ndërsa në komunën Baqka Topolla në vendbanimin Novo Orahovo.

³³ Në tërë territorin e qytetit të Suboticës, ndërsa në komunën Apatin në vendbanimin Sonta, në qytetin e Somborit në vendbanimin Baqki Monoshtor dhe Baqki Breg në komunën Sremska Mitrovica në vendbanimin Stara Bingulla.

përdorim zyrtar në punën organeve dhe organizatave krahinore. Në territorin e KA të Vojvodinës janë të pranishme edhe gjuha dhe shkrimi çek, të cilat janë në përdorim zyrtar në komunën e Bellacërkvës, dhe gjuha dhe shkrimi maqedonas të cilat janë në përdorim zyrtar në zgjidhjen vendbanimin e Jabukas i cili hyn në përbërjen e qytetit të Panqevës dhe në bashkësinë lokale të Duzhinës në komunën Pllandishte.³⁴ Në disa qytete dhe komuna në Serbinë qendrore në përdorim zyrtar janë gjuha shqipe, boshnjake dhe bullgare. Gjuha shqipe është në përdorim zyrtar në komunat e Bujanovcit, Preshevës dhe Medvegjës, gjuha boshnjake në qytetin e Novi Pazarit dhe komunave Prijepolje, Sjenica dhe Tutin, ndërsa gjuha bullgare në komunat Bosilegrad dhe Dimitrovgrad. Gjuha bullgare është në përdorim zyrtar edhe në vendbanimin e Ivanovës, e cila është në territorin e qytetit të Panqevës.

Gjuha rome, edhe pse është renditur në mesin e gjuhëve për të cilat shteti është obliguar që të zbatohet masat e pranuar me ratifikimin e *Kartës Evropiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave*, nuk është në përdorim zyrtar në asnjë njësi të vetëqeverisjes lokale. Në regjistrimin e popullatës të vitit 2002, 108.193 qytetarë të Serbisë janë deklaruar si Romë, gjë që këtë pakicë kombëtare e rendit në të tretën sipas numrit në Serbi (pas asaj hungareze dhe boshnjake), por shpërndarja e popullsisë vë në pah një shkapërderdhje të madhe të romëve që të vështirëson realizimin e të drejtës në mbrojtje të identitetit që ndërliiden me një përqindje të caktuar të popullsisë në njësinë e vetëqeverisjes lokale. Në fakt, romë në asnjë qytet apo komunë nuk kanë arritur pragun prej 15% të popullsisë së përgjithshme të cilin Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare e paraqet si prag për futjen e obligueshme të gjuhës në përdorim zyrtar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale.

Në komunat në jug të Serbisë, në Bojnik (10,38%), Surdulicë (9,55%) dhe Bujanoc (8,99%) është përqindja më e madhe e popullsisë rome, por që gjuha rome të jetë në përdorim zyrtar është e domosdoshme të zbatohen masat afirmative, por edhe programe të luftimit të paragjytimeve.

Problemi potencial është edhe fakti që, po që se gjuha rome të futej në përdorim zyrtar, nuk ekzistojnë kapacitetet për zbatimin e denjë të kësaj të drejte. Në fakt, pavarësisht se shumica e shteteve të Evropës qendrore, ballkanike dhe shtete të tjera evropiane e kanë tejkaluar problemin e standardizimit të gjuhës rome dhe e kanë futur këtë gjuhë në edukimin publik, në Serbi debati për këtë është ende i hapur. Gjuha rome ende ndodhet në proces të standardizimit, ndërsa dallimet dialektike, edhe pse nuk janë problem për kuptimin funksional, janë pengesë për miratimin e një politike të unifikuar të romëve në Serbi.

Megjithatë gjuha rome, në kuadër të shkollimit fillor, mësohet në disa shkolla në Vojvodinë, si një lëndë zgjedhore "gjuha amtare me elementet e kulturës nacionale"³⁵. Mësimi i gjuhës rome në nivele më të larta të arsimimit gati që edhe nuk ekziston, dhe prandaj parashtrohet edhe pyetja e kuadrit përkatës edukativ për gjuhën rome. Përveç kësaj, edhe niveli i përgjithshëm i shkollimit të Romëve është mjaft i ulët. Shkollën fillore e regjistron rreth 60% të fëmijëve romë, ndërsa e përfundojnë më pak se gjysma, ndërsa shkollën e mesme e përfundojnë vetëm 10% të

³⁴ Të dhënat për gjuhët që janë në përdorim zyrtar në qytetet dhe komunat vojvodinase janë dhënë sipas Sekretariatit krahinor për rregulloret, administratën dhe pakicat kombëtare, janë në dispozicion edhe në internet në <http://www.puma.vojvodina.gov.rs/dokumenti/ostalo/sljezik.pdf>.

³⁵ *Shkollat fillore në KA të Vojvodinës*, Sekretariati krahinor për arsim, <http://www.obrazovanje.Vojvodina.gov.rs/>.

fëmijëve romë. Pengesat kryesore janë politika e papërshtatshme edukative, interesimi i pamjaftueshëm i shtetit që të zgjidh problemin e shkollimit në gjuhën rome, mungesa e të dhënave të vlefshme për fëmijët romë, mungesa e motivimit dhe paragjykimet.

Problemet, në lidhje me politikën gjyqësore, ekzistojnë edhe në raport me pakicën kombëtare bunjevase. Bunjevasët për nga feja janë katolikë, flasin një të folur shtokave-ikave, dhe sot më së shumti janë të vendosur në Suboticë dhe Sombor. Edhe pse gjuha “bunjevase” mund të dëgjohet në emisionet në radio dhe televizion, si dhe të lexohet në gazeta të veçanta³⁶, kjo gjuhë ende nuk është në përdorim zyrtar në asnjë njësi të vetëqeverisjes lokale³⁷.

Kontesti se me cilën gjuhë flasin – rumune apo vllahe është pengesa kryesore për futjen e gjuhës së pakicës kombëtare në përdorim zyrtar. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, pjesa më e vogël e popullsisë deklaruar se i takon pakicës kombëtare vllahe (39.953), në raport me ata të cilat janë deklaruar se flasin gjuhën vllahe (54.742).

Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare vllahe ka vendosur që gjuha zyrtare e vllahëve është gjuha rumune. Vendimi është marrë me mbivotim dhe ka shkaktuar kundërtënie në bashkësinë vllahe, që vë në pah rezistencë dhe rezerva të caktuara. Nga njëra anë, thuhet se me pranimin e gjuhës rumune do të rrezikohet identiteti special kolektiv (regjional) i vllahëve. Një argument që shpesh përmendet kundër pranimit të gjuhës rumune është se e folura vllahe dhe gjuha standarde rumune dallojnë aq shumë sa që vllahët do të duhej të mësonin gjuhën rumune, dhe prandaj futja e gjuhës rumune nuk do t'i shërbente qëllimit të ruajtjes së gjuhës së pakicës kombëtare vllahe. Në anën tjetër, një pjesë e bashkësisë vllahe pa mëdyshje vë në pah origjinën rumune të grupit dhe synon të lidhet më fortë me kulturën dhe ndikimin e amzës.

Nga këndvështrimi i Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare dhe Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare, vendimi i Këshillit nacional të pakicës kombëtare vllahe është legal, por mangësia e tij themelor është në konstruksionin e dobët të

³⁶ Radio emisionet në kohëzgjatje prej gjysmë ore në javë në Radio Novi Sad, emisioni gjysmëorësh *Cross Culture* e cila emitohet njëherë në javë në Radio Sombor dhe emisioni njëorësh *Bunjevaqka rijeq* (Fjala Bunjevase) e cila emitohet një herë në javë në radio suboticase 103. Emisioni televiziv në gjuhën bunjevase në kohëzgjatje prej një ore emitohet një herë në muaj në RT Vojvodina. Mediat e shkruara në gjuhën bunjevase janë *Riq mamice* revistë dymujore, mujorja *Bunjevaqke Novine* (Gazeta Bunjevase) dhe fletushka për fëmijë *Tandraqak*. Sipas *Raportit të dytë periodik të Republikës së Serbisë mbi aplikimin e Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*, janar 2008, faqe 159, 186.

³⁷ Në raportin Alternativ mbi zbatimin e *Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*, të cilin në shtator të vitit 2007 e kishte hartuar Qendra Vojvodinase për të drejtat e njeriut, Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare bunjevase ka parashtruar vërejtje se në Suboticë në përdorim zyrtar ishte futur gjuha kroate, por jo edhe ajo bunjevase, edhe pse sipas regjistrimit të popullsisë asnjëra nga këto bashkësi nuk arrin pragun prej 15% të cilin e parashtron Ligji si kusht për futjen e gjuhës në përdorim zyrtar. Në regjistrimin e cekur, 12% të banorëve të Suboticës janë deklaruar si Kroatë, ndërsa 11,6% si Bunjevacë, me ç'rast në përdorim zyrtar është futur vetëm gjuha kroate dhe atë përmes institutit të të drejtave të arritura, që është arritur duke iu falënderuar pjesëmarrjes së Lidhjes Demokratike të Kroatëve të Vojvodinës në koalicionin politik në pushtet. Përveç kësaj, Bunjevacët banojnë në katër bashkësi lokale në Vojvodinë në përqindje më të madhe se 25% dhe plotësojnë kushtin për futjen e gjuhës në përdorim zyrtar, por kjo nuk është realizuar. Qendra Vojvodinase për të drejtat e njeriut, Raporti alternativ mbi aplikimin e *Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare*, shtator 2007, fq. 70 dhe 71. Në dispozicion edhe në internet faqen http://www.vojvodina-hrc.org/images/stories/alternativni_izvestaj_o_primeni_okvirne_konvencije_u_vojvodini.pdf

legjitimitetit gjegjësisht në mbështetjen më të madhe të pjesëtarëve të pakicës kombëtare vllahe. Pa dyshim se fjala është për një problem i cili prek identitetin e bashkësisë dhe çdo presion nga jashtë, institucional apo joformal cenon lirinë kushtetuese të shprehjes së përkatësisë kombëtare. Para bashkësisë vllahe dhe Këshillin e tyre nacional janë sfidat dhe vendimet të cilat do të përcaktojnë ruajtjen apo ndryshimin e identitetit të bashkësisë. Deri atëherë, do të duhet të kishim parasysh të paktën dy obligime: a) të shfrytëzohet mundësia e mbrojtjes së gjuhës autoktone të folur vllahe si një thesar gjuhësor të Evropës dhe b) t'i mundësohet pakicës kombëtare vllahe që të realizojë të drejtat në autonomi të kulturës, që nënkupton të drejtën në shkollim në gjuhën e parë dhe të drejtën në përdorim zyrtar të gjuhës.

Nëse nuk ushtrohet kujdes i duhur, pjesëtarëve të pakicës kombëtare vllahe edhe më tej do t'iu cenohet e drejta që gjuha e tyre të jetë në përdorim zyrtar në komunat ku ata përbëjnë pjesë domethënëse të popullatës. Në përputhje me nenin 11 par. 2 të Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, që përcakton obligimin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, ku 15% e popullatës së përgjithshme përbëhet nga pakica, që në përdorim zyrtar të futet gjuha e asaj pakice, gjuha e pakicës vllahe do të duhej të ishte gjuhë zyrtare krahas gjuhës serbe në komunat Kuqevë (27,67%), Boljevac (26,26%), Zhagubicë (22,05%) dhe Bor (18,03%). Në asnjërën prej tyre gjuha e pakicës vllahe nuk është në përdorim zyrtar, formalisht sepse Këshilli nacional i pakicës vllahe nuk e ka kërkuar këtë, por edhe për shkak të qëndrimit pasiv të vetëqeverisjes lokale ndaj "problemit gjyqësor", gjegjësisht mbrojtjes së identitetit të vllahëve. Ç'është e vërteta, gjuha e pakicës përdoret në komunikimi gojor të organeve lokale dhe banorëve, pjesëtarëve të pakicës vllahe, pasi që edhe në mesin e të punësuar ka pjesëtarë të pakicës vllahe apo qytetarë që flasin gjuhën e rrethinës. Mirëpo, asnjë komunë në Serbinë juglindore nuk interesohet se sa ka pjesëtarë të pakicave të punësuar në vetëqeverisje lokale.

Problemin e futjes së gjuhës bunjevase dhe vllahe në përdorim zyrtar e ka vënë në pah edhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, i cili ndër rekomandimet mbi aplikimin e *Kartës Evropiane mbi gjuhën rajonale apo të pakicave* autoriteteve në Serbi u rekomandon të qartësojnë statusin e gjuhës bunjevase dhe vllahe në konsultim me përfaqësuesit e atyre që flasin këto gjuhë³⁸.

IV Futja e gjuhës në përdorim zyrtar

Futja e gjuhës së një pakice kombëtare në përdorim zyrtar në territorin e njësisë vetëqeverisëse është në kompetencë të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Sipas nenit 20, pika 33 e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 11 paragrafi 1 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe

³⁸ Recommendation RecChL(2009)2 of the Committee of Ministers on the application of the European Charter for Regional or Minority Languages by Serbia, 6. May 2009, p. 2. of Recommendation. http://www.coe.int/t/dg4/education/minlang/Report/Recommendations/SerbiaCMRec1_en.pdf

shkrimeve, komuna³⁹ përcakton gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare që janë në përdorim zyrtar në territorin e saj. Përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave përcaktohet me statutin e komunës (neni 11, paragrafi 2 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve), të cilin e miraton Kuvendi Komunal (neni 32, paragrafi 1 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale). Kuvendi me këtë rast nuk është plotësisht i lirë të vendos nëse një gjuhë e pakicave do të futet në përdorim zyrtar apo jo, por obligohet nga Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare (neni 11, paragrafi 2) të fus një gjuhë të pakicave në përdorim zyrtar nëse sipas rezultateve të regjistrimit të fundit pjesëmarrja e pakicave kombëtare në popullsinë e përgjithshme në komunë arrin 15%. Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale dhe në Ligji për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve, përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave e përcaktojnë në raport me tërë territorin e njësisë së pushtetit lokal. Mirëpo, vendimi i Kuvendit të Vojvodinës, mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të përdorimit të gjuhës dhe të shkrimit të pakicave kombëtare në Vojvodinë, parashihet përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave në edhe në pjesën e territorit të njësisë së vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht në vendbanimin apo në bashkësinë lokale në territorin e saj. Sipas nenit 8 paragrafi 3 të Vendimit, njësia e vetëqeverisjes lokale është e detyruar të fus në përdorim gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare në përdorim zyrtar në vendbanimin apo bashkësinë lokale në territorin e saj nëse në atë vendbanim apo bashkësi lokale përqindja e ndonjë pakice kombëtare arrin 25% sipas rezultateve të regjistrimit të fundit.

Obligimet e Kuvendit lokal gjatë vendosjes mbi gjuhën e pakicës kombëtare në përdorim zyrtar në territorin e tij (në tërësi ose në ndonjë pjesë) forcohet edhe nga institucioni i të drejtës së fituar. Domethënë, Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare (Neni 11, paragrafi 3), Ligjin mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve (neni i pavarur 7) dhe Vendimi i përmendur krahinor (neni 8, paragrafi 4) parashohin që gjuha e pakicave kombëtare e cila është futur në përdorim zyrtar në njësinë e vetëqeverisjes lokale mbetet në përdorim zyrtar edhe nëse përqindja pjesëmarrja e pjesëtarëve më nuk arrin pragun prej 15% (neni 7 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimit, 2010).

Edhe pse dispozitat e cekura janë të qarta, futja e gjuhëve të pakicave në përdorim zyrtar nuk është arritur gjithmonë pa probleme. Vështirësitë lindin në veçanti në zonat ku ka një distancë e theksuar ndër-etnike dhe ku marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike janë të ngarkuara me tensione.

Futja e gjuhës boshnjake në përdorim zyrtar në komunat në të cilat Boshnjakët janë më shumë se 15% të banorëve lokalë realizohet me rezistencë shoqërore dhe institucionale. Sa për ilustrim, në komunën e Pribojit gjuha boshnjake ende nuk është futur në përdorim zyrtar, edhe pse rezultatet e regjistrimit të fundit flasin se 18.33% të numrit të përgjithshëm janë Boshnjakë. Arsyet për këtë gjendje pjesërisht qëndrojnë edhe në paqartësitë e sistemit ligjor në lidhje me implementimin institucional të gjuhës boshnjake dhe qëndrimin të përhapur gjerësisht se Serbët dhe Boshnjakët në këtë pjesë të Serbisë flasin të njëjtën gjuhë dhe se nuk është e nevojshme ndarja artificiale e gjuhëve. Mirëpo, duhet të ceket që përkundër faktit që pushteti lokal boshnjak kishte ndërmarrë nisma për të futur gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare

³⁹ Të njëjtat kompetenca si komuna ka edhe qyteti.

në përdorim zyrtar, delegatët e kuvendit komunal nuk kanë marrë vendim për ndryshimin e nenit 5 të Statutit me të cilin përveç gjuhës serbe në përdorim zyrtar do të futej edhe gjuha boshnjake me shkrimin latin. Mbrojtësi i qytetarëve me rastin e ankesës së qytetarëve i kishte dërguar një Rekomandim Kryetarit të Kuvendit Komunal të Pribojit për të ndërmarrë të gjitha masat e parashikuara me ligj që kuvendit të sjell vendimin me të cilin do të mundësohej zbatimi i të drejtës *Kushtetuese* dhe ligjore e pjesëtarëve të pakicës kombëtare boshnjake në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit boshnjak.⁴⁰ Rekomandimi nuk është përfillur dhe as është vendosur bashkëpunimi i organeve komunale me Mbrojtësin e Qytetarëve⁴¹.

Më lartë është deklaruar tashmë se gjuha e pakicës kombëtare vllehe nuk është futur në katër komuna (Boljevac, Bor, Kuçevo dhe Zhagubica) në të cilin vllahët kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në popullsi dhe tejkalojnë pragun e përcaktuar me ligj prej 15%. Qeveritë lokale në këto komuna si një justifikim për mosfutjen e gjuhës së pakicës kombëtare vllehe japin kontestin mbi gjuhën i cili ekziston brenda vetë komunitetit vllah, si dhe nevojën që pushteti lokal në këtë mosmarrëveshje të mbajë një qëndrim neutral.

Në Vojvodinë në 39 njësi të vetëqeverisjes lokale gjuhët e pakicave kombëtare janë futur në përdorim zyrtar. Problemet lindin në lidhje me futjen e gjuhëve të pakicave kombëtare në pjesën e komunës – bashkësisë lokale apo vendbanimit - në komunën Inxhija dhe në vendbanimin Sllankamenaqki Vinogradi nuk është futur gjuha sllovaqe, në vendbanimin Dobrodol dhe Shatrinci në komunën Irig nuk është futur gjuha hungareze, ndërsa në vendbanimin sot në komunë Shid ajo kroate.

Në disa komuna vojvodinase kishte edhe probleme në kuptim të revokimit apo kufizimit të të drejtave të fituara. Në komunën Bačka Topolla, deri në miratimin e Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare dhe Vendimit mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në territorin e KA të Vojvodinës në përdorim zyrtar ishin gjuhët dhe shkrimet sllovaqe dhe rusinase. Pas sjelljes së Vendimit krahinor, autoritetet komunale duke interpretuar gabimisht dispozitat mbi kushtet demografike për futjen e gjuhës së pakicës kombëtare në përdorim zyrtar në tërë territorin gjegjësisht vetëm në vendbanimin apo bashkësinë lokale, kishin kufizuar përdorimin e gjuhës sllovaqe vetëm në vendbanimin Bajsha, ndërsa atë rusine në vendbanimin Novo Orahovo. I njëjti rast kishte ndodhur edhe në vitin 2003 në komunën Vrshac, kur Kuvendi komunal me ndryshimin e Statutit të komunës së atëhershme Vrshac, kishte hequr përdorimin zyrtar të gjuhës hungareze dhe rumune në tërë territorin e komunës dhe ka kufizuar përdorimin e këtyre gjuhëve vetëm në disa bashkësi lokale në territorin e saj. Me iniciativën e Këshillave nacionale të pakicës kombëtare rumune dhe hungareze, Kuvendi komunal i Vrshacit në maj të vitit 2007 ka ndryshuar Statutin e komunës dhe sërish ka futur gjuhën rumune dhe hungareze dhe

⁴⁰ Shih: <http://www.ombudsman.rs/index.php/lang-sr/misljenja-preporuke-i-stavovi/818-2010-04-01-12-42-54>

⁴¹ Përgjigja nëse pakicat kombëtare të cilat flasin me gjuhë të njëjtë duhet të realizojnë të drejtën e plotë në mbrojtje duhet të kërkohet në interpretimin e Gjykatës kushtetuese për nenet 10, 21. dhe 79 të Kushtetutës dhe obligimeve ndërkombëtare që janë marrë përsipër me ratifikimin e tyre.

shkrimet e tyre në përdorim zyrtar në tërë territorin e qytetit. Në komunën Shid gjithashtu ishte shënuar shkelja e të drejtave të fituara dhe atë me Vendimin mbi revokimin e përdorimit zyrtar të gjuhës rusine dhe sllovaqe, të cilin Kuvendi Komunal e kishte sjellë në prill të vitit 2005 dhe e kishte publikuar në gazetën zyrtare. Pas reagimit të ashpër të komuniteteve rusine dhe sllovaqe, vendimi i cekur ishte revokuar.

Pyetja që lind në mënyrë të pashmangshme lidhet me efektivitetin e mbrojtjes ligjore në rast se kuvendi lokal injoron obligimet ligjore për të futur në përdorim zyrtar edhe gjuhët minoritare. Neni 22 i Ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimin parasheh që mbikëqyrjen e zbatimit të saj ministrive kompetente për punën në fushën e administratës, transportit, urbanizimit, arsimit, kulturës dhe shëndetësisë. Mirëpo, ministrinë kompetente mund të mbikëqyrin zbatimin e të drejtave për përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave vetëm kur gjuha e caktuar futet në përdorim zyrtar. Prandaj, e drejta (dhe detyrimi) i ministrisë për monitorim të përdorimit të gjuhës paraqitet me futjen në përdorim të gjuhës zyrtare, dhe dështimi i asamblesë lokale që të fus një gjuhë të pakicave në përdorim zyrtar, nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes administrative.

Ministria e administrimit të shtetit dhe pushtetit lokal nuk mund të ndërhyjë në autonominë e pushtetit lokal ashtu që t'i urdhërojë atyre se cilat çështje mund t'i rregullojnë me statut, dhe as nuk mund të merr vendim për përdorimin zyrtar të gjuhës për ta. Ministria mund t'i bëjë rekomandim njësisë së vetëqeverisjes lokale, por ajo nuk ka karakter detyrues. Vetë Ministria e administrimit të shtetit dhe pushtetit lokal nuk ka një instrument që mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në njësinë e vetëqeverisjes lokale për të futur në përdorim zyrtar gjuhën e pakicës që plotëson pragun ligjor prej 15%. Për më tepër, është obligimi qeverisë lokale që, në pajtim me nenin 195 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë, me të cilën rregullohet hierarkia e akteve vendore të përgjithshme ligjore, në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje statutin e vetëqeverisjes lokale ta harmonizojnë me ligjin, përfshirë edhe Ligjin për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve me të cilin përcakton obligimi i drejtpërdrejtë i qeverive lokale kundrejt rregullimit të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimeve.

Ministria do të mundte, që në bazë të nenit 81 paragrafi 1 i Ligjit mbi vetëqeverisjes lokale, para Gjykatës supreme të iniciojë procedurën për vlerësimin e ligjshmërisë së statutit të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Mirëpo, iniciimi i procedurës para Gjykatës supreme nuk është një mjet efikas juridik duke marrë parasysh se Gjykata kushtetuese ka marrë qëndrim që nuk është kompetent të vlerësojë atë që nuk përmban ligji, statuti, apo rregullativa tjetër dhe as të vlerësojë zbatimin e ligjit, rregullativës tjetër dhe akteve të përgjithshme⁴².

Gjykata Kushtetuese e Serbisë në vitin 2001 i kishte dërguar një shkresë Asamblesë Kombëtare ku kishte vënë në pah se pasaktësitë dhe paqartësitë në nenin 11 të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimin kanë si rezultat që një numër i komunave nuk parasheh përdorimin zyrtar të gjuhës së minoriteteve, edhe pse në territorin e saj banojnë pjesëtarët e atij minoriteti. Veçanërisht është theksuar dilema nëse, në rastin kur komuna në territorin së cilës jetojnë pjesëtarët e pakicave kombëtar nuk përcakton përdorimin zyrtar të gjuhëve të tyre,

⁴² Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese IU-297/96 të 1 shkurtit 2001. (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr 15/2001).

kanë tejkaluar kompetencat në bazë të nenit 11 të Ligjit mbi përdorimin e gjuhës dhe shkrimit zyrtar, dhe nëse komuna kanë shkelur ligjin gjatë zbatimit të tij, me çka problemi bartet në juridiksionin e ministrisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit⁴³. Gjykata Kushtetuese ka shprehur këtë mendim para miratimit të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave, por ai mund të monitorohet dhe më tej, gjegjësisht sa herë që një qeveri lokale ka shkelur nenin 11 paragrafin 2 të Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale *gjatë zbatimit të tij*. Duke qenë se ligji nuk e rregullon as çështjen e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, mbetet e paqartë nëse ndonjë organ shtetëror mund të bëjë mbikëqyrjen. Mirëpo, edhe nëse ekziston mundësia e mbikëqyrjes së organit shtetëror për zbatimin e nenit 11 paragrafit 2 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, në rrethanat ekzistuese ligjore kjo nuk do të prodhonte rezultatet e dëshiruara, sepse autoriteti përkatës, si masë të fundit, përsëri do të udhëzohej të iniciojë procedurën para Gjykatës Kushtetuese, me të cilën gjë hyn në një rreth vicioz.

⁴³ Buletini i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë 1-2/2001, fq. 116.

V Analiza e segmenteve më të rëndësishme të të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare

1. E drejta në emër personal dhe regjistrimi i tij në evidencat dhe dokumentet publike sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të pakicës kombëtare

E drejta në emër personal është njëra prej të drejtave kyçe pasi që është thelbi i identifikimit personal, krijimit dhe ruajtjes së identiteti personal. E drejta në emër personal është ngritur në rang të të drejtave të njeriut të garantuar me Kushtetutë. *Kushtetuta* e Serbisë në nenin 37 paragrafi 3 proklamon se e drejta në zgjedhje dhe përdorim të emrit personal të fëmijëve të vet janë të lira. Për pjesëtarët e pakicave kombëtare, *Kushtetuta* në nenin 79 të paragrafit 1 përmban një garancë shtesë për të drejtën në përdorim të emrit dhe mbiemrit të vet në gjuhën e vet. Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare rregullon të drejtën në emrin personal në nenin 9 me të cilin parashihet e drejta e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që emrin dhe mbiemrin e fëmijëve të vet të zgjedhin dhe ta përdorin lirshëm. Realizimi i të drejtës në emër personal në këtë segment nuk kërkon veprimin e shtetit, por përkundrazi nga shteti kërkon që të përmbahet nga miratimi i akteve apo ndërmarrja e veprimeve të cilat do të rrezikonin realizimin e kësaj të drejte. Përveç zgjedhjes dhe përdorimit të emrit personal, pjesëtarët e pakicave kombëtare gjithashtu kanë të drejtë të regjistrojnë emrin personal në të gjitha dokumentet e evidencave zyrtare dhe përmbledhjet e të dhënave personale sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të vet. Në këtë segment të të drejtave në emër personale pritet roli aktiv i organeve shtetërore të cilat me veprime të veta mundësojnë realizimin e të drejtës në regjistrim. Ligji në nenin 9 paragrafi 2 parashih regjistrimin paralel të emrit sipas drejtshkrimit dhe shkrimit serb. Këso zgjidhjesh ligjore iu përgjigjen dispozitave të nenit 11 paragrafi 1 të *Konventës Kornizë*. E drejta e pjesëtarëve të pakicës kombëtare hungareze, maqedonase dhe rumune në regjistrim të emrit në dokumentet personale vërtetohet më tej me marrëveshjet bilaterale me këto shtete⁴⁴.

Për realizimin e të drejtës në emër personal, me rëndësi kyçe është regjistrimi në librat amë, pasi që vetëm kjo është më meritorë për përdorimin e emrit personal në rendin ligjor dhe është parakusht për të gjitha regjistrimet e tjera në evidencat e tjera publike. Ligji mbi librat amë, i cili ishte në fuqi deri në 27 dhjetor 2009 (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, 15/90, 57/2003, 101/2005) nuk përmbante asnjë dispozitë e cila merrej me të drejtën e emrit personal në gjuhën amtare. Mirëpo, Ligji mbi marrëdhëniet familjare (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 18/2005) në nenin 344 paragrafi 2 parashih të drejtën e prindit që të regjistrojë fëmijën në librin amë të të lindurve dhe në gjuhën dhe shkrimin amtare të njërit apo të dy prindërve. Regjistrimi i mbiemrit të fëmijës në gjuhën e pakicës kombëtare kushtëzohet me regjistrimin e mbiemrit të njërit apo të dy prindërve në atë gjuhë⁴⁵. Sipas interpretimit të ekspertëve nga Ministria për administratë shtetërore dhe vetëqeverisje lokale për regjistrim të emrave të pjesëtarëve të pakicave

⁴⁴ Neni 5 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Hungarinë*; neni 3 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Maqedoninë*; neni 3 paragrafi 1 i *Marrëveshjes me Rumaninë*.

⁴⁵ Sipas nenit 345 të Ligjit mbi marrëdhëniet familjare të ligjit, mbiemri i fëmijës përcaktohet nga prindërimt sipas mbiemrit të njërit apo të dy prindërve (paragrafi 1), me ç'rast fëmijëve të përbashkët nuk mund t'iu jepen mbiemra të ndryshëm (paragrafi 2). Në raste të caktuara, mbiemrat e fëmijëve i përcakton organi i kujdestarisë (paragrafi 3).

kombëtare në gjuhën dhe shkrimin e tyre, shërbimet e ofiqarisë janë bazuar në dispozitat e Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare dhe Ligjit mbi marrëdhëniet familjare⁴⁶.

Ligji mbi librat amë (*Gazeta zyrtare e RS-së*, nr. 20/2009) i cili ka filluar të zbatohet më 27 dhjetor të vitit 2009 parasheh në nenin 17 paragrafi 1 se pakicat kombëtare kanë të drejtë të regjistrojnë emrin sipas gjuhës dhe drejtshkrimit të tyre, gjë që nuk përjashton regjistrimin paralel të emrit personal edhe në gjuhën serbe, me shkrimin cirilik. Në territorin e KA të Vojvodinës të drejtën në emër personal e rregullon edhe neni 3 paragrafi 1 i Vendimit mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të përdorimit të gjuhës dhe shkrimeve të pakicave kombëtare në territorin e KA të Vojvodinës, sipas të cilit pjesëtarët e pakicave kombëtare se kanë të drejtë që emrin personal dhe atë të fëmijëve ta regjistrojnë në dokumentet publike në formën e tyre burimore, sipas shkrimit dhe drejtshkrimit të gjuhës së vet. Neni 3 paragrafi 2 i Vendimit të cekur parasheh që regjistrimi i këtillë nuk përjashton shkrimin e emrit personal edhe në gjuhën serbe krahas emrit në formën burimore.

Vendimi Krahinor mbi formularët shumëgjuhësor të certifikatave nga librat amë në nenin 6 parasheh që në certifikata shumëgjuhësore nga librat amë regjistrimi i emrit personal të pjesëtarëve të pakicave kombëtare të bëhet në gjuhën dhe shkrimin të pakicave kombëtare, me kusht që emri personal i pjesëtarëve të pakicave kombëtare regjistrohet pas kësaj në kllapa edhe në gjuhën dhe drejtshkrimin serb.

Mirëpo, hulumtimi në njësitë e vetëqeverisjes lokale në Serbi ka vënë në pah ekzistimin e dallimeve në kuptim të mbajtjes së librave amë dhe regjistrimit të emrit personal.

Në komunat Novi Pazar, Prijepolje dhe Priboj regjistrimi i emrit personal në librat amë bëhet në gjuhën serbe dhe në shkrimin cirilik. Është interesante që në Novi Pazar për arsye teknike të gjitha të dhënat, madje edhe emri personal, regjistrohen në librat amë në shkrimin latin. Në komunat Kuqevë dhe Bor në të cilat jetojnë në numër të konsiderueshëm pjesëtarët e pakicës kombëtare vllahe emrat personal regjistrohen në librat amë në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Në komunat Bujanoc dhe Preshevë emrat personal të pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare regjistrohen në librat amë të të lindurve vetëm në gjuhën shqipe dhe sipas drejtshkrimit të kësaj gjuhe, ndërsa emrat personal të romëve dhe serbëve regjistrohen në librat amë në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Praktikën e këtillë e shpjegojnë ashtu që regjistrimi i faktit të lindjes në këtë shërbim të ofiqarisë bëhet sipas Raportit të lindjes në shtete të jashtme. Raportet në fjalë plotësohen nga prindërit në konzullat në formularin e parashikuar. Në këso raste emri personal i pjesëtarit të pakicës kombëtare është shkruar vetëm në gjuhën dhe drejtshkrimin shqip. Ofiqarët flasin se hasin në vështirësi gjatë regjistrimit të emrit personal të pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare në gjuhën serbe për shkak të pamundësisë për të përkthyer emrin personal nga gjuha shqipe në atë serbe dhe regjistrimit në librat amë në shkrimin cirilik. Sipas deklaratave të të punësuarve zgjidhja e këtij problemi i është lënë vlerësimit të lirë të ofiqarëve që ka të bëjë me njohjen e shqiptimit të tingujve në gjuhën shqipe dhe regjistrimit të emrit personal në gjuhën serbe dhe cirilike. I njëjti problem është cekur edhe

⁴⁶ Biseda me përfaqësues të Ministrisë për administratën shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale (Jasmina Ben - Mensur, Zoran Petroviq dhe Bratislav Gjokiq) i mbajtur më 20 nëntor 2009.

në Medvegje. Mirëpo, në këtë shërbim të ofiqarisë problemi përpiqet të tejkalohet ashtu që gjatë regjistrimit të emrit personal të pjesëtarit të pakicës kombëtare shqiptare hartohet Procesverbali mbi përcaktimin e emrit personal, në të cilin pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare deklarohen se si do t'iu regjistrohet emri personal në librat personal në gjuhën serbe dhe cirilike. Nëse regjistrimi bëhet në bazë të raporteve nga shtetet e jashtme, shërbimi i ofiqarisë në Medvegje, përmes lutjes kërkon nga konzullati që qytetarët të thirren dhe të deklarohen mbi regjistrimin e saktë të emrit personal në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

Përfaqësuesit e Këshillit nacional të pakicës kombëtare bullgare flasin për dy probleme kyçe me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e pakicës kombëtare bullgare kur dëshirojnë të regjistrojnë emrin e tyre sipas drejtshkrimit bullgar. Në fakt, regjistrimi i të sapolindurve në Boslilegrad bëhet në shërbimet e ofiqarisë në Surdulicë apo në Vranje, në të cilat ofiqarët të drejtën në emër personal gabimisht e ndërlidhin me të drejtën në përdorimin zyrtar gjuhës së pakicës kombëtare dhe refuzojnë të regjistrojnë emrin në fonetikën bullgare, me ç'rast shkelin të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me ligj të pjesëtarëve të pakicës kombëtare bullgare. Problemi tjetër domethënës ka të bëjë me formën e mbiemrit mashkullor dhe femëror i cili ekziston në gjuhën bullgare (nga gjuhët që ekzistojnë në Serbi ekzistojnë edhe në gjuhën sllovaqe, çeke dhe maqedonase). Në fakt, sipas rregullave të kësaj gjuhe, forma femërore e mbiemrit përmban një prapashtesë të caktuar (më së shpeshti -a ose -ska) sipas të cilit dallohet nga forma mashkullore e këtij mbiemri. Problemi paraqitet kur gjatë lidhjes së martesës njëri bashkëshort (më së shpeshti gruaja) vendos të merr mbiemrin e burrit në bazë të të cilit mbiemri jonë parasheh që emri i bashkëshortëve duhet të ketë formë të njëjtë. Për shembull, nëse mbiemri i burrit është Stoimenov edhe bashkëshortja mund të regjistrohet në librin amë të të martuarve vetëm si Stoimenov, edhe pse sipas rregullave dhe traditës së gjuhës amtare bullgare ajo do të duhej të barte mbiemrin Stoimenova. Gjithashtu, nëse bashkëshortët Stoimenov do të donin të regjistrojnë të bijën e tyre në librin amë të të lindurve, këtë do të mund ta bënin vetëm në këtë formë (mashkullore). Në bisedë me përfaqësues të Ministrisë për administratë shtetërore dhe vetëqeverisje lokale na është thënë se emri i formës femërore të mbiemrit ende nuk është rregulluar me ligj dhe se duhet të rregullohet me akte nënligjore të cilat duhet të pasojnë Ligjin e ri mbi librat amë.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në KA të Vojvodinës problemet në lidhje me regjistrimin e emrit personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare plotësisht të tjera. Shërbimet e ofiqarisë nuk refuzojnë kërkesa të këtilla, por hulumtimi i kryer nuk ka larguar mëdyshjen nëse ofiqarët i paralajmërojnë qytetarët që kanë të drejtë të regjistrojnë emrat e fëmijëve në gjuhën e pakicës kombëtare, apo këtë të drejtë e realizojnë vetëm ata që synojnë këtë. Ofiqarët tregojnë se vështirësimin e realizimit të kësaj të drejte e kushtëzon edhe interpretimi i larmishëm i zbatimit të dispozitave nga ana e organeve inspektuese shtetërore dhe krahinore. Në fakt, këto organe kanë mendim të ndryshëm nëse në librat amë duhet së pari të regjistrohet emri personal në gjuhën serbe dhe në shkrimin cirilik dhe pastaj në kllapa në formën burimore, gj që preferohet nga organet shtetërore inspektuese apo së pari duhet të shkruhet emri personal në formën burimore për çka angazhohet më shumë Inspektorati krahinor. Konsiderohet se me ligjin e ri mbi librat amë kjo dilemë është zgjidhur por duke marrë parasysh se dilema ekzistuese ende mbizotëron dhe krijon huti e vështirësi në realizimin e një të drejte

elementare të qytetarëve, është e domosdoshme që me interpretim zyrtar të harmonizohen qëndrimet e organeve inspektuese me Ligjin.

Problemi më i shpeshtë me të cilin ballafaqohen qytetarët pjesëtarë të pakicave kombëtare por edhe shërbimet e ofiqarisë në KA të Vojvodinës paraqitet kur emri personal i qytetarët në librat amë është regjistruar vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Pjesëtarët e pakicave kombëtare emri personal i të cilit është shkruar në librat amë në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik ka të drejtë të kërkojë që emri t'i shkruhet edhe sipas gjuhës dhe shkrimit të tij amtar. Mirëpo, edhe në rastet e regjistrimit të vonshëm praktika ndryshon, sepse shërbimet e ofiqarisë në disa vetëqeverisje lokale e bëjnë regjistrimin e vonshëm të emrit sipas procedurës së rregullt për ndryshim të emrit personal, ndërsa të tjerat sipas procedurës së shkurtuar për ndryshim të emrit personal. Gjithashtu, disa vetëqeverisje lokale bëjnë ndryshimin e regjistrimit, ndërsa të tjerat korrigjimin e regjistrimit. Kjo për pasojë ka një tretman jo të barabartë si për nga kompleksiteti i procedurës (te procedura e rregullt për ndryshim të emrit pala duhet të parashtrijë vërtetime se nuk është dënuar, vërtetim nga administrata tatimore dhe vërtetim mbi nënshtetësinë, gjë që me procedurat tjera kjo nuk kërkohet), ashtu edhe për nga kohëzgjatja e procedurës (“menjëherë”, në afat prej një dite apo për disa ditë) dhe shpenzimeve (disa njësi të vetëqeverisje lokale nuk paguajnë taksa, ndërsa tek ato që kërkojnë taksa, shumat e tyre ndryshojnë). Duke qenë se të dhënat të cilat i kemi siguruar në bazë të bisedave në shërbimet e ofiqarisë në disa njësi të vetëqeverisjes dhe nga ankesat që qytetarët i kanë drejtuar Mbrojtësit të qytetarëve tregojnë se është fjala për procedurën e regjistrimit shtesë, dhe jo për ndryshimin e emrit, është i domosdoshëm një interpretim i duhur, udhëzim i organit kompetent për shërbimet e ofiqarisë.

Ashtu siç është thënë tashmë, regjistrimi i emrit personal në formën burimore në librat amë të lindurve është bazë për realizimin e të drejtës në regjistrim të emrit personal në formën burimore në dokumentet e tjera publike dhe evidencat zyrtare. Në këtë kuptim, duhet përmendur regjistrimin e emrit personal në letërnjoftim, si dokument themelor identifikuese në Republikën e Serbisë. Ligji mbi letërnjoftimin (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr 62/2006) në nenin 9 paragrafi 3 parasheh që mbiemri dhe emri të regjistrohen në formularë të letërnjoftimit në formën burimore, siç janë regjistruar në certifikatën e librit amë të të lindurve, me ç'rast këto të dhëna të pjesëtarët e pakicave kombëtare regjistrohen paralelisht edhe sipas drejtshkrimit dhe shkrimit serb. Që pjesëtari i pakicës kombëtare të realizojë të drejtën në regjistrim të emrit personal në formën burimore në letërnjoftim, është e domosdoshme që të parashtrijë certifikatën nga libri amë dhe vërtetimin mbi nënshtetësinë ku emri personal është shkruar edhe në formën burimore, si dhe të kërkojë shprehimisht që në formularët e letërnjoftimit të shkruhet emri personal në formën burimore. Në drejtoritë/stacionet policore nuk ekziston një praktikë e unifikuar lidhur me informimin e palës se mund ta realizojë këtë të drejtë. Në disa prej tyre është cekur dukshëm se pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të regjistrojnë emrin në formën burimore, në të tjera është cekur në gjuhët e pakicave se cilat dokumente nevojiten për lëshimin e letërnjoftimit, ndërsa në shumicën e rasteve realizimi i kësaj të drejte varet nga kujdesi i zyrtarëve nëse do ta udhëzojnë palën si duhet. Këshillat nacionale të

pakicave kombëtare⁴⁷ vënë në pah problemet në realizimin e kësaj të drejte, e posaçërisht faktin që situata ndryshon në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Në anën tjetër, në disa drejtori policore dhe stacione policore prefektët dhe komandantët pohojnë se mangësitë teknike shkaktojnë probleme në lidhje me regjistrimin e emrit në formën burimore. Mirëpo, në Shkresën⁴⁸ të cilën Mbrojtësi i Qytetarëve e ka pranuar nga Ministria e punëve të brendshme është shpjeguar se ekzistojnë mundësi teknike dhe të tjera që dokumentet personale, krahas gjuhës serbe, të lëshohen edhe në dhjetë gjuhët e pakicave kombëtare, gjegjësisht në gjuhën dhe shkrimin në të cilin është lëshuar edhe certifikata nga libri amë i të lindurve dhe vërtetimi mbi nënshtetësinë.

Mirëpo, është evidente se programi nuk mundëson regjistrim paralel të emrit personal edhe në gjuhën dhe shkrimin serb,⁴⁹ gjë që parashikohet me ligj. Në fakt, nëse qytetari orientohet që emri personal t'i shkruhet në gjuhën serbe atëherë emri nuk mund t'i shkruhet edhe në formë burimore, dhe anasjelltas. Në bisedat të cilat i kemi zhvilluar më 20 nëntor 2009 në Ministrinë e punëve të brendshme është thënë se e vetmja arsye për këtë është që në formularin e letërnjoftimit nuk është lënë hapësirë e mjaftueshme për regjistrimin paralel. Personat kompetent në MPB kanë thënë se nuk ekziston dallimi në përpunimin e formularit varësisht prej asaj se a prodhohet letërnjoftimit me çip apo pa të, dhe se regjistrimi i emrit në formën burimore mund të bëhet në të dyja rastet⁵⁰. Në drejtoritë/stacionet policore na është thënë se problemi themelor të regjistrimi i emrit personal në formën burimore paraqitet kur pala sjell dokumentet e domosdoshme (certifikatën nga libri amë i të lindurve dhe vërtetimin mbi nënshtetësinë) të cilat nuk përmbajnë të dhëna mbi emrin personal në formë burimore, por kërkon një regjistrim të tillë në letërnjoftim.

2. Dokumentet publike në gjuhët e pakicave kombëtare

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare në nenin 11 paragrafi 4 parasheh shprehimisht që përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave kombëtare nënkupton lëshimin e dokumenteve publike dhe mbajtjen e evidencave zyrtare dhe përmbledhje të të dhënave personale në gjuhët e pakicave kombëtare dhe pranimit të atyre dokumenteve në këto gjuhë si të vlefshme. Të drejtën në lëshimin e dokumenteve publike edhe në gjuhën e pakicave e rregullon neni 18 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve. Neni 18 paragrafi 1 i këtij Ligji parasheh mundësinë e lëshimit të certifikatës, kur mësimi të jetë mbajtur në gjuhën e pakicave, dokumenteve të tjera publike dhe dokumenteve të tjera të cilat janë me interes për realizimin e të drejtave të qytetarëve të parashikuara me ligj edhe në gjuhën e pakicës, me kusht që në territorin e dhënë gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar dhe se ekziston kërkesa e pjesëtarëve të pakicave kombëtare që të lëshojë dokumente të tilla

⁴⁷ Biseda me përfaqësues të pakicave kombëtare kroate, rumune, rusine dhe sllovaqe (16 tetor 2009), biseda me kryetarin e Këshillit nacional të pakicës kombëtare hungareze (14 tetor 2009).

⁴⁸ Shkresa e Ministrisë së punëve të brendshme nr. 01-1759/10 од 24.02.2010.

⁴⁹ Në Ministrinë e punëve të brendshme (20 nëntor 2009) na është thënë sepse në formularin e letërnjoftimit nuk është lënë hapësirë e mjaftueshme për regjistrim paralel.

⁵⁰ Nga pjesëtarë të disa pakicave kemi marrë informatën se në disa drejtori policore e lidhin regjistrimin e emrit personal në formën burimore për letërnjoftim me çip.

publike. Në paragrafin 3 të po të njëjti nen të Ligjit parashihet që formularët e dokumenteve të tilla shtypen në të dyja gjuhët, në gjuhën serbe dhe në atë të pakicës kombëtare. Dispozita të njëjta janë dhënë edhe në nenin 4 të Vendimit mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në territorin e KA të Vojvodinës.

Mirëpo, hulumtimi i përmendur tregon se në hapësirën e Serbisë qendrore nuk ekzistojnë formularët dygjuhësorë të certifikatës nga libri amë i të lindurve, por që të gjitha shërbimet e ofiqarisë përdorin formularë në gjuhën serbe dhe në shkrimin cirilik. Në komunën Bosilegrad kompetentët kanë vënë në pah nevojën për formularë dygjuhësor të certifikatave në librin amë, dhe se në disa raste i janë drejtuar ministrive të resorit për ndihmë – Ministrinë e administratës shtetërore dhe vetëqeverisje lokale si dhe Ministrinë për punë dhe ndihmë sociale – por nuk kishin marrë ndihmë konkrete.

Tashmë është përmendur se Kuvendi i KA të Vojvodinës ka miratuar një Vendim të posaçëm mbi formularët shumëgjuhësor të certifikatave nga librat amë si dhe mbi mënyrën e regjistrimit të tyre. Vendimi parasheh që në komunat ku gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar, me kërkesë të pjesëtarëve të asaj pakice kombëtare, të lëshohen certifikatat dhe vërtetimit dygjuhësore (neni 3). Gjatë regjistrimit të të dhënave në formularët e certifikatave dhe vërtetimeve, në pjesën e tekstit i cili është në pjesën e pakicës kombëtare regjistrimi bëhet në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, me obligimin që teksti të jetë identik me tekstin në gjuhën serbe (neni 4). Teksti në gjuhët dhe shkrimet e pakicave kombëtare shkruhet pas, gjegjësisht nën tekstin në gjuhën serbe, me të njëjtën formë dhe madhësi të shkronjave (neni 2 paragrafi 2). Përveç kësaj, Vendimi rregullon edhe çështjen e regjistrimit të emërimit të vendit dhe komunës (neni 6) edhe në gjuhën e pakicës kombëtare. Në rajonin e KA të Vojvodinës, ekzistojnë formularët dygjuhësorë të certifikatave të librave amë në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilat i kemi vizituar dhe ku kemi pasur qasje në formularë të tillë. Shumica e njësive të vetëqeverisjes lokale siguron formularët e tillë nga shtypshkronja *Dnevnik* në Novi Sad.

Mirëpo, Ligji mbi librat amë, i cili aplikohet më 27 dhjetor 2009, nuk parasheh lëshimin e formularëve dygjuhësorë nga libri amë. Ky ligj gjithashtu parasheh centralizimin e përpunimit të formularëve të certifikatave ashtu që në nenin 80 të paragrafit 2 parasheh që formularët e certifikatave të librave amë t'i punojë dhe shtyp Banka kombëtare e Serbisë – Enti për prodhimin e bankënotave. Në bisedat me përfaqësues të Ministrisë për administrim shtetëror dhe vetëqeverisje lokale nuk është shprehur mirëkuptim për përdorimin e formularëve dygjuhësor të certifikatave nga libri amë, pasi që përdorimi i tyre ngjall huti dhe komplikon një gjendje tashmë kaotike në sferën e librave amë. Është thënë gjithashtu se KA e Vojvodinës ka sjellë një Vendim mbi formularët shumëgjuhësorë edhe pse nuk kishte kompetenca në lëminë e librave amë, pasi që neni 10 pika 3 e Statutit të atëhershëm të KA të Vojvodinës, i referohet lëmisë së përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimeve të pakicave kombëtare, ku në përfshihen çështje nga lëmia e librave amë. Është thënë që problemi i formularëve dygjuhësorë të certifikatave do të tejkalohet me sjelljen e aktit nënligjor. Dhe me të vërtetë, më vonë kishte sjellë Udhëzimin mbi mbajtjen e librave amë dhe formularëve të librave amë (*Gazeta zyrtare e RS-së, nr. 109/2009, 4/2010-i korrigjuar dhe 10/2010*) në pikën 137. parasheh që në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat me statut është përcaktuar që në përdorim zyrtar të gjuhës së

pjesëtarëve të pakicave kombëtare në pjesën e pasme të formularëve të certifikatave nga librat amë të të lindurve, të martuarve dhe të vdekurve, mund të shtypen emërtimet e rubrikave të certifikatës së librit amë edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare. Mirëpo, zgjidhja e këtillë nuk i përgjigjet dispozitave të nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit sipas të cilëve teksti në gjuhët e pakicave të cilat janë në përdorim zyrtar shkruhen pas tekstit të gjuhën serbe, nën apo djathtas tij. Udhëzimi nuk ka zgjidhur as dilemën mbi shkrimin e të dhënave në gjuhën e pakicave kombëtare të cilët janë në përdorim zyrtar pasi që nuk rregullon mënyra e shkrimit të të dhënave në formularët e përcaktuar. Fakti që nuk lejohet që formularët dygjuhësor nga librat amë të kufizohen vetëm në përshkrimin e emërtimeve të rubrikave në gjuhën e pakicave kombëtare në fletën e pasme mbështetet edhe nga Sekretariati krahinor për administratë, rregullore dhe pakicat kombëtare për shkak të praktikës së deritanishme konfuze, por edhe për shkak të të drejtave të pranuarra të cilat nuk janë zbatuar në masë të obligueshme dhe të plotë⁵¹.

Ligji mbi letërnjoftimet parasheh në nenin 9 paragrafi 2 që formulari i letërnjoftimit botohet edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, në përputhje me ligjin. Pas qasjes në programin kompjuterik i cili përdoret gjatë përpunimit të kërkesave për lëshimin e letërnjoftimeve, kemi konstatuar se ekzistojnë mundësi teknike për përpunimin e formularëve të letërnjoftimit edhe në gjuhën e pakicës kombëtare. Me shënimin adekuat në fushën „label“ përcaktohet gjuha në të cilën pala dëshiron që formulari t'i përpunohet. Me këtë rast, shenja e çdo fushe në formularin e letërnjoftimit shkruhet në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, në gjuhën angleze dhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare. Programi kompjuterik parasheh këtë mundësi që për çdonjërin nga dhjetë gjuhët të cilët janë cekur në aktin e ratifikimit të *Kartës së Evropës mbi gjuhët rajonale dhe të pakicave*. Përveç regjistrimit të emrit personal në formën burimore (për të cilën gjë është folur më herët), Ligji parasheh që të dhënat e tjera të shkruhen në gjuhën serbe, shkrimin cirilik, dhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare, në përputhje me ligjin (neni 9 paragrafi 4). Përveç kësaj, Rregullorja mbi letërnjoftimet (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 11/2007, 9/2008) në nenin 8 paragrafi 3 përcakton se në kërkesën për lëshimin e letërnjoftimit cek edhe gjuhën dhe shkrimin në të cilin duhet të shkruhen të dhënat në formularin e letërnjoftimit. E drejta në regjistrim të të dhënave të tjera në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, përveç emrit personal, nuk realizohet. Në drejtoritë dhe stacionet policore, në të cilat kemi kryer bisedat, na është thënë në mënyrë kategorike se të gjitha të dhënat e tjera, përveç emrit personal, regjistrohen ekskluzivisht në shkrimin cirilik.

Në kuptim të mbajtjes së evidencave në shkolla dhe univerzitetet dhe lëshimit të dokumenteve personale në bazë të këtyre evidencave, përveç Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve, relevante janë edhe ligjet të cilat rregullojnë lëminë e arsimit. Sipas nenit 129 paragrafi 2 i Ligjit mbi shkollën fillore⁵² shkolla mban evidencë⁵³ edhe në gjuhën e pakicës

⁵¹ Nga sugjerimet e Sekretariatit krahinor për administratë, rregullore dhe pakicat kombëtare për draftin e këtij dokumenti.

⁵² *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 50/92, 53/93, 67/93, 48/94, 66/94 – vendimi i GJKRS-së, 22/2002, 62/2003 – ligji i d., 64/2003 – korr. i ligjit të d., 101/2005 – ligji i d. dhe 72/2009 – ligji i d.

kombëtare, kur mësimi zhvillohet në atë gjuhë. Ditari (libri i klasës) mbahet në gjuhën dhe shkrimin në të cilin realizohet puna edukativo-arsimore (neni 129 paragrafi 4 i Ligjit). Si dokumente publike, shkolla lëshon librezën shkollore, dëftesën mbi përfundimin e shkollës së kryer fillore, bllokun, vërtetimin mbi provimin e dhënë nga gjuha e huaj (neni 132 paragrafi 1 i Ligjit), ndërsa kur mësimi mbahet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare dokumentet lëshohen edhe në atë gjuhë (neni 133 paragrafi 4). Dispozitat ekuivalente përmban edhe Ligji mbi shkollën e mesme⁵⁴ (neni 99 paragrafi 3 dhe neni 100 i paragrafi 5) si dhe Ligji mbi arsimin e lartë⁵⁵ (neni 97 paragrafi 3 dhe neni 99 paragrafi 4).

Hulumtimet dhe bisedat me përfaqësues të këshillave nacionale të pakicave kombëtare kanë treguar se rregullat mbi dygjuhësinë e evidencave dhe dëftesave shkollore të respektohen, posaçërisht duke marrë parasysh se edhe inspekcioni arsimor është duke përcjellur këtë çështje. Mirëpo, janë vënë në pah edhe lëshimet vijuese: a) në administratën e qytetit të Novi Pazarit është thënë se evidencat shkollor, dëftesat dhe librezat shkollore lëshohen vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik; b) në komunën e Medvegjës në shkollën e fshatit Tupale evidenca mbahet vetëm në gjuhën shqipe; c) në administratën komunale të Shidit është theksuar se evidenca shkollore në Erdevik mbahet vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik; d) përfaqësuesit e Këshillit nacional të pakicës kombëtare rumune kanë pasur vërejtje në mungesën e përkthimit si dhe gabime thelbësore në të shtypur në dëftesa dhe librezat shkollore; e) përfaqësuesi i Këshillit nacional i pakicës kombëtare hungareze na ka bërë me dije se në fakultete nuk ka librezat dygjuhësore të studentëve (indekse), dhe se diplomat janë vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik.

3. Shenjat topografike në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare

Sipas Kushtetutës së Serbisë, anëtarët e pakicave kombëtare, në zonat ku ata përbëjnë një popullatë të konsiderueshme, kanë të drejtë që emërtimet tradicionale lokale, emrat e rrugëve, vendbanimet dhe emërtimet topografike të shkruhen edhe në gjuhën e tyre (neni 79, paragrafi 1). Karta Europiane, neni 10 paragrafi 2 pika g, parasheh detyrimin e shtetit për të miratuar ose për të inkurajuar përdorimin e formave tradicionale të emrave në gjuhët rajonale ose të pakicës, nëse është e nevojshme së bashku me emrin në gjuhën zyrtare. Të drejtën në emërtimet topografike e garanton edhe Konventa Kornizë, e cila në nenin 11 paragrafi 3 "e detyron" shtetin që emërtimet tradicionale lokale, emërtimet e rrugëve dhe emërtimet topografike të tjera të dedikuara për publikun, të shkruhen edhe në gjuhën lokale. Duke vepruar kështu, Konventa Kornizë vendos dy kushte të rëndësishme: së pari, zona në të cilët bëhen këto emërtime duhet të jenë të banuara tradicionalisht nga një numër i konsiderueshëm

⁵³ Librin amë, ditarin e punës edukativo-arsimore – librin e klasës, evidencën e provimeve – procesverbalin mbi provimet korigjuuese, klasore, dhe për edukim të të rriturve dhe provimet tjera, mbi suksesin e nxënësve në fund të vitit shkollor, mbi dëftesat e lëshuara dhe për ndarjen e lëndëve ndërmjet arsimtarëve (neni 130 paragrafi 1 i Ligjit mbi shkollën fillore).

⁵⁴ *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 50/92, 53/93, 67/93, 48/94, 24/96, 23/2002, 25/2002 – korr., 62/2003 – ligji i d., 64/2003 – korr. i ligjit të d., 101/2005 – ligji i d. dhe 72/2009 – ligji i d.

⁵⁵ *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 76/2005, 100/2007 – interpretimi autentik dhe 97/2008.

i personave që u përkasin pakicave kombëtare; së dyti, duhet të ketë kërkesë të mjaftueshme për emërtime të tilla.

Vendosja e duhur e shenjave topografike, emrave të vendeve, rrugëve dhe shenjave të tjera publike në gjuhën kroate, hungareze, rumune dhe maqedonase, është subjekt edhe i marrëveshjeve bilaterale me këto vende⁵⁶. Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare pason *Konventën Kornizë* dhe në nenin 11 paragrafi 5, parasheh që në njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku 15% e popullatës së përgjithshme përbëhet nga pakicat etnike, emrat e organeve që kryejnë funksione publike, emrat e njërive të qeverisjes lokale, qyteteve dhe fshatrave, shesheve, rrugëve dhe toponimet tjera, shënohen edhe në gjuhën e asaj pakice kombëtare. Ligji parasheh shprehimisht që emrat të shënohen sipas traditës dhe drejtshkrimit të gjuhës së pakicës kombëtare. Ligji i tejkalon standardet e vendosura nga *Konventa Kornizore* pasi nuk paraqet "kërkesë të mjaftueshme" si kusht për realizimin e kësaj të drejte.

E drejta në shkrimin e shenjave topografike në gjuhët e pakicave, përfshihet edhe në Ligjin për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit (neni 11, paragrafi 4 dhe neni 19).

Për çështjet e shënimeve topografike është i rëndësishëm edhe neni 93 i Ligjit për vetëqeverisjen Lokale. Neni 93 paragrafi 1 i Ligjit i jep përgjegjësinë këshillit lokal për të vendosur mbi emrat e rrugëve, shesheve, qarqeve të qytetit, fshatrave dhe pjesëve të tjera të vendbanimeve në territorin e saj, me pëlqimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale. Sipas nenit 93 paragrafi 2 të të njëjtit ligj, në ato njësi të qeverisjes lokale ku është në përdorim zyrtar edhe gjuha e pakicave kombëtare, për emërtimin e rrugëve, shesheve, qarqeve, fshatrave dhe pjesët e tjera të vendbanimeve, këshilli lokal duhet të marrë mendimin e Këshillit Kombëtar të pakicës kombëtare.

Në nivelin e AP Vojvodinës çështja e shenjave topografike rregullohet më për së afërmi me Vendimin për rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në Vojvodinë. Me nenin 6 paragrafin 1 të këtij vendimi, është e përcaktuar se emrat e vendeve dhe emërtimet e tjera gjeografike, emrat e rrugëve dhe shesheve, emrat e agjencive, organizatave, kompanive publike, institucioneve dhe shërbimeve, shenjat e trafikut, njoftimet dhe paralajmërimet për publikun, dhe shenjat e tjera publike shkruhen në gjuhën e pakicës kombëtare gjuha e së cilës është në përdorim zyrtar, si dhe në bazë të traditës së tyre. Me këtë vendim parashihet që këshilli nacional të përcaktojë emrat tradicionale të qyteteve, komunave dhe vendbanimeve në gjuhën e pakicës (neni 7 paragrafi 1 i Vendimit). Nëse Këshilli nacional nuk e bën këtë, emërtimet në gjuhën e pakicës përcaktohen nga Këshilli Ekzekutiv i Vojvodinës (në bashkëpunim me pushtetin lokal, organizatat e pakicave kombëtare, ekspertë të gjuhës, historisë dhe gjeografisë të asaj pakice, neni 7, paragrafi 2. I Vendimit). Dilemat rreth kompetencave të këshillave nacionale në drejtim të përcaktimit të emrave tradicionale të gjuhëve të pakicave kombëtare janë hequr që nga miratimi i Ligjit mbi Këshillat nacionale të pakicave kombëtare, i cili në nenin 22 pika 1 shprehimisht parasheh që këshilli nacional përcakton emrat tradicionale të vetëqeverisjes lokale, vendbanimet dhe emrat

⁵⁶ Neni 6 Paragrafi 2 alineja 7 Marrëveshja me Kroacinë; neni 5 paragrafi 5, Marrëveshja me Hungarinë; neni 3 paragrafi 2 Marrëveshja me Maqedoninë; neni 3 paragrafi 2 Marrëveshja me Rumaninë;

e tjerë gjeografik në gjuhët e pakicave, nëse në zonën e qeverisjes lokale është në përdorim zyrtar gjuha e pakicave.

E drejta e zbatimit të shenjave topografike në gjuhët e pakicave nuk është e harmonizuar dhe në asnjë njësi të qeverisjes lokale nuk përputhet plotësisht me standardet e kornizës ligjore. Në lidhje me emërtimin e emrave të organeve dhe organizatave që kryejnë funksione publike, ka ndryshime varësisht prej faktit nëse janë në juridiksionin e qeverisjes lokale ose të Republikës. Organet dhe organizatat që janë nën juridiksionin e qeverisjes lokale, ku gjuha e pakicës është në përdorim zyrtar më së shpeshti e respektojnë detyrimin e shënimit të tabelave shumëgjuhëshe me emërtimin e organit, apo organizatës. Organet e Republikës dhe Ndërmarrjet publike, në anën tjetër, injorojnë dispozitat ligjore dhe shfaqin tabelat me emërtimet në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Shkak i kësaj gjendjeje është struktura e centralizuar organizative e organeve shtetërore dhe mungesa e mekanizmave për të filluar iniciativa për të ndryshuar këtë praktikë në mënyrë që të jetë në pajtim me ligjin.

Sa i përket emërtimeve të vendbanimeve, më së shumti shihen tabelat në shkrimin cirilik me transkriptim latin. Ky rast është më i shpeshtë në Sërbinë qendrore, ku deri në miratimin e Ligjit për këshillat nacionale të pakicave kombëtare nuk ishte e rregulluar se kush përcakton emërtimet tradicionale të vendbanimeve në gjuhën e pakicës⁵⁷. Në Vojvodinë janë të vendosura tabelat e vendeve me emërtimet tradicionale në gjuhët e pakicave, por shpesh tabela shumëgjuhëshe nuk është vendosur në çdo hyrje të zonës së banuar. Emrat e rrugëve dhe shesheve janë rrallë të shënuara me tabelat shumëgjuhëshe, dhe ato vetëm në disa komuna në Vojvodinë. Në Senti, Srbobran, Stara Pazova rregullat respektohen si duhet, derisa për shembull në Kovaçicë emërtimet janë postuar në gjuhën serbe dhe sllovaqe, edhe pse duhet të jenë të shkruar edhe në gjuhën hungareze dhe rumune. Gjithashtu, në komunën Alibunar, shenjat janë postuar në gjuhën serbe dhe rumune, ndërsa është dashur edhe në gjuhën sllovaqe. Arsyet më të shpeshta për mosaplikimin e shenjave shumëgjuhëshe në vendbanime janë kosto të mëdha materiale që rrjedhin nga ndërtimi dhe vënia e këtyre tabelave, konfliktet e juridiksionit në lidhje me vendosjen e tabelës për të treguar vendbanimin, problemet me dëmtimet e tabelave shumëgjuhëshe.

4. Gjuhët e pakicave kombëtare në procedurat para organeve administrative

E drejta në përdorim të gjuhës së vet para organeve të autoriteteve publike është një prej të drejtave kyçe e cila rrjedh nga përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare, sepse edhe vetë karakteri i përdorimit „zyrtar“ i gjuhës ka të bëjë me komunikimin e qytetarëve me organet shtetërore. Ky komunikimi i pjesëtarëve të pakicave kombëtare me organet e autoriteteve publike në gjuhën e pakicave kombëtare mund të realizohet edhe përmes zhvillimit të tërë procedurës në këtë gjuhë, ose përmes të drejtës së palës apo pjesëmarrësit tjetër që në procedurën e cila zhvillohet në gjuhën serbe, të përdor gjuhën e vet. Edhe njëra edhe tjetra drejtë garantohen me *Kushtetutë*.

⁵⁷ Përfaqësuesit e Këshillit nacional të pakicës kombëtare bullgare kanë tërhequr vëmendjen që emërtimet e disa vendbanimeve jeton pakica kombëtare bullgare nuk janë të shenjëzuara me emërtimet tradicionale në gjuhën bullgare.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që në territoret ku ata përbëjnë popullatë domethënëse, organet e autoritetit publik dhe organizatave të cilave iu janë besuar kompetencat publike, të zhvillojnë procedurën edhe në gjuhën e tyre (neni 79 paragrafi 1 i *Kushtetutës*). E drejta në përdorim të gjuhës së vet në procedurë e cila mbahet në gjuhën serbe, nuk është rezervuar vetëm për pjesëtarët e pakicave kombëtare, por në përputhje me nenin 199, paragrafin 1 të Kushtetutës, kjo e drejtë i garantohet çdo personi, mbi drejtën apo obligimin e të cilit vendoset në procedurë. Gjatë ratifikimit të Kartës së Evropës. Serbia ka marrë përsipër obligimin në lidhje me masat të cilat janë të intezitetit më të ulët nga standardi që ekziston në të drejtën kombëtare, pasi që ka pranuar që vetëm parashtresat gojore apo të shkruara⁵⁸, dokumentet⁵⁹ dhe kërkesat⁶⁰ mund të parashtrohen edhe në gjuhët e pakicave.

Përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare në komunikim me organet e administratës e parasheh edhe Konventa kornizë në nenin 10 paragrafi 2, por shteteve u lë edhe një liri të gjërë të vlerësimit. Dispozita e cekur parasheh mundësinë e përdorimit të gjuhës së pakicave në marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të pakicave kombëtare të cilët tradicionalisht apo në numër më të madh banojnë në treva të caktuara dhe organeve të administratës, me kusht që pjesëtarët këtë e kërkojnë dhe kjo kërkesë i përgjigjet nevojës së *vërtetë*. Me këtë rast, obligimi i shtetit është e zbutur edhe me formulimin që do të *synojë që deri në masë të mundur* të sigurojë kushtet për komunikim të këtyllë. Me marrëveshjet bilaterale me Kroacinë, Hungarinë, Maqedoninë dhe Rumaninë, Serbia është obliguar që pjesëtarëve të pakicave t’u sigurojë shfrytëzimin e gjuhës së tyre amtare dhe para organeve të administratës dhe organizatave të cilat ushtrojnë kompetenca publike⁶¹. Sipas nenit 11 paragrafi 4 i Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare parasheh edhe përdorimin e kësaj gjuhe në procedurën administrative, si dhe zhvillimin e procedurave administrative përkitazi me to. Ligji gjithashtu parasheh që gjuhët e pakicave kombëtare mund të përdoren në komunikimin e organeve të kompetencave publike me qytetarët.

Procedura administrative zhvillohet në gjuhën serbe⁶², por në kushte të caktuara, mund të mbahet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare. Procedura administrative mund të mbahet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare nëse për çështjen administrative vendoset në instancë të parë, nëse në organin i cili udhëheq procedurën në përdorim zyrtar është edhe gjuha e pakicës kombëtare dhe nëse ekziston kërkesa e palës që procedura të zhvillohet në atë gjuhë⁶³. Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit përcakton obligimin e personit zyrtar i cili udhëheq procedurën që të njoftojë palën se cilat gjuhë janë në përdorim zyrtar në territorin e organit e organit dhe t’i kërkojë atij që të deklarohet se në cilën gjuhë dëshiron që të zhvillohet

⁵⁸ Neni 10 paragrafi 1 pika a (IV) dhe neni 10 paragrafi 2 i pikës 6 të Kartës Evropiane.

⁵⁹ Neni 10 paragrafi 1 pika a (V) e Kartës Evropiane.

⁶⁰ Neni 10 paragrafi 3 pika c e Kartës Evropiane.

⁶¹ Neni 6 paragrafi 2 alineja 1 e *Marrëveshjes së Kroaciës*; neni 5 paragrafi 3 i *Marrëveshjes për Hungarinë*; neni 3 i paragrafit 2 të *Marrëveshjes me Maqedoninë*; neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Rumaninë*.

⁶² Neni 12 i paragrafit 1 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit dhe neni 16 paragrafi 1 të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative (*Gazeta Zyrtare e RF të Jugosllavisë*, nr. 33/97 dhe 31/2001).

⁶³ Shih nenin 12 të paragrafit 1, paragrafit 2 dhe paragrafit 4 të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit dhe neni 16 paragrafi 1 i LPA-së.

procedura (neni 13 paragrafi 2). Personi zyrtar është i obliguar që në procesverbal të konstatojë këtë fakt, si dhe të theksojë se në cilën gjuhë do të zhvillohet procedura (neni 13 paragrafi 4). Në procedurën administrative e cila është duke u zhvilluar në gjuhën e pakicës kombëtare i tërë komunikimi me gojë dhe me shkrim ndërmjet palës dhe organit (parashtresat, thirrjet, deklaratat, etj.) parashtrohen në atë gjuhë, ndërsa procesverbalet dhe vendimet hartohen si tekste autentike në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik dhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare⁶⁴. Sipas Rregullores për formularët e akteve në procedurën administrative (*Gazeta zyrtare e RF të Jugosllavisë nr. 8/99 dhe 9/99-i korrigj*), në organet në të cilat procedura zhvillohet edhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, formularët e parashikuar, përveç teksteve në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik përmbajnë edhe tekstin në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, me obligimin që të përmbajnë të gjitha elementet e parapara (neni 6 i Rregullores).

E drejta në zhvillim të procedurës në gjuhën e pakicës është e kufizuar vetëm në procedurën e instancës së parë ndërsa procedura në instancë të dytë mbahet në gjuhën serbe, me të drejtën e palës, që në këtë procedurë të përdorin gjuhën e vet⁶⁵. Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe pakicave përcakton obligimin e organit të shkallës së parë që dokumentet e shkruara në procedurën e instancës së dytë dhe në lidhje me të (aktvendimi, vendimi, procesverbali, parashtresat, dokumentet dhe të ngjashme) t'i përkthejë në gjuhën e pakicës kombëtare në të cilin është zhvilluar procedura e shkallës së parë (neni 15 paragrafi 2 i Ligjit).

Nëse gjuha e pakicës kombëtare nuk është në përdorim zyrtar të territorin e organit i cili udhëheq procedurën administrative, procedura nuk mund të zhvillohet në atë gjuhë, por pjesëtarët e pakicës kombëtare kanë të drejtë që në procedurë të përdorin gjuhën dhe shkrimin e vet, me kusht që para organit përkatës të përmbushin ndonjë të drejtë apo obligim të vet. Në këtë kuptim, pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që në gjuhën e vet të parashtrojnë ankesat, propozimet, aplikimet dhe parashtresat e tjera, të kërkojnë dhe në gjuhën e vet të marrin kopjet e aktvendimeve dhe akteve të tjera me të cilat vendoset mbi të drejtat dhe obligimet e veta, si dhe dokumentet e tjera të shkruara, që, me kërkesë, t'u përkthehet procesverbali apo pjesë të caktuara si dhe deklaratat e palëve të dhënë në gjuhën serbe⁶⁶. Shpenzimet e përkthimit nga dhe në gjuhën e pakicave kombëtare barten nga organi i cili udhëheq procedurën, gjegjësisht financohen nga buxheti (neni 17 paragrafi 4 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar i gjuhës dhe shkrimit). E drejta në përdorim zyrtar të gjuhës dhe pakicës kombëtare është një e drejtë procedurale në procedurën administrative dhe shkelja e saj mund të theksohet në ankesë. Përveç kësaj, shkelja e kësaj të drejte mund të jetë arsye për përsëritje të procedurës⁶⁷.

Përdorimi i gjuhës së pakicës kombëtare para organit të administratës nuk është shpeshtuar në praktikë dhe zbatohet vetëm si përjashtim. Kësaj i kontribuon, nga njëra anë, qasjen e organeve

⁶⁴ Neni 14 paragrafi 1 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve

⁶⁵ Neni 15 paragrafi 1 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve.

⁶⁶ Neni 16 paragrafi 1 pika 2 dhe 3 dhe neni 17 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave. Krahaso me nenin 16 paragrafin 2 të Ligjit mbi procedurën administrative (LPA).

⁶⁷ Sipas nenit 239 pika 11 e LPA-së, procedura në të cilën është marrë vendimi përfundimtar përsëritet nëse personit i cili ka marrë pjesë në procedurë nuk i është dhënë mundësia që të shërbehet me gjuhën dhe shkrimin e vet.

të autoritetit publik të cilat nuk kanë kapacitete për përdorim të barabartë të të gjitha gjuhëve në përdorim zyrtar në territorin e tyre dhe të cilët nuk nxisin përdorimin e gjuhëve të pakicave, por edhe dëshira e palëve që sa më shpejtë dhe thjeshtë të arrijnë deri te aktvendimi në procedurën administrative. Duke marrë parasysh se zhvillimi i procedurës në gjuhën e pakicës kombëtare dhe përdorimi i saj komplikon procedurën, prapa kërkesës për përdorim të gjuhës jo rrallë fshehet synimi që procedura të zgjatet në mënyrë që të vonohet marrja e vendimit i cili është i pafavorshëm për palën. Në njësitë organizative të organeve republikane në territoret ku në përdorim zyrtar është edhe gjuha e pakicës kombëtare, procedurat administrative zhvillohen në gjuhën serbe dhe i gjithë komunikimi i qytetarëve, pjesëtarëve të pakicave kombëtare, me të gjitha organet është në gjuhën serbe. Gjuha e pakicave kombëtare përdoret më së shpeshti në komunikimin me gojë në mënyrë që pala të informohet mbi ndonjë të drejtë apo obligim të tij, apo për rrethanat e rastit.

E drejta në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicës kombëtare në komunikim me organet republikane të cilët ushtrojnë kompetenca publike nuk realizohet. Situata është pak më e mirë në kuptim të përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në procedurat para organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale, por edhe në këtë nivel nuk iu përgjigjet standardeve të cilat parashtrihen me rregullativë. Në mesin e njësive të vetëqeverisjes lokale duhet theksuar Suboticën e cila ka siguruar kapacitetet për përdorim efikas të të gjitha gjuhëve të cilat janë në përdorim zyrtar⁶⁸. Në komunën Senta procedurat zhvillohen kryesisht në gjuhën serbe, por komuna ka kapacitete që t'i zhvillojë edhe në gjuhën hungareze, nëse qytetarët do ta kërkonin këtë. Praktika tregon se shumica e njësive të vetëqeverisjes lokale zhvillohen në gjuhën serbe, por vetëm me kërkesë të qytetarëve procedurat zhvillohen në gjuhën e pakicës kombëtare me angazhimin e përkthyesit.

5. Gjuhët e pakicës kombëtare në procedurat para gjykatësve

Përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare para gjykatave realizohet me mbajtjen e procedurës gjyqësore në gjuhën e pakicës kombëtare apo, kur procedurat mbahet në atë gjuhë, me përdorimin e saj gjatë procedurës. Mbajtja e procedurës gjyqësore në gjuhët e pakicave kombëtare si dhe përdorimi i këtyre gjuhëve në procedurat gjyqësore të ngrihet në nivelin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por ekzistojnë dallime të caktuara në rregullimin e tyre. Mundësia që procedura gjyqësore të mbahet në ndonjë gjuhë tjetër përveç në gjuhën serbe është e hapur vetëm për gjuhët e pakicave kombëtare, me ç'rast lidhet për rrethinat ku pjesëtarët e pakicave kombëtare përbëjnë popullatë domethënëse (neni 79 paragrafi 1 i *Kushtetutës*).

E drejta në përdorim të gjuhës së vet në procedurën gjyqësore, në anën tjetër, nuk është rezervuar vetëm për pjesëtarët e pakicave kombëtare, por mund ta realizojë çdo person për të drejtat dhe obligimet e të cilit zgjidhet në procedurë (neni 199 paragrafi 1 i *Kushtetutës*).

⁶⁸ Në çdonjërin prej sporteleve të qendrës për shërbim të qytetarëve pala mund të merr informata në cilën do prej tre gjuhëve të cilat janë në përdorim zyrtar, të gjithë formularët shtypen në çdonjërin prej këtyre gjuhëve, por ekziston edhe shërbimi i përkthimit.

Kushtetuta në neni 32 paragrafi 2 i garanton çdonjërit të drejtën në përkthyes pa pagesë, në rast se nuk flet apo kupton gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në gjykatë.

Karta Evropiane mbron gjuhët rajonale dhe të pakicave në procedurat para gjykatave në nenin 9. Serbia në këtë kuptim është obliguar që në procedurat penale t'i garantojë të akuzuarit, pjesëmarrësit të pakicës kombëtare, të drejtën që të përdor gjuhën e vet, si dhe të sigurojë që kërkesa dhe dëshmia, e hartuar me gojë apo me shkrim, të mos konsiderohen të papranueshme vetëm pse janë formuluar në gjuhën e pakicave kombëtare (neni 9 paragrafi 1 pika a (ii) dhe (iii)). Sa i përket procedurave kontestimore civile dhe kontesteve administrative, Serbia është obliguar që të lejojë që, sa herë që nevojitet që pala të paraqitet para gjykatës, ajo të mund të përdor gjuhën e vet pa shpenzimet shtesë (neni 9 paragrafi 1 pika b (ii) dhe c (ii)). Serbia gjithashtu është obliguar që të sigurohet që zbatimi i këtyre masave dhe shfrytëzimi i përkthyesit të mos shkaktojë shpenzime shtesë personave të interesuar (neni 9, paragrafi 1 pika d). Me ratifikimin, Serbia ka pranuar edhe nenin 9, paragrafin 2, pikës a, b dhe c të cila obligojnë shtetin që të mos vë në pikëpyetje vlefshmërinë e të drejtave juridike vetëm pse janë në gjuhët regjionale dhe të pakicave.

Konventa kornizë nuk rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve të pakicave para organeve gjyqësore, por përdorimin e këtyre gjuhëve në kushte të caktuara e kufizon vetëm në komunikimin me organet administrative (neni 10 paragrafi 2).

Marrëveshjet bilaterale mbi mbrojtjen e pakicave me Kroacinë, Hungarinë, Maqedoninë dhe Rumaninë e obligojnë shtetin që të mundësoj përdorimin e gjuhës së këtyre pakicave në procedurat para gjykatësve⁶⁹.

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare mundëson përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare para gjykatave në një vëllim më të gjërë, pasi që në nenin 11 paragrafi 4 parasheh si përdorimin e gjuhës së pakicës kombëtare në procedurën gjyqësore, ashtu edhe udhëheqjen e procedurës gjyqësore në gjuhën e tyre. Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit parasheh që procedura penale, kontestimore apo tjetër e shkallës së parë (për shembull: jashtëkontestimore apo e kundërvajtjes) ku vendoset mbi të drejtat dhe obligimet e qytetarëve mund të kryhet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare e cila është në përdorim zyrtar në gjykatë. Nëse në territorin e gjykatës në përdorim zyrtar është edhe gjuha e pakicës kombëtare (njëri apo më shumë), gjykata është e obliguar që për këtë ta njoftojë palën/palët dhe të kërkojë prej tyre që të deklarohen në cilën gjuhë do të udhëhiqet, gjë që duhet të regjistrohet në procesverbal. Çështja e gjuhës në të cilën do të mbahet procedura është pyetja paraprake për të cilën vendos gjykata, por që, në masë të madhe kufizohet nga dispozitat e Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit. Ligji mbi nenin 12 paragrafi 4-6 përcakton rregullat për përcaktimin e gjuhës në të cilën do të mbahet procedura. Procedura do

⁶⁹ Neni 6 paragrafi 2 alineja 1 e *Marrëveshjes me Kroacinë*; neni 5 paragrafi 3 i *Marrëveshjes me Hungarinë*; neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Maqedoninë* dhe neni 3 paragrafi 2 i *Marrëveshjes me Rumaninë*. Formulimi i kësaj dispozite nuk është e njëjtë në të gjitha marrëveshjet. *Marrëvesha me Hungarinë* shprehimisht flet mbi të drejtën e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, ndërsa të tjerët theksojnë obligimin e shtetit, me ç'rast shfrytëzojnë termine të ndryshme („lejon“ në *Marrëveshjen me Rumaninë*, „siguron“ në *Marrëveshjen me Kroacinë* dhe „mundëson“ në *Marrëveshjen me Maqedoninë*).

të mbahet në gjuhën e pakicës kombëtare i cili është në përdorim zyrtar në gjykatë, nëse në të merr pjesë vetëm një palë dhe ajo kërkon që procedura të zhvillohet në atë gjuhë. Procedura mund të zhvillohet në gjuhën e pakicave e cila është në përdorim zyrtar në gjykatë dhe nëse në të marrin pjesë më shumë pala, me kusht që palët merren vesh që procedurat të zhvillohet në atë gjuhë. Nëse nuk vjen deri te një marrëveshje e tillë, ndërsa njëra palë kërkon që procedura të zhvillohet në gjuhën serbe, procedura do të zhvillohet në gjuhën serbe. Prandaj, gjykata në parim ka të drejtë të vendos mbi gjuhën në të cilin do të zhvillohet procedura vetëm në rast se palët nuk mund të dakordohen dhe nëse asnjëra prej tyre nuk kërkon që procedura të zhvillohet në gjuhën serbe.

Nëse procedura e shkallës së parë zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare, pala/palët mund t'i dërgojnë të gjitha parashtresat në këtë gjuhë, gjykata i dërgon të gjitha dokumentet me shkrim në atë gjuhë, ndërsa procesverbali dhe vendimet mbi procedurën e shkallës së parë hartohen si tekste autentike në gjuhën serbe dhe në gjuhën e pakicës në të cilën është zhvilluar procedura.

Procedura e shkallës së dytë gjithmonë zhvillohet në gjuhën serbe, ndërsa palët në procedurë, pjesëtarët e pakicave kombëtare, kanë të drejtë që gjatë kësaj procedure të përdorin gjuhën e vet. **Pismena u drugostepenom postupku i u vezi sa njim prevodi na jezik na kome je vođen prvostepeni postupak prvostepeni sud.**

Nëse procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, pjesëtari i pakicës kombëtare ka të drejtë që në procedurë të përdor gjuhën e vet. Ligjet e procesit parashohin obligimin e gjykatës që t'i këshillojë palët në procedurë dhe pjesëmarrësit e tjerë se mund të përcjellin procedurën gojore para gjykatës në gjuhë të vet, dhe atë me ndihmën e përkthyesit. Në procesverbal vendoset shënimi se këshilla është dhënë, si dhe deklaratat e palëve gjegjësisht pjesëmarrësve⁷⁰. Sipas Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit (neni 16 paragrafi 1 pika 1-3) organet shtetërore (në këtë rast gjykatat) në të cilat gjuha e pakicave kombëtare nuk është në përdorim zyrtar kanë obligimin që pjesëtarëve të pakicave kombëtare të cilët realizojnë të drejtat dhe obligimet tek ata, t'u sigurojnë mundësinë e përdorimit të gjuhës së vet në procedurë, që në atë gjuhë të parashtrojnë paditë, ankesat, lutje dhe parashtresat tjera, që me kërkesë të tyre në gjuhën e tyre t'u parashtrohen kopjet e vendimeve, gjykimeve dhe akteve të tjera me të cilat vendosen mbi të drejtat dhe obligimet e tyre. Ligji i njëjtë, në nenin 17 paragrafi 1, mundëson që procesverbali apo pjesë të caktuara të tij të përkthehen në gjuhën e pakicave, nëse kjo kërkohet nga pjesëtari i pakicës kombëtare, i cili është pjesëmarrës në procedurë. Përveç kësaj, pjesëtari i pakicës kombëtare, i cili është pjesëmarrës në procedurë, mund të kërkojë që deklaratat e palëve, dëshmitarëve, ekspertëve dhe të tjerëve të cilët marrin pjesë në procedurë, e që janë dhënë në gjuhën serbe të përkthehet edhe në gjuhën e tyre (neni 17 paragrafi 2). Ligjet procedurale parashohin që, nëse pala apo pjesëtarët e tjerë në procedurë përdorin gjuhën e vet (gjuha në të cilën nuk zhvillohet procedura), t'u përkthehet gojarisht ajo

⁷⁰ Neni 96 paragrafi 2 i Ligjit mbi procedurën kontestimore (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 125/2004 dhe 111/2009), neni 9 paragrafi 3 i Kodit të procedurës penale (*Gazeta zyrtare e RF të Jugosllavisë*, nr. 70/2001 dhe 68/2002 dhe *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 58/2004, 85/2005, 115/2005, 85/2005 – ligji i d., 49/2007, 20/2009 – ligji i d. dhe 72/2009), neni 86 paragrafi 4 i Ligjit mbi kundërvajtjet (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 101/2005, 116/2008 dhe 111/2009).

që parashtrohet në procedurë, si dhe dokumentet dhe materialet e tjera të shkruara⁷¹. Sipas nenit 98 paragrafi 1 i Ligjit mbi procedurën kontestimore dhe nenit 8 paragrafi 1 i Kodit të procedurës penale, paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera i drejtohen gjykatës në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në gjykatë. Me këtë rast, Kodi mbi procedurën penale në nenin 98 paragrafi 2 parasheh që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë të mund t'i drejtojnë gjykatës parashtresat e veta edhe në gjuhën e pakicave kombëtare e cila nuk është në përdorim zyrtar në gjykatë nëse kjo është në përputhje me ligjin. Kodi mbi procedurën penale nuk përmban një dispozitë të tillë. Gjykata parashtresat e veta iu dërgon palëve në procedurë në gjuhën e vet; gjykata i dërgon parashtresat me shkrim palëve dhe pjesëtarëve të tjerë në procedurë në gjuhën serbe; palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë të cilët janë pjesëtarë të pakicave kombëtare parashtrohen në gjuhën e pakicës të cilën e përdorin në procedurë, me kusht që ajo gjuhë është në përdorim zyrtar në gjykatë⁷². Dispozitat e këtyre dy ligjeve procedurale dhe Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve nuk janë të harmonizuara, pasi që, ashtu siç është cekur, Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve parasheh në nenin 16 paragrafi 1 pika 3 obligimin e organit në të cilin gjuha e pakicave nuk është në përdorim zyrtar që në gjuhën e pjesëtarit të pakicës i cili kërkon këtë, të dorëzojë kopjet e vendimeve, aktgjykimeve dhe akteve të tjera me të cilat vendoset për të drejtat dhe obligimet e tij në gjuhë të tij.

Përkthimi në procedurën gjyqësore nga dhe në gjuhën e pakicave kombëtare bëhet nga përkthyesit⁷³. Shpenzimet e përkthimit barten nga mjetet e gjykatës⁷⁴.

E drejta në përdorim të gjuhës dhe shkrimit të vet është e drejtë e rëndësishme e procesit të cilën e gëzon pala, dhe prandaj shkelja e saj përbën një shkelje thelbësore të procedurës⁷⁵. Nëse gjykata më e lartë në procedurës sipas ankesës konstaton se gjykata, vendimi i së cilës atakohet, ka refuzuar kërkesën që në procedurë të përdor gjuhën dhe shkrimin e vet, anulon aktgjykimin dhe e kthen lëndën në gjykatën e shkallës së parë.

Në kohën kur është bërë analiza, rrjeti i vjetër i gjykatave ishte ende në fuqi, ku ka ekzistuar mundësia që në gjykatat komunale procedura të zhvillohet edhe në gjuhën e pakicës kombëtare që është në përdorim zyrtar në territorin e komunës së caktuar. Mirëpo, me hulumtim kemi ardhur në përfundim se në gjykatat në Serbinë qendrore nuk zhvillohen procedura në gjuhët e pakicave kombëtare.

- Në gjykatën komunale në Bujanoc nuk kishte kushte për zhvillimin e procedurës në gjuhën shqipe, dhe as nuk janë theksuar kërkesat që procedurat të zhvillohen në këtë mënyrë.

⁷¹ Neni 96 paragrafi 1 i Ligjit mbi procedurën kontestimore, neni 9 paragrafi 2 i Kodit ligjor mbi procedurën penale, neni 86, paragrafi 3 i Ligjit mbi kundërvajtjet.

⁷² Neni 97 i Ligjit mbi procedurën kontestimore dhe neni 10 paragrafi 1 dhe 2 i Kodit mbi procedurën penale.

⁷³ Neni 17 i paragrafit 3 të Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit; neni 96 paragrafi 3 i Ligjit mbi procedurën kontestimore; neni 86 paragrafi 5 i Ligjit mbi procedurën kundërvajtëse.

⁷⁴ Neni 17 paragrafi 4 i Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit; neni 99 i Ligjit mbi procedurën kontestimore; neni 193 paragrafi 3 dhe 5 i Kodit të procedurës penale; neni 136 i Ligjit mbi procedurën penale.

⁷⁵ Neni 361 paragrafi 2 pika 8 e Ligjit mbi procedurën kontestimore; neni 368 paragrafi 1 pika 3 e Kodit të procedurës penale; neni 234 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit mbi procedurën kundërvajtëse.

- Në Gjykatën e atëhershme komunale në Bosilegrad konsideronin se nuk ka bazë ligjore për zhvillimin e procedurës në gjuhën bullgare, pasi që Statuti i Komunës parashihte që gjuha bullgare është në përdorim zyrtar në punën e organeve të komunës, ndërsa gjykata është një organ shtetëror.

- Në gjykatat në territorin e të cilëve në përdorim zyrtar është edhe gjuha boshnjake, procedurat zhvillohen në gjuhën serbe.

Në gjykatat në Vojvodinë kemi konstatuar se procedurat zhvillohen në gjuhën serbe, ndërsa në disa gjykata (Suboticë, Zrenjanin, Temerin, Senta) procedurat udhëhiqen edhe në gjuhën hungareze, por procesverbalet dhe vendimet, kryesisht, shkruhen në gjuhën serbe.

Organizimi i ri i gjyqësorit ka ndikuar në mundësinë e zhvillimit të procedurës edhe në gjuhën e pakicës kombëtare e cila është në përdorim në dy mënyra. Së pari, shumica e gjykatave komunale në të cilat gjuha e pakicës kombëtare ishte në përdorim zyrtar ka pushuar së ekzistuar në këtë cilësi dhe është bërë njësi e gjykatës të ndonjërit të gjykatave themelore. Edhe pse në rrethanat e reja është ruajtur mundësia që procedura në njësinë e gjykatës të zhvillohen në gjuhën e pakicës kombëtare⁷⁶, parashtrahet pyetja nëse në selinë e gjykatës themelore është e mundur të zhvillohet procedura në gjuhën e pakicës kombëtare i cili është në përdorim zyrtar në njërin prej njësive të gjykatës. Problemi i dytë rrjedh nga harmonizimi i strukturës së gjykatave të reja themelore ku hyjnë edhe njësitë e gjykatave me më shumë gjuhë të pakicave kombëtare në përdorim zyrtar. Rastet e këtilla posaçërisht janë të pranishme në gjykatat e KA të Vojvodinës, ku në përbërje të gjykatave themelore kanë hyrë gjykatat komunale në të cilat në përdorim zyrtar ishin gjuhë të shumta të pakicave. Me këtë hapet çështja e kapaciteteve të gjykatave dhe gjyqtarëve që në strukturën e re të sigurojnë realizimin e të drejtës në zhvillimin e procedurës në gjuhën e pakicës kombëtare. Edhe pse gjatë përzgjedhjes së gjykatës që kishte pasuar themelimin e rrjetit të ri të gjykatave duhet të tregonte kujdes për përbërjen nacionale dhe përfaqësimin adekuat të pakicave kombëtare, dhe në veçanti, për njohjen e gjuhës së rrethinës, nuk ekzistojnë të dhënat të besueshme nëse dhe në çfarë mase ky kriter ishte marrë parasysh gjatë përzgjedhjes.

Arsyet se pse një numër i vogël i procedurave zhvillohen në gjuhën e pakicave janë të ndryshme. Së pari, sipas Ligjit mbi përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve, procedura gjyqësore mund të zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare, vetëm nëse në të merr pjesë një palë (për shembull: në procedurë jashtëkontestimore), ndërsa kur marrin pjesë më shumë palë (gjë që edhe është rregull në procedurat gjyqësore) vetëm nëse njëra nga palët e interesuara kërkon që procedura të zhvillohet në gjuhën serbe. Së dyti, zhvillimi i procedurës në gjuhën e pakicës vështirësohen edhe nga problemet kadrovike. Në mënyrë që procedura të zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare, është e domosdoshme që gjykatësi, procesmbajtësi dhe avokatët të mund të kryejnë veprime procedurale në atë gjuhë. Duke marrë parasysh se në sistemin

⁷⁶ Sipas nenit 10 paragrafi 5 i Ligjit mbi rregullimin e gjykatave (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 116/2008 dhe 104/2009) në gjykata, në drejtori jashtë selisë së gjykatave dhe në njësitë e gjykatave në përdorim zyrtar janë edhe gjuhë dhe shkrime të tjera, në përputhje me ligjin. Me Rregulloren e re të punës së gjykatave (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr.110/2009) në nenin 108 paragrafi 1 është paraparë që procedura gjyqësore të mund të zhvillohet në gjuhën e pakicës kombëtare, nëse gjuha e pakicës kombëtare është në përdorim zyrtar në gjykatë, në përputhje me dispozitën të veçanta (shënime në shkronja kurzive nga MQ).

edukativ nuk zhvillohen ligjëratat, të mësuarit dhe as përsosja e terminologjisë juridike në gjuhët e pakicave kombëtare, si dhe nuk janë përcaktuar kriteret dhe mënyrat e vërtetimit të dijës së gjuhës së pakicave, përdorimi i gjuhës së pakicave në gjykata është vështirësuar. Së treti, janë të pranishme edhe problemet teknike, të cilat pasqyrohen në atë se ligjet e rëndësishme (materiale dhe të procesit) të cilat duhet të aplikohen në procedurë, nuk janë të përkthyer në gjuhën e pakicave, gjë që vështirëson punën. Krahas kësaj, duke qenë se procedurat të cilat zhvillohen në gjuhën e pakicave në shkresat (procesverbalet, vendimet) mbahen në dy gjuhë, kjo edhe më tej komplikon procedurën. Së katërti, duke pasur parasysh synimin që drejtësia të realizohet sa më shpejtë, palët nuk theksojnë kërkesën që procedurat të zhvillohen në gjuhën e pakicës. Për më tepër, kërkesat e këtilla më së shpeshti edhe theksohen atëherë kur synohet të zgjatet procedura.

Në kuptim të realizimit të të drejtave në përdorim të gjuhës së pakicave kombëtare në procedurë, gjendja është më e mirë. Duke pasur parasysh se shkelja e të drejtave në përdorim të gjuhës është shkelje thelbësore e procedurës, për shkak të të cilave mund të anulohet aktgjykimi, gjykatësit njoftojnë palën se ka të drejtë të përdor gjuhën e vet. Parashtrahet pyetja nëse gjykatësit njoftojnë palët mbi këtë të drejtë në mënyrë të duhur, dhe nëse ky njoftim ndonjëherë është sugjestiv, por kjo edhe nuk është e rëndësishme aq të madhe kur pala ka avokatin. Nëse pala apo ndonjë pjesëmarrës tjetër në procedurë deklarohet se dëshiron të përdor gjuhën e vet, gjykata angazhon përkthyesin. Përdorimi i gjuhës në procedurë në rend të parë i referohet komunikimit gojor në seancë gjegjësisht në dëgjim. Komunikimi me shkrim me rregull parashtrahet në gjuhën serbe, ndërsa shumica e gjykatave posedojnë formularë shumëgjuhësorë standardë. Njëri prej problemeve në implementim të të drejtave për përdorim të gjuhës së pakicave në procedurë është i natyrës financiare. Shpenzimet e interpretimit dhe përkthimit janë në barrë të gjyqit, me ç'rast gjatë përgatitjes së buxhetit të gjykatës nuk merret parasysh apo nuk merret parasysh sa duhet shumëgjuhësia e rrethinës.

6. Gjuhët e pakicave kombëtare në procesin zgjedhor

Sipas Ligjit mbi pakicat kombëtare (neni 11 paragrafi 4), përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave kombëtare nënkupton edhe përdorimin e këtyre gjuhëve në fletëvotime dhe materialin zgjedhor. Përdorimi i gjuhëve të pakicave kombëtare në procesin zgjedhor rregullohet me Ligjin mbi zgjedhjen e deputetëve popullor⁷⁷ dhe Ligjin mbi zgjedhjet lokale (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 129/2007). Të dy ligjet parashohin që në komunat ku në të cilat gjuhët e pakicave kombëtare janë në përdorim zyrtar, fletëvotimet dhe procesverbali mbi punën e komisionit zgjedhor botohen edhe në këto gjuhë⁷⁸.

Marrëveshja bilaterale me Kroacinë mbi mbrojtjen e ndërsjellët të pakicave kombëtare, në nenin 6 pika 2 alineja 3 shprehimisht parasheh që shtetet do të sigurojnë përdorimin e gjuhës

⁷⁷ *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 35/2000, 57/2003 – vendimi i GJKRS-së, 72/2003 – ligji i d., 75/2003 – korrigjimi i ligjit të d., 18/2004, 101/2005 – ligji i d., 85/2005 – ligji i d. 104/2009 – ligji i d.

⁷⁸ Neni 60 paragrafi 6 dhe neni 76 paragrafi 2 i Ligjit mbi zgjedhjen e deputetëve dhe neni 28 paragrafi 7 dhe paragrafi 37 paragrafi 2 i Ligjit mbi zgjedhjet komunale.

dhe shkrimit të pakicës kombëtare në procedurën e zbatimit të zgjedhjeve dhe referendumeve lokale.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale obligimi i shtypjes së fletëvotimeve dhe procesverbaleve mbi punën e komisioneve zgjedhore në gjuhët e pakicave respektohen denjësisht. Botimi i formularëve është i centralizuar, dhe asnjë njësi e vetëqeverisjes lokale nuk ka spikatur vështirësi lidhur me këtë. Ç'është e vërteta, disa herë na është thënë se formularët mbi punën e komisionit zgjedhor plotësohet vetëm në një gjuhë.

Ligji mbi këshillat nacionale parasheh mundësinë e përdorimit të gjuhës së pakicës kombëtare për zgjedhjen e këshillit nacional të pakicës kombëtare. Sipas nenit 54 të këtij ligji lista e veçantë zgjedhore dhe të dhënat të cilat vendosen në këtë regjistër mbahen në të njëjtën kohë në gjuhën serbe dhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare për të cilën mbahet regjistri zgjedhor. Përveç kësaj, Ligji në nenin 89 parasheh që tërë materiali dhe dokumentacioni zgjedhor shtypen në dy gjuhë, në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik dhe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare këshilli nacional i të cilit është duke u zgjedhur.

7. Përdorimi i gjuhëve të pakicave kombëtare në organet përfaqësuese

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, në nenin 11 paragrafin 4 parasheh që përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare përfshin edhe përdorimin e gjuhës në punën e organeve përfaqësuese. Segmenti më i rëndësishëm i kësaj të drejte është e drejta e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, të cilët ushtrojnë funksion të deputetit në nivel kombëtar apo komunal që, në kuvendet republikane, krahinore dhe lokale të flasin në gjuhën e vet, si dhe të parashtrojnë dhe të pranojnë materiale në gjuhën e vet. Sipas nenit 11 paragrafi 8 Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, deputetët në parlamentin republikan të cilët i takojnë pakicave kombëtare, numri i të cilëve në popullatën e përgjithshme arrin së paku 2% sipas regjistrimit të fundit të popullsisë kanë të drejtë që në parlament të drejtohen me gjuhën e vet. Deputeti i Kuvendit popullor (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 14/2009) në nenin 240 paragrafi 2 parasheh të drejtën e deputetit kombëtar që në mbledhjet e Kuvendit popullor të flasin në gjuhën amtare dhe të parashtrojnë dokumentet me shkrim mbi punën e Kuvendit popullor në atë gjuhë. Neni 240 paragrafi 3 i Rregullores së punës obligonte deputetin kombëtar i cili synon të shfrytëzojë të drejtën e vet për të folur, gjegjësisht për të parashtuar materiale në gjuhën e vet, për këtë të njoftojë me kohë sekretarin e Kuvendit popullor, për shkak të përkthimit të fjalimit me gojë apo dokumentit në gjuhën serbe. Rregullorja e re e punës e Kuvendit popullor e miratuar më 28 korrik 2010 nuk rregullon mënyrën sesi deputetët flasin dhe pranojnë përgjigje në gjuhën e vet.

Statuti i KA të Vojvodinës i cili ishte në fuqi deri më 14 dhjetor 2009 në nenin 26 përmbante një dispozitë eksplicite mbi të drejtën e deputetëve që në Kuvendin e KA të Vojvodinës të përdorin gjuhën dhe shkrimin përdorimi i të cilëve rregullohet me Statut. Statuti i ri i KA të Vojvodinës nuk përmban ndonjë dispozitë të këtillë, por e drejta në përdorim të gjuhës së vet në punën e Kuvendit krahinor mund të mbështetet në neni 26 paragrafi 1 i Statutit me të cilin përcaktohet se cilët gjuhë dhe shkrime janë në përdorim zyrtar në organet e KA të Vojvodinës, duke marrë parasysh se KA e Vojvodinës është "organi më i lartë" në KA të Vojvodinës (neni 33 i Statutit). Me Rregulloren e punës së Kuvendit të KA të Vojvodinës (*Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr.

23/2002, 30/2004, 4/2008 dhe 13/2009) parashihet që në përdorim zyrtar në punën e Kuvendit popullor janë gjuhët hungareze, kroate, sllovaqe, rumune dhe rusine dhe shkrimet e tyre (neni 5). Rregullorja e punës shprehimisht parasheh të drejtën e deputetëve që në Kuvend të përdorin gjuhën dhe shkrimin e vet, përdorimi zyrtar i të cilëve parashihet me Statut (neni 223).

Ligji mbi përdorimin e vetëqeverisjes lokale nuk përmban ndonjë dispozitë eksplicite mbi përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare në punën e kuvendeve lokale, por dispozita e përgjithshme mbi përcaktimin e gjuhëve të cilat janë në përdorim zyrtar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale përfshin edhe punën e këtyre organeve. Njësia e vetëqeverisjes lokale në të cilat në përdorim zyrtar është gjuha e pakicës kombëtare, përmbajnë zgjidhje të ndryshme përkthimi me të drejtën e deputetëve në përdorim zyrtar të gjuhës së vetë në punën e organeve lokale, prandaj disa përmbajnë dispozitë eksplicite me të cilën posaçërisht theksojnë këtë të drejtë, ndërsa disa rregullojnë këtë të drejtë në mënyrë të veçantë.

Cilësia e realizimit të së drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës në punën e organeve përfaqësuese ndryshon në nivele të ndryshme të organeve. Edhe pse ekziston korniza ligjore për përdorimin e gjuhës së pakicës kombëtare në Kuvendin kombëtar, kjo e drejtë nuk realizohet në praktikë. Në Kuvendin kombëtar në fund të vitit 2009, kur hulumtimi kishte përfunduar, nuk kanë ekzistuar mundësitë teknike për përkthim simuluan të fjalimeve të deputetëve popullor, prandaj të gjithë deputetët flasin në gjuhën serbe. Materialet e kuvendit gjithashtu parashtrohen në gjuhën serbe.

Në Kuvendin e KA të Vojvodinës është ndryshe – në punën e vet ekziston një praktikë e rregullt që deputetët të mund të flasin në të gjitha gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar. Kuvendi ka shërbimin e përkthimit dhe teknikisht është e pajisur për përkthimin simuluan të mbledhjeve. Materialet gjithashtu parashtrohen në të gjitha gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në punën e Kuvendit, me ç'rast në fillim të çdo mandati deputetët deklarohen se në cilën gjuhë dëshirojnë t'i pranojnë materialet e kuvendeve.

Përvojat në lidhje me përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare në punën e kuvendeve lokale janë të ndryshme. Në qytetin e Novi Pazarit dhe kuvendeve Tutin, Prijepolje dhe Sjenica të cilat në përdorim zyrtar kanë vënë edhe gjuhën dhe shkrimin boshnjak, kuvendarët në kuvendet lokale drejtohen në gjuhën e "vet", ndërsa për shkak të kuptimit të gjuhës nuk ekziston nevoja për përkthim simultan. Materialet e kuvendit parashtrohen sipas kërkesës së deputetëve në shkrimin cirilik dhe latin, me ç'rast vetëqeverisjet lokale kanë problem me përdorimin e gjuhës standarde letrare boshnjake, me ç'rast vetëqeverisjet lokale kanë problem me përdorimin e gjuhës standarde letrare boshnjake, prandaj aktet në gjuhën latine më së shpejti janë përshkrime të tekstit në gjuhën serbe. Në komunat në Serbinë jugore, në të cilat në përdorim zyrtar është edhe gjuha shqipe, në punën e organeve të kuvendeve komunale delegatët flasin dhe marrin materialet e kuvendit në gjuhën e tyre. Sipas bashkëbiseduesve në komunën e Medvegjës ekziston problemi në lidhje me përkthimin gjegjës, kështu që këshilltarët pjesëtarë të pakicës kombëtare shqiptare shpesh kërkojnë që materialet t'u dorëzohen edhe në gjuhën serbe, pasi që përkthimet në gjuhën shqipe janë të cilësisë së dobët. Në Bosilegrad këshilltarët drejtohen në gjuhën e "vet", nuk ka kërkesë për përkthim simuluan, ndërsa materialet shtypen në gjuhën serbe dhe bullgare. Në njësitë e vetëqeverisjeve lokale në Vojvodinë dhe Senti, Suboticë dhe Temerinë këshilltarët iu drejtohen kuvendit edhe në gjuhët e pakicave

(hungareze) dhe marrin materialet e kuvendit edhe në këtë gjuhë. Në qytetet dhe komunat e tjera, në punën e kuvendeve lokale përdoret gjuhët serbe, ndërsa materialet dorëzohen në gjuhën serbe, në shkrimin cirilik dhe latin. Në këto njësi të vetëqeverisjes lokale këshilltarët shpesh nuk kërkojnë që të sigurohen kushtet në kuvendet komunale për të folur në gjuhën e pakicave kombëtare, ndërsa problemet të cilët pamundësojnë realizimin e kësaj të drejte janë edhe kushtet e dobëta teknike për përkthim simuluan dhe kapacitet e pamjaftueshme kadrovike për përkthimin e materialeve të kuvendit.

8. Publikimi i akteve në gjuhët e pakicave kombëtare

Për realizimin e të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave është me rëndësi që aktet e përgjithshme juridike të botohen edhe në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar. Gjatë ratifikimit të Kartës Evropiane të gjuhëve rajonale dhe të pakicave, Serbia ka marrë përsipër obligimin që të sigurojë qasje ligjeve më domethënëse, e posaçërisht atyre të cilat kanë të bëjnë me personat të cilët i përdorin këto gjuhë, në dhjetë gjuhë të pakicave kombëtare (neni 9 paragrafi 3), si dhe që qeveritë rajonale dhe lokale t'i botojnë dokumentet e tyre zyrtare edhe në këto gjuhë (neni 10 paragrafi 2 pika c dhe d).

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të pakicave kombëtare në nenin 11 paragrafi 6 parasheh që ligjet dhe rregulloret republikane të botohen edhe në gjuhët e pakicave kombëtare, me ç'rast rregullimin më të hollësishëm të kësaj çështjeje Ligji i lë një rregulloreje të posaçme. Publikimi i ligjeve dhe ligjeve republikane rregullohet me një ligj të veçantë⁷⁹, por ai është sjellë në vitin 1991 dhe nuk parasheh botimin e akteve të përgjithshme të akteve të Republikës edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Me këtë Ligj parashihet që edhe aktet e përgjithshme të krahinës autonome, të komunës dhe të qytetit të botohen në mënyrën e përcaktuar nga krahina autonome, komuna dhe qyteti (neni 1 paragrafi 2). Në përputhje me këtë, publikimi i akteve krahinore rregullohet me Statutin e KA të Vojvodinës, ku përcaktohet se aktet të cilat botohen në *Gazetën Zyrtare të KA të Vojvodinës* botohen edhe në gjuhët të cilët janë në përdorim zyrtar në Krahinë⁸⁰.

Mënyra e publikimit të akteve të përgjithshme të njërive të vetëqeverisjes lokale përcaktohet me statutin e tyre, por më së shpeshti jo edhe në cilat gjuhë botohen, por të rralla janë njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilat orientohen që aktet të botohen edhe në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar në territorin e tyre⁸¹.

Aplikimi i së drejtës në lidhje me botimin e akteve të përgjithshme në gjuhët e pakicave kombëtare gjithashtu dallon, por në përgjithësi nuk iu përgjigjet standardeve ndërkombëtare dhe rregulloreve kombëtare. Ligjet dhe dispozitat e tjera republikane nuk publikohen në gjuhët

⁷⁹ Ligji mbi botimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera dhe akteve të përgjithshme mbi lëshimin e *Gazetës Zyrtare të Republikës së Serbisë*, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 72/91 dhe "Gazeta Zyrtare e RFJ-së", nr. 11/93 – vendimi i **CYC**; *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 30/2010 .

⁸⁰ Neni 46 paragrafi 3 i Statutit të vjetër (ka pushuar së qeni në fuqi më 14 dhjetor 2009), neni 65 paragrafi 3 i Statutit të ri.

⁸¹ Dispozitë të tillë përmban për shembull Statuti i qytetit të Suboticës (neni 102 paragrafi 1, Statuti i qytetit të Somborit (neni 115 paragrafi 4), Statuti i komunës Senta (neni 80 paragrafi 1), Statuti i komunës Bujanoc (neni 87 paragrafi 2).

e pakicave kombëtare, dhe nuk janë në dispozicion as përkthimet e ligjeve më me rëndësi në këto gjuhë. Sipas informatave të Ministrisë për të drejta të njeriut dhe të pakicave, vetëm Ligji mbi pakicat kombëtare është i përkthyer në gjuhët e pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar, dhe ishte parashikuar edhe përkthimi i Ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare. Gjithashtu na është thënë që kjo Ministri në disa raste kishte vënë në pah nevojën që ligjet më me rëndësi të përkthehen në gjuhët e pakicave kombëtare, por që nuk ka pasur kurrfarë përgjigje.

Mungesa e ligjeve në gjuhët e pakicave kombëtare vështirëson në masë të madhe të drejtën në përdorimin zyrtar të gjuhës, në veçanti në procedurat administrative dhe gjyqësore, pasi që nëpunësit duhet të mbështeten në tekstet në gjuhën serbe, ndërsa në zbatim të përdorin gjuhën e pakicës kombëtare, me ç'rast për shkak të mungesës së përkthimit zyrtar nuk ekziston standardizimi i përkthimit të nocioneve të cilat përdoren në tekstin origjinal të ligjit.

Publikimi i akteve të përgjithshme të organeve krahinore bëhet në përputhje me dispozitën e Statutit të KA të Vojvodinës. Në kuadër të Sekretariatit Krahinor për rregullore, administratë dhe pakica kombëtare ekziston Shërbimi i përkthimit i cili, ndër të tjera, përkthen dhe lekturon aktet të cilat botohen në *Gazetën Zyrtare të KA të Vojvodinës*. Në Kuvendin e KA të Vojvodinës ekziston edhe Këshilli për vërtetimin e saktësisë së rregulloreve krahinore në gjuhët në përdorim zyrtar i cili përcakton saktësinë e teksteve të rregulloreve, vendimeve dhe akteve të përgjithshme të cilat i sjell Kuvendi në gjuhët përdorimi zyrtar i të cilëve përcaktohet me Statut kundrejt gjuhës serbe dhe për këtë njofton Kuvendin⁸².

Mënyra e publikimit të akteve të përgjithshme të njërive të vetëqeverisjes lokale është e ndryshme. Aktet e përgjithshme të qytetit të Novi Pazarit botohen në *Gazetën Zyrtare të qytetit të Novi Pazarit* dhe atë në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik dhe atë boshnjake në shkrimin latin; komnatat e Medvegjës dhe Bujanocit aktet e veta të përgjithshme i boton në gjuhët serbe dhe shqiptare dhe në shkrimet përkatës në *Gazetën Zyrtare të qytetit të Leskovcit*, aktet e përgjithshme të qytetit të Suboticës botohen në tre gjuhë, në gjuhën serbe, hungareze dhe kroate dhe shkrimet e tyre, aktet e përgjithshme të qytetit të Somborit dhe të komunës Senta botohen në gjuhën serbe dhe hungareze. Në komunën Srbobran aktet e përgjithshme botohen në gjuhët serbe dhe hungareze, por jo paralelisht, por në gazeta të veçanta zyrtare, dhe prandaj botimi i akteve në gjuhën hungareze vonohet. Në komunën Temerin aktet në gjuhën hungareze nuk botohen përnjëherë, por bëjnë përkthimin e tyre të mëvonshëm. Në këtë komunë na është thënë se janë në vonesë me përkthime, dhe për shkak të kësaj në vitin e kaluar nuk i kanë përkthyer të gjitha aktet, gjë që do të duhet të ndryshojë në të ardhmen.

Publikimi i akteve të përgjithshme të njësisë së vetëqeverisjes lokale në gjuhët e pakicave kombëtare është vështirësuar në komunat të cilat për shkak të arsyeve financiare nuk kanë një gazetë zyrtare komunale por janë të obliguara që aktet e veta t'i botojnë në gazetatat tjera zyrtare. Në praktikë është paraqitur problemi i publikimit të akteve të këtilla në gazetatat zyrtare të cilat janë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale në të cilat gjuhët e pakicave kombëtare nuk janë në përdorim zyrtar. Aktet e përgjithshme të komunave të Bujanovcit dhe Preshevës

⁸² Shih nenin 65 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të KA të Vojvodinës.

botohen në *Gazetën Zyrtare të qytetit të Leskovcit* në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik si dhe në gjuhën shqiptare dhe shkrimin shqip, të cilat janë në përdorim zyrtar në këto komuna. Qyteti i Vranjës refuzon t'i publikojë aktet e komunave Bujanovc dhe Preshevë, në gjuhën dhe shkrimin shqip, pasi që sipas dispozitave të nenit 2 dhe nenit 28 të Vendimit mbi botimin e rregulloreve të qytetit dhe akteve të tjera dhe mbi botimin e *Gazetës Zyrtare të qytetit të Vranjes dhe komunave të qarkut administrativ të Pqinjit*, të cilën Kuvendi i Qytetit të Vranjes kishte sjellë në mbledhjen e 20.05.2009, është paraparë që rregulloret dhe aktet tjera të botohen vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik. Aktet e përgjithshme të komunës Bosilegrad botohen në gazetën zyrtare të komunës, por vetëm në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik, por aktet e veçanta botohen në dy gjuhë dhe vendosen në tabelën e shpalljeve.

9. Kapacitetet për realizim efikas të së drejtës në përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare

Republika e Serbisë ka përvetësuar standarde të larta në lidhje me mbrojtjen e të drejtës për përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare, por me këtë rast janë shpërfillur rrethanat në të cilat këto standarde duhet të aplikohen. Ndonjëherë duket se gjatë përgatitjes së zgjidhjeve të caktuara ligjore nuk është bërë ndonjë studim më serioz i zbatueshmërisë dhe se në segmente të caktuara të drejtat janë përcaktuar në një mënyrë e cila e bën të pamundur të realizohen në tërësi. Kjo, në masë të madhe, shkakton një mospërputhje të dukshme ndërmjet rregullativës dhe zbatimit të saj në praktikë, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare. Mangësitë në zbatimin e kësaj të drejte rrjedhin nga kapacitetet e pamjaftueshme të organeve të administratës publike, në rend të parë njësitë të vetëqeverisjes lokale, për përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare. Faktori vështirësues në këtë kuptim janë shpenzime të larta materiale, nevoja për themelimin e shërbimeve të veçanta dhe sistematizimin vendeve të punës të përkthyesve dhe lektorëve dhe nevojën për një strukturë të baraspeshuar nacionale të të punësuarve në organet dhe organizatat me kompetenca publike.

Përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare ngarkon si buxhetin shtetëror ashtu edhe atë krahinor, si dhe buxhetet e njësitë të vetëqeverisjes lokale, por gjatë planifikimit dhe miratimit të buxhetit shtetëror nuk merren parasysh shpenzimet të cilat përcjellin përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare. Njësitë e vetëqeverisjes lokale në Serbinë qendrore në të cilat gjuhët e pakicave kombëtare janë në përdorim zyrtar nuk marrin mjete shtesë për implementim të kësaj të drejte. Në KA të Vojvodinës njësitë e vetëqeverisjes lokale në këtë aspekt janë në një pozitë më të favorshme, pasi që Sekretariati krahinor për rregullore, administratë dhe pakica kombëtare çdo vit shpall konkurs për ndarjen e mjeteve buxhetor për organet dhe organizatat e KA të Vojvodinës në punën e të cilëve janë në përdorim zyrtar gjuhët dhe shkrimet e pakicave kombëtare. Mjetet përdoren për bashkëfinancim të projekteve qëllimi i të cilëve është avancimi i të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në KA të Vojvodinës. Në konkurs mund të marrin pjesë organet e komunës dhe qytetet në territorin e KA të Vojvodinës në të cilat me statut përcaktohet përdorimi i gjuhës së pakicave kombëtare në vetëqeverisje lokale, si dhe si dhe në organe, organizata, shërbime dhe institute të tjera në territorin e kësaj komune. Mjetet ndahen për aftësimin e të punësuarve në

organet dhe organizatat të cilat përdorin gjuhën e pakicave komunale e cila është në përdorim zyrtar dhe për zhvillimin e sistemit të administratës elektronike për punë në kushte të shumëgjuhësisë, si dhe për shpenzimet e përpunimit dhe vendosjes së tabelave për shenjzimin e emrave të organeve dhe organizatave, si dhe shenjave topografike, për shtypje të formularëve dygjuhësorë apo shumëgjuhësorë dhe gazetave zyrtare si dhe botimeve të tjera publike. Kësi mbështetje për njësitë e vetëqeverisjes lokale në Serbinë qendrore nuk ekziston, dhe vendosjen eventuale të saj duhet kërkuar në iniciativa dhe realizim të kompetencave të Ministrisë për administratën shtetërore dhe vetëqeverisje lokale, Ministrisë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave kombëtare si dhe Ministrisë së financave.

Problemi tjetër ka të bëjë me problemet kadrovike. Përdorimi zyrtar i gjuhës së pakicave kombëtare kërkon specifika në sistematizimin e vendeve të punës, pasi që për implementim efikas kërkohen përkthyes dhe lektorë. Shërbime të zhvilluara të përkthimit kanë vetëm organet krahinore, ndërsa situata në njësi të vetëqeverisjes lokale është e ndryshme. Për shembull, në administratën e qytetit të Novi Pazarit është sistematizuar dhe plotësuar vendi i punës së lektorit për gjuhën boshnjake. Në komunat e Medvegjës dhe Bujanocit janë sistematizuar dhe plotësuar dy vende të punës së përkthyesve për gjuhën shqipe, por ekziston edhe problemi në nivelin e njohjes së gjuhës shqipe letrare, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e përkthimit. Në komunën e Prijepoljës nuk ekziston lektori për gjuhën boshnjake, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e përkthimit. E njëjta situatë është edhe në komunën Bosilegrad, ku nuk ekziston përkthyes zyrtar komunal. Në qytetet dhe komunat e KA të Vojvodinës, shërbimet e përkthimit, gjegjësisht vende të sistematizuara të punës së përkthyesve i kanë qytetet e Suboticës, komunat Senta dhe Temerin. Në Kuvendin e qytetit të Somborit është sistematizuar vendi i punës së përkthyesit për gjuhën hungareze, dhe kështu shërbimet e tij sipas nevojës i përdorin edhe organet e tjera të Qytetit. Në komunën e Stara Pazovës është sistematizuar një vend i punës së përkthyesit në gjuhën sllovaqe, por nuk është plotësuar. Në komunat Alibunar, Kovaqicë, Novi Sad, Srbobran, Shid, Vrshac dhe Zrenjanin nuk ekzistojnë poste të përkthyesve dhe këto njësi të vetëqeverisjes lokale sipas nevojës mbështeten në dijen e të punësuarve të tyre, përdorin shërbime të përkthimit të Sekretariatit Krahinor për rregullativë, administratë dhe pakica kombëtare apo angazhojnë përkthyes të autorizuar.

Në përdorimin efikas dhe cilësor zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare ndikon negativisht dhe përfaqësimi i pamjaftueshëm i pakicave kombëtare në organet publike, si dhe në organizata me kompetenca publike. *Kushtetuta* në nenin 77 paragrafi 1 parasheh që gjatë punësimit në organet shtetërore, shërbimet publike, organet e krahinës autonome dhe njësitë të vetëqeverisjes lokale të ushtrojnë kujdes për përbërjen kombëtare të popullatës dhe për përfaqësimin adekuat të pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Neni 21 i Ligjit mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare parasheh shprehimisht që gjatë punësimit në organet publike, përfshirë edhe policinë, të kenë parasysh përbërjen nacionale të popullatës, përfaqësimin përgjegjës dhe për njohjen e gjuhës i cili flitet në territorin e organit apo shërbimit, por në praktikë është e dukshme mungesa e kuadrove të cilët njohin gjuhën përkatëse të

gjuhës së pakicës kombëtare i cili është në përdorim zyrtar.⁸³ Në këtë situatë dukshëm ndikon edhe marrëdhënia e paqartë e shtetit kundrejt shumëgjuhësisë dhe mosekzistimi i politikës adekuate shtetërore për shumëgjuhësinë. Edhe pse në shkollat e Serbisë kryhet mësimi edhe në gjuhët e pakicave, kjo nuk i kontribuon zhvillimit të dygjuhësisë (shumëgjuhësisë) së baraspeshuar, gjegjësisht nuk mundëson që dija dhe kompetencat të zhvillohen paralelisht në të dy gjuhët. Pjesëtarët e shumicës rrallëherë flasin ndonjë gjuhë të pakicave në nivelin i cili është pak më shumë se ai bashkëbisedues, ndërsa janë gjithnjë e më të shpeshta rastet kur edhe pakicat tërhiqen nga aspekti gjuhësor dhe flasin më dobët gjuhën e shumicës. Kjo gjithsesi ndikon edhe në cilësinë e përdorimit zyrtar të gjuhës së pakicave, pasi që janë të rrallë të punësuarit të cilët flasin të dy gjuhët (edhe të shumicës edhe të pakicës) në nivelin i cili mundëson kryerjen cilësore të punës në çdonjërin prej tyre.

⁸³ Në maj të vitit 2006 Qeveria e Serbisë ka sjellur Konkluzën mbi masët për rritjen e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në organet e administratës shtetërore (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 40/2006).

VI Konkluzioni

Ashtu siç është thënë, rendi ligjor i Serbisë parashtron standarde të larta në lidhje me të drejtën në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave kombëtare, por nuk ofron mekanizëm efikas për realizimin e kësaj të drejte dhe në shumë aspekte nuk paraqet një bazë efektive ligjore. Ndonjëherë duket se aktet relevante janë reciprokisht të izoluara dhe se nuk ekziston një “element lidhës”, gjegjësisht një koncept i qartë i shumëgjuhësisë të cilën shteti dëshiron të promovojë përmes rregullativës ligjore.

Mangësitë në nivelin normativ pasqyrohen edhe në atë që shumica e dispozitave të rëndësishme që garantojnë të drejtën në përdorim zyrtar të gjuhës së pakicave janë të karakterit deklarativ, për zbatimin efikas të të cilave nevojitet rregullativa përkatëse nënligjore. Në KA të Vojvodinës aktet e këtilla janë sjellë dhe në disa aspekte janë tejkaluar mangësitë e përmendura.

Përveç kësaj, duhet të ceket se disa standarde janë mjaft ambicioze, dhe prandaj në rrethanat ekzistuese shoqërore nuk është reale të përmbushen, që ndikon edhe më tej në hendekun ndërmjet gjendjes normative dhe reale. Në këtë kuptim, është edhe një dobësi domethënëse edhe fakti që shteti, krahas miratimit të rregullativës, nuk ka ndërtuar apo i ka kontribuar ngritjes së kapaciteteve për zbatimin efektiv të të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare.

Sipas analizës së të dhënave të hulumtimit i cili, siç është thënë, është kryer në pjesën e dytë të vitit 2009 dhe plotësuar me monitorimin e gjendjes në lidhje me realizimin e të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në vitin 2010, janë vërejtur problemet vijuese:

1. Nuk ekziston mekanizëm efektiv juridik në bazë të të cilit njësitë e vetëqeverisjes lokale do të futnin në mënyrë obliguese gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare në përdorim zyrtar në territorin e vet nëse për të është plotësuar kushti ligjor, gjegjësisht nëse me Regjistrin e fundit të popullsisë është paraparë që në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale banojnë 15% të banorëve të cilat i takojnë pakicave kombëtare.
2. Administrata shtetërore nuk inkurajon në masë të plotë, dhe në përputhje me standardet e miratuara ndërkombëtare dhe sistemin kushtetues ligjor, zbatimin e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicës kombëtare, gjegjësisht shumëgjuhësinë dhe dygjuhësinë. Shteti nuk planifikon dhe as nuk ndan mjete për zbatim të të drejtave në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare. Mësimi i gjuhës së pakicave kombëtare, si dhe gjuhës së rrethinës shoqërore, nga ana e pjesëtarëve të bashkësive etnike është i vogël dhe fakultativ, ndërsa mësimi i gjuhës serbe në njësitë e caktuara të vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e pakicave kombëtare përbëjnë shumicën është në një nivel i cili nuk kënaq integrimin shoqëror.
3. Paragjykimet dhe distanca e theksuar etnike në pjesë të caktuara të vendit pamundësojnë futjen e gjuhës së pakicave të caktuara kombëtare në përdorim zyrtar.

4. Mungesa e kuadrit profesional për sigurimin e kushteve për punësimin në sektorin publik dhe në vetëqeverisje lokale të qytetarëve të cilat flasin gjuhën serbe dhe gjuhët e pakicave kombëtare.
5. Shteti nuk nxit kushtet për përdorim të papenguar, në përputhje me ligjin, të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në punën e organeve shtetërore. Gjithashtu, shumica e njësive të vetëqeverisjes lokale nuk disponon kushtet teknike dhe kadrovike për komunikimin zyrtar në punën e organeve të vetëqeverisjes lokale.
6. Në lidhje me regjistrimin e emrit personal në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare në librin amë:
 - Zbatimi i ndryshëm i ligjit në shërbimet e ofiqarisë në njësitë e vetëqeverisjes lokale
 - Pamundësia e regjistrimit të mbiemrave femëror në formën femërore në përputhje me traditën e gjuhës së pakicave kombëtare
 - Mosekzistimi i formularëve dygjuhësorë të certifikatave nga librat amë në Serbinë qendrore
7. Në lidhje me lëshimin e dokumenteve personale:
 - Informimi joadekuat i qytetarëve pjesëtarë të pakicave kombëtare lidhur me kushtet e parapara me ligj për lëshimin e dokumenteve me emrin e regjistruar në gjuhën e pakicave kombëtare
 - Pamundësia faktike e regjistrimit të emrit personal në letërnjoftim dhe në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik dhe në gjuhën e shkrimit të pakicave kombëtare
 - Pamundësia e regjistrimit të mbiemrit të kombinuar në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare si dhe në gjuhën serbe dhe shkrimin cirilik
8. Shkrimi i shenjave dhe emërtimeve topografike të vendbanimeve, rrugëve dhe emërtimeve theksohet në mënyrë jo të duhur, vendosja e emërtimeve të njësive organizative republikane dhe ndërmarrjeve publike republikane edhe në gjuhët e pakicave kombëtare është selektive dhe në shumicën e njësive të vetëqeverisjes lokale këto emërtime nuk vendosen edhe në gjuhët dhe shkrimet e pakicave kombëtare.
9. Mosekzistimi i formularëve për komunikimin zyrtar me palët, pjesëtarët e pakicave kombëtare, në gjuhën e tyre dhe praktika e pazhvilluar e komunikimit me shkrim të qytetarëve pjesëmarrës të pakicave kombëtare dhe organeve publike në gjuhën e pakicave kombëtare.
10. Ligjet dhe dokumentet më me rëndësi nuk përkthehen në gjuhët e pakicave kombëtare.
11. Aktet dhe vendimet e organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale nuk publikohen si duhet në gazetatat zyrtare edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Ky problem është posaçërisht i theksuar gjatë publikimit të akteve në gazetatat zyrtare të themeluara për më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale ku gjuhët e pakicave nuk janë në përdorim zyrtar në çdonjërin prej tyre.
12. Nuk ekzistojnë kapacitete të duhura për zhvillimin efikas të procedurave administrative dhe gjyqësore në gjuhët e pakicave kombëtare.

13. Përfaqësimi i pamjaftueshëm i pjesëtarëve të pakicave kombëtare apo qytetarëve të cilët flasin gjuhët e pakicave në organet e administratës publike.

BURIMET LIGJORE

1. Kushtetuta e Republikës së Serbisë, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 98/2006. [*Kushtetuta*]
2. Ligji mbi ratifikimin e Kartës Evropiane mbi gjuhët rajonale dhe të pakicave, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 18/2005. [*Karta Evropiane*]
3. Ligji mbi vërtetimin e Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, *Gazeta Zyrtare e RF të Jugosllavisë – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 6/98. [*Konventa Kornizë*]
4. Ligji mbi ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Kroacisë mbi mbrojtjen e të drejtave të pakicës serbe dhe malazeze në Republikën e Kroacisë dhe pakicës kroate në Serbi dhe Mal të Zi, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 3/2005. [*Marrëveshja me Kroacinë*]
5. Ligji mbi ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Hungarisë mbi mbrojtjen e të drejtave të pakicës kombëtare hungareze e cila jeton në Serbi dhe Mal të Zi dhe pakicës kombëtare serbe e cila jeton në Republikën e Hungarisë, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 14/2004. [*Marrëveshja me Hungarinë*]
6. Ligji mbi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi dhe Republikës së Maqedonisë mbi mbrojtjen e pakicës kombëtare serbe dhe malazeze në Republikën e Serbisë dhe pakicës kombëtare maqedonase në Serbi dhe Mal të Zi, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare* nr. 6/2005. [*Marrëveshja me Maqedoninë*]
7. Ligji mbi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Federale të RFJ-së dhe Qeverisë së Rumanisë mbi bashkëpunimin në lëminë e mbrojtjes së pakicave kombëtare, *Gazeta Zyrtare e SMZ-së – Marrëveshjet ndërkombëtare*, nr. 14/2004.
8. Ligji mbi përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, *Gazeta zyrtare e RS-së*, nr. 45/91, 53/93, 67/93, 48/94 dhe 101/2005- ligji i dytë. [*Marrëveshja me Rumaninë*]
9. Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, *Gazeta Zyrtare e RFJ-së*, nr. 11/2002. [*Ligji mbi pakicat*]
10. Ligji mbi këshillat nacionale të pakicave kombëtare, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 72/2009. [*Ligji mbi këshillat nacionale*]
11. Ligji mbi përcaktimin e kompetencave të caktuara të krahinës autonome, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 6/2002, 101/2007 – ligji i d. dhe 51/2009 – ligji i d. [*Ligji omnibus*] (vlen deri më 1 janar 2009)
12. Ligji mbi përcaktimin e kompetencave të Krahinës Autonome të Vojvodinës, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 99/2009 (vlen nga 1 janari 2009)
13. Ligji mbi vetëqeverisjen lokale, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 129/2007.
14. Ligji mbi librat amë, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 15/90, 57/2003, 101/2005 (ka qenë në fuqi deri më 27 dhjetor 2009)
15. Ligji mbi marrëdhëniet familjare, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 18/2005.
16. Ligji mbi librat amë, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 20/2009 (vlen deri më 27 dhjetor 2009)
17. Ligji mbi letërnjoftimin, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 62/2006.
18. Ligji mbi shkollat fillore, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 50/92, 53/93, 67/93, 48/94, 66/94 – Vendimi i GJKRS-së, 22/2002, 62/2003 – ligji i d., 64/2003 – korrigjimi i ligjit të d., 101/2005 – ligji i d. dhe 72/2009 – ligji i d..

19. Ligji mbi shkollën e mesme, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 50/92, 53/93, 67/93, 48/94, 24/96, 23/2002, 25/2002 – i korrigjuar, 62/2003 – ligji i d., 64/2003 – korrigjimi i ligjit të d., 101/2005 – ligji i d. dhe 72/2009 – ligji i d.
20. Ligji mbi arsimin e lartë, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 76/2005, 100/2007 – interpretimi autentik i 97/2008.
21. Ligji mbi procedurën e përgjithshme administrative, *Gazeta Zyrtare e RF të Jugosllavisë*, nr. 33/97 dhe 31/2001. [LPA]
22. Ligji mbi procedurën kontestimore, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 125/2004 dhe 111/2009.
23. Kodi i procedurës penale, *Gazeta Zyrtare e RF të Jugosllavisë*, nr. 70/2001 dhe 68/2002 dhe *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 58/2004, 85/2005, 115/2005, 85/2005 – ligji i d., 49/2007, 20/2009 – ligji i d. dhe 72/2009.
24. Ligji mbi kundërvajtjet, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 101/2005, 116/2008 dhe 111/2009. (fillon të aplikohet më 1 janar 2010)
25. Ligji mbi rregullimin e gjykatave, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 116/2008 dhe 104/2009.
26. Ligji mbi zgjedhjen e deputetëve kombëtar, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 35/2000, 57/2003 – vendimi i GJKRS-së, 72/2003 – ligji i d., 75/2003 – korr. i ligjit të d., 18/2004, 101/2005 – ligji i d., 85/2005 – ligji i d., dhe 104/2009 – ligji i d.
27. Ligji mbi zgjedhjet lokale, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 129/2007.
28. Ligji mbi publikimin e ligjeve dhe rregulloreve dhe akteve të përgjithshme si dhe mbi botimin e *Gazetës Zyrtare të Republikës së Serbisë*, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 72/91 dhe *Gazeta Zyrtare e RFJ-së*, nr. 11/93 – vendimi i GJKRS-së.
29. Rregullorja e punës e Kuvendit popullor, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 14/2009.
30. Rregullorja e punës së gjykatave (*Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr.110/2009).
31. Konkluzioni i Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi masat për ngritjen e pjesëmarrjes së pjesëtarëve të pakicave kombëtare në organet e administratës shtetërore, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 40/2006.
32. Rregullorja mbi letërnjoftimin, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 11/2007, 9/2008.
33. Rregullorja mbi formularët e akteve të procedurës administrative, *Gazeta Zyrtare e RF të Jugosllavisë*, nr. 8/99 dhe 9/99-e korrigjuar.
34. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese IU-27/99, *Gazeta zyrtare e RS-së*, nr. 10/2001.
35. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese IU-297/96, *Gazeta Zyrtare e RS-së*, nr. 15/2001.
36. Statuti i KA të Vojvodinës, *Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 17/91 (vlen deri më 14 dhjetor 2009)
37. Statuti i KA të Vojvodinës, *Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 17/2009. (vlen deri më 14 dhjetor 2009)
38. Rregullorja e Kuvendit të Vojvodinës, *Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 23/2002, 30/2004, 4/2008 dhe 13/2009.
39. Vendimi mbi rregullimin më të afërt të çështjeve të caktuara të përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të pakicave kombëtare në territorin e KA të Vojvodinës, *Gazeta zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 8/03 dhe 9/03. [Vendimi mbi gjuhët e pakicave]
40. Vendimi mbi formularët shumëgjuhësor të certifikatave nga librat amë dhe mënyra e regjistrimit të tyre, *Gazeta Zyrtare e KA të Vojvodinës*, nr. 1/01 dhe 8/03.
41. Statuti i qytetit të Zrenjaninit, *Gazeta Zyrtare e Zrenjaninit*, nr. 21/2008.

42. Statuti i qytetit të Suboticës, *Gazeta Zyrtare e komunës së Suboticës*, nr. 26/2008, 27/2008-i korrigjuar.
43. Statuti i qytetit të Novi Pazarit, *Gazeta Zyrtare e komunës së Novi Pazarit*, nr. 14/2008 dhe *Gazeta Zyrtare e qytetit të Novi Pazarit*, nr. 7/2009.

BURIMET - HULUMTIMI

1. Sekretariati krahinor për rregullore, administratë dhe pakica kombëtare: Danica Lluqić, shefe e Sektorit për mbikëqyrje administrative (20 gusht 2009)
2. Zyra e Ombudsmanit Krahinor të KA të Vojvodinës: Petar Teofilović, Ombudsmani krahinor; Zolltan Gobor, zëvendës i Ombudsmanit Krahinor për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare; Kllara Oros, këshilltare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare (20 gusht 2009)
3. Këshilli nacional i pakicës kombëtare rumune: Dragan Marqell, kryetar (21 gusht 2009)
4. Komuna e Kuqevos: Zoran Mllekić, kryetari i komunës së Kuqevës; Mića Stojanović, zëvendësi i Kryetarit të Komunës; Snežana Rančić, shefe e administratës komunale; Dragoslav Mratiq, kryetari i KK; Dushica Radivojević, shefe e drejtoratit për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta-shërbimit të ofiqarisë; Zlatko Janković, zëvendësi i komandantit të SP të Kuqevës (9 shtator 2009)
5. Këshilli kombëtar i pakicës kombëtare vllahe: Zavisha Zhurz, kryetar; Predrag Bellashević, anëtar; Zoran Janković, anëtar (9 shtator 2009)
6. Komuna e Borit: Branisllav Rankić, kryetari i komunës së Borit; Predrag Ballashević, zëvendësi i Kryetarit të Komunës; Ljubinka Jellić, shefe e administratës komunale; Dragan Marković kryetari i KK-së; Zoran Janković, ndihmësi i kryetarit të Komunës; Sllobodan Baxha, sekretari i KK-së; Novica Marelj, shefi i shërbimit të ofiqarisë dhe Sllavisha Barac, shef i administratës policore Bor (10 shtator 2009)
7. Qyteti i Novi Pazarit: Mirsad Mahmutović, kryetar; Borka Jovanović, kryetare e Kuvendit të qytetit; Hajrudin Hajrović, anëtar i Këshillit të qytetit përgjegjës për arsim dhe çështje sociale; Rifat Rexhević, drejtor i Shtëpisë së kulturës; Sulejman Nićević, shef i administratës së qytetit; Sabaheta Munishević, zëvendëse e shefit të drejtoratit për administratë të përgjithshme; Ibrahim Maxhović, kryetari i Gjykatës komunale; Vladimir Gjurić, drejtori i filiales së administratës tatimore të Novi Pazarit; Adnan Dizdarević, sociolog në Ćendrën për punë sociale; Enver Beshirović, zëvendësi i shefit të administratës policore të Novi Pazarit; Esad Gjugjević, kryetar i Këshillit nacional të pakicës kombëtare boshnjake (16 shtator 2009)
8. Komuna Prijepolje: Dobro Llazarević, zëvendës Kryetari i Komunës; Hanka Hajdarević, shefe e administratës komunale (17 shtator 2009)
9. Komuna e Pribojit: L Lazar Rvović, kryetari i Komunës dhe Vitomir Pjevac, kryetar i KK-së (18 shtator 2009)
10. Komuna e Medvegjës: Jadranka Bozhović, shefe e administratës komunale dhe Zorica Stanković, shefe e drejtoratit për administratë të përgjithshme; Zoran Anxhelić, komandant i stacionit policor të Medvegjës, R. Radovanović, komandant i Postit policor të Medvegjës (28 shtator 2009)

11. Qyteti i Vranjës: Sllobodan Stamenković, Kryetari i Kuvendit të Qytetit dhe Ljiljana Stojanović, sekretar i Kuvendit të qytetit të Vranjës (28 shtator 2009)
12. Komuna e Bujanovcit: Farush Islami, shef i administratës komunale; Nasim Rexhepi, shef i drejtoratit për administratë të përgjithshme; Predrag Cvetković, Kryetar i Gjykatës komunale të Bujanovcit; Dragan Veličković, komandant i stacionit policor të Bujanovcit (29 shtator 2009)
13. Komuna Bosilegrad: Stanisha Zinoviev, shef i administratës komunale; Dimitar Vasilev, ofiqar; të pranishëm ishin edhe Sllavica Stojanova, sekretare e KK-së; Vlladimir Zaharijev, kryetari i Komunës dhe z. Jordanov, referent për gjendje civile; Boris Georgiev, kryetari i Gjykatës komunale në Bosilegrad; Novica Stojanov, komandanti i postit policor në Bosilegrad; Nenad Marković, zëvendës shefi i administratës policore në Vranje; Këshilli nacional i pakicës kombëtare bullgare (30 shtator 2009)
14. Këshilli nacional i pakicës kombëtare hungareze: Llaslo Jozha, kryetar (14 tetor 2009)
15. Qyteti i Suboticës: Marija Ushumović-Davčik, shefe e administratës së; Zllatko Marosiuk, ombudsmeni lokal; Odri Kakonjish-Zhuzhan, shefe e drejtoratit për gjendjen civile të qytetarëve dhe Marija Miljatović, shefe e shërbimit të administratës së përgjithshme; Ivan Bogosavljev, kryetari i Gjykatës komunale në Suboticë dhe Borivoje Mucalj, shef i administratës policore të Suboticës (14 tetor 2009)
16. Qyteti i Novi Sadit: Milena Popović-Subić, anëtare e këshillit të qytetit për rregullore; Zora Gjorgjić, shefe e administratës së qytetit për rregullore; Biljana Dragin, ndihmëse e shefit për gjendje civile; Ruzhica Kollapić, shefe e administratës së qytetit për punë të përgjithshme; Petar Mohan, kryetari i Gjykatës komunale të Novi Sadit; Aleksandar Vučković, zëvendës i drejtorit që qendrës regjionale të Administratës tatimore të Novi Sadit; Petar Jellići, shef i sektorit për analitikë i administratës policore të Novi Sadit; Radovan Vuqurović, shef i drejtoratit për punë administrative të administratës policore të Novi Sadit dhe Lljajosh Mishkolci, komandant i stacionit policor të Temerinit. Është mbajtur edhe një takim i përbashkët me Mato Groznicën, Dragan Marćellon, Negjo Antićin, përfaqësues të këshillave nacionale të pakicave kombëtare kroate, rumune, rusine dhe sllovaqe (16 tetor 2009)
17. Qyteti i Somborit: Irina Burk-Pačetić, shefe e administratës së qytetit dhe Zvonimir Štrbac, shef i drejtoratit për administratë të përgjithshme; Branislav Petković, kryetari i Gjykatës komunale të Somborit; Saša Dimitrašinović, shef i administratës policore, Mirjana Cvijanović, shefe e sektorit për analitikë dhe evidenca dhe Vlladimir Zorica, shef i drejtoratit për punë administrative të administratës policore në Sombor (29 tetor 2009).
18. Komuna e Shidit: Živka Sremac, shefe e drejtorit për administratë të përgjithshme dhe veprimtari shoqërore; Bogdan Tomasović, ofiqar; Dragi Tintor, kryetar i Gjykatës komunale në Shid; gjykatësit Ljubica Petrić dhe Nevenka Smajić, bashkëpunëtor i lartë gjyqësor Miroslav Cirba; Mirko Đurić, shef i grupit për luftimin e krimit; Stevan Vukelić, zëvendës i komandantit të stacionit policor të Shidit dhe Radmilla Savanović, shefe e drejtoratit për punë administrative (30 tetor 2009)
19. Qyteti i Zrenjaninit: Sofija Anxhellković, zëvendëse e shefit të drejtoratit për punë administrative; Dobrinka Bačić, shefe e shërbimit për punë të zyreve lokale; Ljubica Cikora, kryeofiqare; Gordana Dragojlllov, shefe e sektorit për punë administrativo-

- juridike dhe punë të ofiqarisë dhe Stanko Lov-Peter, bashkëpunëtor i lartë për punë administrative dhe të përkthimit; Divna Tatić, kryetare e Gjykatës komunale dhe Zllatoje Ankić, zëvendës kryetare e Gjykatës komunale; Bojan Marković, shef i administratës policore (4 nëntor 2009)
20. Komuna e Kovaqicës: Dushanka Aleksić, sekretare e KK-së dhe Jadranka Tekijashki, shefe e shërbimit të ofiqarisë; Ondrej Sahter, u.d. i Kryetarit të Gjykatës komunale; Janko Mihalj, komandanti i stacionit policor dhe Atila Berkan, zëvendës shefi i punëve administrative të stacionit policor (4 nëntor 2009)
21. Komuna e Sentas: Roland Janković, shefi i administratës komunale dhe Gordana Balloq, ofiqare; Ivan Hershi, kryetari i Gjykatës komunale; Dragoljub Milinkov, komandant i stacionit policor (5 nëntor 2009)
22. Komuna e Vrhacit: Jovan Knezhević, shefi i administratës komunale; Branislav Gjurić, shef i drejtoratit për administratë të përgjithshme; Petar Pavkov, ofiqar dhe Ljiljana Kovački-Gjan; Milorad Ankić, ndihmës i lartë i gjykatësve në Gjykatën komunale Vrhac; Snezhana Kanački, shefe e grupit për punë administrative në stacionin policor (6 nëntor 2009)
23. Komuna Alibunar: Oktavijan Broshqanac, shef i administratës komunale; Cvetana Radulović-Kozhokari, shefe e Drejtoratit për gjendje civile, administratë të përgjithshme dhe çështje pronësoro-juridike dhe Eufrozina Trifu, bashkëpunëtore e lartë për gjendje civile – ofiqare; Marijana Trifu, gjykatës në Gjykatën komunale; Slobodan Đoković, zëvendës komandanti i nën-stacionit policor (6 nëntor 2009)
24. Endre Lleq, avokat dhe përkthyes i autorizuar gjyqësor për gjuhën hungareze (10. nëntor 2009)
25. Komuna Temerin: Magdolna Pete, shefe e administratës komunale; Goran Rodić, kryetari i gjykatës komunale; Lljajosh Mishkolci, komandant i stacionit policor (11. nëntor 2009)
26. Komuna Srbobran: Dragan Šarčev, shef i administratës komunale; Gordana Rankov, shefe e drejtoratit për punë administrative dhe të përbashkëta; Zita Jović, zëvendëse e ofiqares kryesore; Zdravko Vasilić gjykatës i drejtoratit të gjykatës komunale në Vrbas dhe Srbobran; Rodoljub Zinović, komandant i stacionit policor dhe Radosava Ćobanov, shefe e punëve administrative të stacionit policor (11. nëntor 2009)
27. Komuna Stara Pazova: Radmila Odošić, shefe e administratës komunale; Gordana Milosavljević nga shërbimi për çështje të kuvendit dhe Miloš Jovanović, shef i sektorit për administratë të përgjithshme; Ruzhica Nikolić, kryetare e gjykatës komunale; Zoran Obrenović, komandant i stacionit policor (12. nëntor 2009)
28. Tryeza e rrumbullakët mbi aspektet shoqëro-gjuhësore të përdorimit zyrtar të gjuhëve të pakicave kombëtare në zyren e Mbrojtësit të qytetarëve: prof. dr Goran Bašić, zëvendës i Mbrojtësit të qytetarëve; dr Ranko Bugarski, dr Biljana Sikimić, dr Rajko Đurić, dr. XXX, doc. dr Ljubica Gjorgjević, si dhe bashkëpunëtorë të zyres së Mbrojtësit të qytetarëve (13. nëntor 2009)
29. Ministria për administratë shtetërore dhe vetëqeverisje lokale: Jasmina Ben-Mensur; Zoran Petrović, ndihmës i ministrit dhe Bratislav Gjokić, ndihmës i ministrit për mbikëqyrje (20. nëntor 2009)

30. Ministria e drejtësisë: Helene Surliq, këshilltare e lartë në drejtoratin për mbikëqyrje të gjykatave, organeve për kundërvajtje dhe prokuritë (20. nëntor 2009)
31. Ministria e punëve të brendshme: Aleksandar Veljković, shef i drejtoratit për çështje normative; Jasmina Vasiljević, këshilltare ligjore në Zyren e ankesave; Dejan Joksimović, zëvendës shef për kontrollin e ligjshmërisë në administratën policore dhe Biljana Trifunović-Govedarović, shefe e sektorit për letërnjoftime, vendbanime dhe çështje tjera administrative në administratën policore (20. nëntor 2009)
32. Ministria për të drejtat e njeriut dhe të pakicave: Zorica Novaković dhe Gordana Govedarica nga drejtorati i ministrisë për avancimin e të drejtave të pakicave kombëtare si dhe Bosiljka Agjemović, këshilltare për çështje normative (25. nëntor 2009)
33. Administrata tatimore: Zoran Vasić, ndihmës i drejtorit të administratës qendrore të Novi Sadit; Aleksandar Vuković, zëvendës drejtor i qendrës rajonale të administratës tatimore në Novi Sad dhe Miodrag Pavićević, ndihmës i drejtorit të administratës tatimore qendrore për çështje tatimore juridike dhe koordinim (25. nëntor 2009)
34. Gjykata kushtetuese e Serbisë: Snezhana Markovska-Antić, zëvendëse e sekretarit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë; Ljiljana Lalić, koordinatore e praktikës gjyqësore dhe Bojana Gjorgjević, këshilltare e pavarur (4. dhjetor 2009)
35. Gjykata supreme e Serbisë: gjykatëset Vida Petrović-Shkero dhe Nevenka Vazhić (4. dhjetor 2009)